

Universiteti i Evropës Juglindore

Fakulteti Juridik

Studime posdiplomike - cikli i dytë - programi “E drejta civile”



TEZA E MAGJISTRATURËS

Tema: *Procedura e përmbarimit në legjislacionin e Republikës së Kosovës*

Kandidat-ja:

Julinda Elezi

Mentori:

Doc. D-R. Emine Zendeli

Tetovë, 2018

HYRJE

Çështja e përmbarimit me kohë ka pësuar ndryshime në legjislacionin e Republikës së Kosovës. Deri në fund të vitit 2013 ishin kompetent përmbaruesit gjyqësor, gjykata ishte ajo që merrej me çështjet nga procedura përmbarimore. Nga Maji i vitit 2014 hyri në funksion dhe u aplikua ligji për përmbarues privat, ku që prej atëherë përmbaruesve privat iu janë deleguar autorizimet që do të kryejnë natyrisht në shërbim të palëve, pra kreditorëve, ku në saje të përmbaruesit privat kreditorët do të realizojnë të drejtat e tyre ligjore duke mos lënë anash dhe respektimin e dinjitetit të debitorëve. Ideja e krijimit të shërbimit përmbarimor privat ka sjellur transparencën e veprimtarisë së këtij shërbimi, e cila ndërlihet me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Si pasojë e vonesave të mëdha në përmbarimin e vendimeve gjyqësore në Kosovë është dëmtuar e drejta për gjykim korrekt e cila poashtu e ka dëmtuar sundimin e ligjit në përgjithësi. Duke e marrë bazë faktin që institucioni i përmbaruesve privat është një institucion bashkëkohor, do të bëhet shqyrtimi i rrjedhjes së procedurës përmbaruese, duke filluar hulumtimin nga koha kur kryhej nga gjykata pra para ekzistimit dhe funksionimit të përmbaruesit privat dhe shqyrtimi i kësaj procedure nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit për përmbarues privat. Qëllimi i këtij punimi do të jetë arritja në atë pikë që na vërteton suksesin dhe efikasitetin e punës së përmbaruesit privat, pra ndikimet pozitive që na ka sjellur aplikimi i ligjit për përmbarues privat. Por krahas kësaj, unë mendoj që do mund të gjejmë edhe ndonjë mangësi si p.sh: Shpenzimet, ku në rastin e përmbaruesit privat janë më të mëdha se sa që kanë qenë në gjykatë, andaj do shtrohet në tryezë çështja se a vlen të jenë shpenzimet më të mëdha dhe lënda të kryhet më shpejtë dhe me shumë efikasitet, duke mos harruar që poenta e ligjit për përmbarim është që lëndët të mos vazhdojnë të vonohen siç ka ndodhur më herët.

Në këtë punim do të bëhet poashtu krahasimi i rrjedhjes së procedurës për përmbarim në legjislacionin e Kosovës krahas legjislacioneve të tjera, ku ende aplikohet sistemi gjyqësor duke i nxjerrë avantazhet dhe dis avantazhet në të dy sistemet. Do të bëhet edhe krahasimi i kësaj procedure në legjislacionin e Kosovës krahas ndonjë shteti tjetër ballkanik apo evropian, si p.sh. do të bëhet krahasimi me Maqedoninë, Shqipërinë, etj aplikohet poashtu sistemi privat, dhe kjo do të realizohet për ti nxjerr në pah hapësirat apo mangësitë që mund ti ketë cilido legjislacion krahas tjetrit, pasi që kur krahasohen dy shtete me një sistem të njejtë medoemos do të gjejmë ndonjë dallim në mes tyre, ndonjë përparësi apo mangësi në mes tyre, ku kjo do na shpie drejt plotësimit të zbrazëtirave në procedurën përmbarimore në

legjislacionin e Kosovës. Një gjë tjetër që vlen të përmendet është se procedura për përmbaerim është paraparë për ata që nuk e paguajnë borxhin, e jo për ata që nuk kanë mundësi ta kryejnë detyrimin ndaj kreditorit. Kjo është një ndër pikat kyqe ku mund të jepet ndonjë propozim që të ndahet situata e mos dashjes të kryerjes së detyrimit dhe mos mundësisë të kryerjes së detyrimit, gjithmonë duke iu referuar drejtësisë dhe kodit të etikës. Siç e shohim Kosova është ballafaquar me shumë probleme në procedurën e përmbaerimit, por me fillimin e aplikimit të ligjit për përmbaerues privat nga viti 2014, shërbimi ka ardhur duke u përmirësuar, duke e pasur ne fokus qëllimin final të ekzekutimit të lëndëve, gjithnjë duke i respektuar të drejtat e palëve.

Me funksionalizimin e sistemit privat për përmbaerim, Kosova përfundimisht ka bërë një hap të madh drejt përmirësimit të sundimit të ligjit dhe respektimit të përmbushjes së detyrimeve. Është fakt që ky sistem ka marrë kohë derisa ka arritur stabilizimin e duhur, por me plot kuptimin e fjalës mund të themi që sistemi privat për procedurën e përmbaerimit në Kosovë është lancuar suksesshëm. Reforma të tilla si kjo me të vërtetë ndihmojnë legjislacionin e Kosovës ne rrugën e saj drejt reformimit të sistemit të së drejtës dhe krijimin e një sistemi më praktik për ti përmbushur nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të saj.

Çështja e përmbaerimit është mjaft çështje atraktive por në të njëjtën kohë e ndjeshme, andaj do jem falemnderuese ndaj çdo kritike, propozimi dhe vërejtje.

KREU I

I. KUPTIMI I PROCEDURËS PËR PËRMBARIM

1 Dispozitat themelore të procedurës përmbarimore

Ligji për procedurë përmbarimore rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të marrë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër. Ligji për procedurë përmbarimore rregullon edhe kryerjen e veprimtarisë së përmbaruesve privat.¹ Procedura e përmbarimit i referohet çfarëdo veprimi të ndërmarrë bazuar në vendimin përmbarues gjatë zbatimit të atij vendimi.² Kur jemi tek organi përmbarues dhe vendimet, Procedurën e përmbarimit në shkallë të parë e udhëheq dhe për te vendosë përmbaruesi privat, ndërsa përjashtimisht gjyqtari individual kur me këtë ligj është caktuar se përmbarimin e cakton dhe zbaton Gjykata (organi i shkallës së parë). Organi përmbarues vendos për propozimin e përmbarimit brenda afatit prej shtatë (7) ditëve pas pranimit të propozimit. Në shkallën e dytë vendimet i nxjerrë gjyqtari individual. Nëse vendimi për realizimin e detyrueshëm të kredisë merret në ndonjë procedurë tjetër gjyqësore, ai vendim merret nga Gjykata në përbërjen sipas të cilës udhëhiqet ajo procedurë gjyqësore. Vendimet në procedurën e përmbarimit organi përmbarues i nxjerrë në formë të aktvendimit ose urdhrorit për përmbarim. Konkluzioni nxirret për zbatimin e disa veprimeve dhe për drejtimin e procedurës.³ Në procedurën e përmbarimit organi përmbarues ka për detyrë të veprojë me ngutshmëri. Organi përmbarues ka për detyrë që lëndët t'i marrë në punë sipas radhës që i ka pranuar, përpos kur natyra e kredisë ose rrethanat e posaçme kërkojnë që organi përmbarues të veprojë ndryshe. Organi përmbarues mund të konkludojë se natyra e kredisë kërkon trajtim të përshpejtuar të rastit nëse ka rrezik legjitim që pasuritë e debitorit në atë rast të mos jenë në

¹ Neni 1- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

² Neni 2- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

³ Neni 3- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

dispozicion për konfiskim apo do t'i bie vlera shumë në rast të vonesës. Gjyqtari mund të pranojë 5 ekzistimin e rrethanave të veçanta, dhe të veprojë shpejt, në rastet që kanë të bëjnë me punësimin, çështjet familjare, alimentacionin apo pagesat për fëmijë nëse interesat e palës mund të ndikohen negativisht si rezultat i vonesës.⁴ Mjete të përmbartimit janë veprimet përmbartimore ose sistemi i veprimeve të tilla, me të cilat sipas ligjit kërkesa realizohet me detyrim. Objektet e përmbartimit janë pasuria dhe të drejtat tjera që mund t'i nënshtrohen përmbartimit, përveç atyre që përjashtohen nga përmbartimi me ligj dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë. Veprimet përmbartimore mund të kryhen drejtpërdrejtë kundër debitorëve dhe personave tjerë, në pajtim me ligjin për procedurë përmbartimore.⁵ Objekt përmbartimi nuk mund të bëhen sendet jashtë qarkullimit juridik, pasuritë nëntokësore dhe pasuritë tjera natyrore. Objekt përmbartimi nuk mund të bëhen objektet, armatimi dhe pajisjet e forcave të armatosura dhe të policisë, e as mjetet financiare të siguruar për dedikime të këtilla.⁶ Me propozimin e kreditorit, procedura përmbartimore inicohet me "Propozimin për përmbartim", i cili duhet të përmbajë:

1. Kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor apo dokumenti i besueshëm në bazë të të cilit kërkohet përmbartimi ("Propozimi për përmbartim");
2. Kërkuesi i përmbartimit dhe debitori;
3. Kredia që kërkohet të realizohet;
4. Mjeti më anë të të cilit duhet kryer përmbartimi;
5. Objekti i përmbartimit po që se është i njohur; si dhe
6. Të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit.⁷

Gjatë zbatimit të procedurës së përmbartimit, duhet kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit të debitorit, dhe përmbartimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundur për debitorët. Organi përmbartues ka për detyrë që me rastin e ekzekutimit të vendimit dhe të identifikimit të sendeve të veprojë me respektin e duhur të personalitetit të debitorit dhe të anëtarëve të familjes së tij. Nëse ekziston ndonjë arsye legjitime dhe nëse organi përmbartues ka miratimin për të kryer përmbartimin gjatë ditëve të pushimit dhe gjatë orëve të natës, organi përmbartues gjithashtu mund të kryej përmbartimin në shtëpinë e debitorit gjatë ditëve të

⁴ Neni 6- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁵ Neni 7- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁶ Neni 8- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁷ Shqiptimi i masave ndëshkuese nga inspektoratet komunale, Procedurat standarde evropiane.(Fq.18). Shih. http://helvetas-ks.org/demos/wp-content/uploads/2017/11/ProceduratStandardeOperative_ALB_05.pdf.

pushimit apo orëve të natës.⁸ Me vet faktin se është filluar procedura përbarimore, nënkuptohet se kreditori tashmë e ka fituar betejën me të cilën është vërtetuar se debitori i ka borxh. Me këtë, është e kuptueshme se ajo është e drejta e tij thelbësore. Sidoqoftë, edhe obligimi kryesor i tij është që në rast se i arkëtohet shuma më e madhe se sa që i takon, ai ka për detyrë që atë pjesë ta kthej tek organi përbarues i cili të njejtën e përcjell tutje tek debitori. Përveç të drejtës së qartë, që është kthimi i borxhit nga debitori, kreditori ka edhe obligime por edhe të drejta tjera që varen nga rasti në rast.⁹ Kur jemi tek zbatimi i përbarimit, mund të themi që përbarimi zbatohet edhe para se aktvendimi për përbarimin apo urdhri për përbarim të bëhet i formës së prerë, në qoftë se për veprimet e caktuara përbarimore nuk është paraparë diçka tjetër. Përbarimi i caktuar në bazë të dokumentit të besueshëm nuk mund të kryhet para se të ketë marrë formë të prerë aktvendimi për përbarimin apo urdhri për përbarim.¹⁰

1.1 Parimet udhëheqëse të përbarimit civil

Përbarimi është faza e fundit e procesit gjyqësor. Pa përbarim efektiv dhe në kohë të arsyeshme, palët privohen nga të drejtat e fituara me aktgjykim. Nga fundi i viteve të 90-ta, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriute ka njohur fazën e përbarimit si pjesë integrale të gjykimit me qëllim të vlerësimit se a iu është ofruar palëve mbrojtja e nevojshme nga gjyqësori. Kjo njohje rezultoi me një numër të vendimeve me të cilat sanksionohen shtetet për shkelje të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Sigurimi i qasjes së drejtë dhe procedurave efektive të përbarimit, tani u bë prioritet në gjithë Evropën.

Ekzistojnë katër parime të përbarimit civil:

- Përbarimi gjyqësor, i udhëhequr nga gjyqtari, p.sh: gjykata e ka përgjegjësinë primare për përbarimin e vendimeve gjyqësore dhe të dokumenteve të tjera që i nënshtrohen përbarimit.
- Përbarimi gjyqësor, i udhëhequr nga zyrtari për përbarim, p.sh: gjykata e ka përgjegjësinë primare për përbarimin e vendimeve gjyqësore dhe të dokumenteve

⁸ Neni 9- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁹ USAID- Programi për përbarim dhe legjislacion komercial, (Mars,2014). Shih.

http://kontrata.net/repository/docs/A_e_dini_se_nuk_keni_nevoj%EB_ta_pritni_Gjykat%EBn_p%EBr_ta_p%EBrmba_ruar_%EBnd%EBn_tuaj_844444.pdf.

¹⁰ Neni 48- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

tjera që i nënshtrohen përmbarrimit,ku zyrtari për përmbarrim e ka rolin kryesor për zbatimin e përmbarrimit.

- Përmbarrimi në sektorin publik, p.sh: agjencia ose ministria kanë përgjegjësinë primare për përmbarrimin e vendimeve gjyqësore dhe te dokumenteve tjera të përshtatshme për përmbarrim.
- Përmbarrimi në sektorin privat ose gjysmë-privat, p.sh: profesionistët e sektorit privat përkatësisht përmbarruesit privat,të cilët i nënshtrohen licencimit dhe rregullimit të saktë të aktiviteteve dhe tarifave të tyre,e kanë përgjegjësinë primare për përmbarrimin e vendimeve gjyqësore dhe të dokumenteve tjera të përshtatshme për përmbarrim.¹¹

Deri në fund të vitit 2013 në Kosovë ka dominuar modeli i dytë,mirëpo që nga viti 2014 në legjislacionin e Kosovës hyri në fuqi ligji për përmbarrues privat ku mund të themi që bashku me këtë ligj Kosova përjetoi fazën e tranzicionit duke bërë një hap shumë të rëndësishëm.

1.2 Parimet kyqe të udhëheqjes së procedurës për përmbarrim

- Koha e arsyeshme.Përmbarrimi duhet të kryhet në një kohë të arsyeshme në mënyrë që të garantohet efikasiteti i të drejtave të kreditorit.
- Nuk është kontest.Përmbarrimi është faza e fundit e procedurave gjyqësore,pasi që aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë.Nuk ka mundësi për ta rigjykuar rastin.
- Neutraliteti.Agjentët e përmbarrimit kanë mandatin e gjykatës për ta asistuar kreditorin në mbledhjen e borxhit i cili i takon.Agjenti i përmbarrimit nuk është i punësuar nga kreditori.Të gjithë veprimet e tij janë të parapara me ligj.
- Proporcionaliteti.Përmbarrimi i balancon të drejtat e kreditorit dhe të debitorit.Qëllimi kryesor i përmbarrimit është shfrytëzimi i mekanizmave të jashtëzakonshëm për të siguruar që kreditori të jetë i kënaqur.Mirëpo përmbarrimi nuk ia mohon të drejtat debitorit,që nënkupton se nëse nuk mund të merret ndonjë veprim i përmbarrimit-p.sh: debitori nuk posedon asnjë aset që do të mund të i merrej atëherë përmbarrimi duhet të përfundojë si i pamundshëm.

¹¹ USAID. (2007, fq.13). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarrimore në Kosovë.Shih.
[http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

Paraqitja e padisë në përmbarrimin civil është mundësia e fundit që i ofrohet kreditorit për ta realizuar të drejtën e tij ekzistuese. Përmbarrimi ndodh pas dështimit të debitorit në përmbushjen vullnetare të obligimit të tij. Pas lejimit të përmbarrimit debitorit i jepet edhe një rast për përmbushjen vullnetare të obligimit. Pas kalimit të këtij afati, procedura duhet menjëherë të kalojë në fazën e përmbarrimit.¹²

2 Përcaktimi i mjeteve dhe objektit të përmbarrimit

Gjykata me aktvendim, ose përmbarruesi privat me urdhër për përmbarrim, e cakton përmbarrimin ndaj atyre mjeteve dhe në ato objekte të përmbarrimit që janë specifikuar në propozimin për përmbarrimin. Përmbarrimi përfshin një apo të gjitha mjetet dhe objektet e përmbarrimit të paraqitura në propozimin për përmbarrim gjersa kërkesa të realizohet plotësisht. Me propozim të kreditorit apo sipas detyrës zyrtare, organi përmbarrues mund të vendosë, përmes urdhrit për përmbarrim që përmbarrimi të zbatohet ndaj pasurisë së debitorit që mund të jetë subjekt i përmbarrimit, pa deklaruar mjetet dhe objektet e përmbarrimit deri në limitin që mjafton për realizimin e kredisë së kreditorit. Nëse organi përmbarrues sekuestron më shumë mjete se sa që nevojiten për të realizuar kredinë, pjesa tjetër i kthehet debitorit në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Kreditori në këtë rast mund të kërkojë nga organi përmbarrues që të ndihmojë në identifikimin e pasurisë siç vijon më poshtë:

- Në qoftë se janë propozuar më shumë mjete apo objekte përmbarrimi sesa që nevojiten për të plotësuar vendimin, organi përmbarrues mund ta kufizojë përmbarrimin, sipas propozimit të debitorit, të kufizojë përmbarrimin vetëm në disa nga mjetet dhe objektet e tilla, po që se ato mjaftojnë në realizimin e kredisë
- Debitori mund të propozojë organit përmbarrues pasuritë që ai preferon të përmbarrtojë, dhe jep arsyet për kufizim të përmbarrimit.
- Debitori i bashkangjet propozimit në fjalë dëshmitë e shkruara, siç janë deklaratat bankare, duke dëshmuar se ato mjete dhe objekte mjaftojnë për ta mbuluar

¹² USAID. (2007, fq.14). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarrimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

kredinë. Debitori gjithashtu do të ofrojë informata të sakta organit përmbaues se ku gjenden ato mjete apo objekte dhe si ato të sekuestrohen.

- Propozimi i debitorit si dhe të gjitha informatat shoqëruese, i jepen kreditorit, dhe kreditori i përgjigjet propozimit brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i propozimit.
- Nëse kreditori nuk e pranon propozimin, organi përmbaues sigurohet nga dëshmitë e siguruar se pasuritë e dhëna në listë mjaftojnë për të mbuluar kredinë para se të vendosë në favor të propozimit të debitorit. Nëse organi përmbaues nuk arrin që të sigurohet, në bazë të dëshmimeve të ofruara, se pasuritë e dhëna në listë mjaftojnë për të mbuluar kredinë, organi përmbaues refuzon propozimin.

Në rastet kur pranohet propozimi i debitorit për të kufizuar mjetet dhe objektet e përmbaimit, dhe nëse pasuritë e dhëna në listë të propozimit nuk mund të gjenden apo ato pasuri janë të pamjaftueshme në shumën për të mbuluar kredinë, atëherë kreditori njofton organin përmbaues i cili menjëherë urdhëron zbatimin e propozimit fillestar të kreditorit për përmbaimit. Nën këto rrethana, debitori që ka të bërë propozimin mund të nënshtrohet gjobave sipas dispozitave të parapara që do të përmendim më vonë. Kreditori mund të pajtohet që të kufizojë kërkesën e tij në pajtim me propozimin e debitorit nëse konsideron propozimin adekuat për të mbuluar kredinë. Po qe se aktvendimi apo urdhri i përmbaimit nuk mund të zbatohet në objektin apo mjetin e përmbaimit, atëherë propozuesi i përmbaimit me qëllim të realizimit të kërkesës së njejtë, mund të propozojë ndonjë mjet ose objekt tjetër përmbaimit.

Kur ndalemi tek shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbaimit paraprakisht i paguan kreditori. Shpenzimet e parapara kreditori ka për detyrë të i parapaguaj brenda afatit të caktuar nga organi përmbaues. Organi përmbaues do ta pezulloj përmbaimit po qe se nuk parapaguhet shpenzimet brenda afatit të tillë. Nëse brenda afatit të dhënë nga organi përmbaues nuk parapaguhet shpenzimet për kryerjen e një veprimi konkret, atëherë nuk do të kryhet vetëm veprimi i tillë. Natyrisht që shpenzimet e procedurës së filluar nga Gjykata sipas detyrës zyrtare, paraprakisht i përballon vetë Gjykata nga buxheti i saj.¹³

¹³ Neni 10- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

3 Roli i kreditorit

Palët në procedurën përbarimore, sikurse në atë kontestimore janë dy: personi, kërkesa e të cilit realizohet në procedurë përbarimtare, e që është kreditor, dhe personi ndaj të cilit rrjedh procedura e realizimit të kërkesës së kreditorit, e që quhet debitor. Kreditor është personi, kredia e të cilit realizohet në procedurë të përbarimit të detyrueshëm. Kreditori është personi me propozimin e të cilit fillohet procedura përbarimtare. Pa ekzistimin e kreditorit nuk mund të ketë procedurë përbarimtare. Ai përfshihet në të gjithë fazat e procedurës siç e parasheh LPP (Ligji për Procedurë përbarimtare i Republikës së Kosovës).¹⁴ Në mes të drejtave dhe obligimeve të kreditorit hasim:

- a. Të drejtën për të kërkuar përbarimin në bazë të dokumentit të përshtatshëm- p.sh aktgjykimi i formës së prerë, i cili është i ekzekutues
- b. Diskrecioni për të përcaktuar mjetet dhe mënyrën e përbarimit. Në praktikë, sekuestrimi dhe transferimi i pasurisë monetare siç janë fondet në llogaritë bankare apo të ardhurat, janë mjetet e preferuara për përbarim sepse ato mund të identifikohen lehtë dhe kërkojnë hapa minimale për ta përmbushur kërkesën e kreditorit. Në anën tjetër, prona e paluajtshme në përgjithësi shihet si mundësi e fundit, sepse përbarimi i pronës së paluajtshme zakonisht zgjatë më shumë dhe kërkon ndjekjen e një procedure të vështirë të vlerësimit, shitjes dhe shpërndarjes së mjeteve.
- c. Detyra për të siguruar informata përkatëse mbi debitorin, vendqëndrimin e tij dhe pasurinë e tij- Në rastet kur kreditori nuk ka informata për debitorin, për vendqëndrimin e tij apo për pasurinë e tij, gjykata do të përdorë të gjitha mjetet në dispozicion për të identifikuar informatat shtesë. Nëse nuk mund të gjendet asnjë e dhënë dhe nëse kreditori dështon të sigurojë informatat ekzistuese brenda një kohe të arsyeshme, procedura duhet të konsiderohet e përfunduar.¹⁵
- d. Detyra për të treguar interes të vazhdueshëm në përbarim- Gjykata nuk duhet të jetë përgjegjëse për mungesën e interesimit të kreditorit për progres në procedure, apo për dështimin e kreditorit që të shoh se procedura nuk do të shpie në kurrfarë inkasimi. Në rastet në të cilat duhet të pezullohet procedura duke pritur zgjidhjen e

¹⁴ Brestovci, F. (2004, fq.117). E drejta Procedurale Civile. Prishtinë.

¹⁵ USAID. (2007, fq.15). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përbarimtare në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

një çështjeje tjetër siç është zgjidhja e trashëgimisë në rastet e vdekjes së debitorit, kreditorit duhet t'i kërkohej ripohimi i interesimit të tij për vazhdimin e procedurës.

3.1 Roli i debitorit

Debitori është personi ndaj të cilit kërkohej përmbartimi. Pa debitorin nuk ka procedurë përmbartimore. Qëllimi i procedurës përmbartimore është ta detyrojë debitorin që t'i përmbushë obligimet ndaj kreditorit. Ligji mbi procedurën përmbartimore është vlerësuar si shumë i favorshëm ndaj debitorit.

Në mesin e këtyre favoreve ndaj debitorit kemi hasur:

- a. Kërkesa që debitori të trajtohet me dinjitet dhe që veprimet e përmbartimit të jenë sa më pak të pafavorshme për debitorin. (Neni 5)
- b. Mundësia për të zëvendësuar pasurinë.
- c. Kufizime të mëdha dhe përjashtime nga përmbartimi. (Nenet 71,92,93,152 dhe 188 LPP)
- d. Mundësi të shumta për kundërshtim.(Nenet 50 dhe 55 LPP).¹⁶

3.2 Roli i palës së tretë

Pala e tretë mund të ketë rol të rëndësishëm në proces. Disa palë të treta janë persona me të drejtën e ndërhyrjes në procedurën përmbartimore, për shkak të drejtës apo interesimit për objektin e përmbartimit. P.sh pala e tretë mund të jetë vet pronari i ndonjë objekti që është përzgjedhur për përmbartim. Në këtë rast, pala e tretë ka të drejtë të prezantojë në objekt dhe të kërkojë që procedura të ndërpritet në atë artikull. Ndërhyrja e kësaj pale të tretë në procedurën përmbartimore është eventuale, e pa obligueshme dhe varet nga dëshira e tij. Një tjetër kategori e rëndësishme e palës së tretë janë debitorët e debitorit. Këta janë persona të cilët kanë ndonjë obligim ndaj debitorit, i cili ende nuk është përmbushur, p.sh: Një person i cili e ka blerë një veturë nga debitori, por nuk ia ka paguar ende. Shembulli tjetër është banka, në të cilën kreditori ka llogari bankare. Në këtë rast, kreditori mund të kërkojë që gjykata të sjellë një vendim që e ndalon debitorin e debitorit nga përmbushja e obligimit të tij dhe e ndalon debitorin që të kërkojë përmbushjen e obligimit. Borxhi atëherë i bartet kreditorit. Në këtë

¹⁶ USAID.(2007,fq.15). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbartimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

kategori hyn çdo person i cili ka obligim ndaj debitorit dhe ende nuk e ka përmbushur obligimin.¹⁷

4 Procedura e përmbarimit

Procedura e përmbarimit i referohet çfarëdo veprimi të ndërmarrë bazuar në vendimin përmbarues gjatë zbatimit të atij vendimi.¹⁸

4.1 Incimi i procedurës

Procedura e përmbarimit inicohet me propozimin e kreditorit, ose sipas detyrës zyrtare të Gjykatës, kur me ligj parashihet një gjë e tillë.¹⁹ Gjykata kompetente ka kompetencë lëndore për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës në pajtim me dispozitat ligjore përveq nëse Gjykata dhe autoritetet tjera përmbaruese kanë juridiksionin për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës. Kur jemi tek përmbaruesi privat, ai nxjerr urdhër në bazë të propozimit për kryerje të përmbarimit dhe kryen përmbarimin me qëllim të plotësimit të kërkesës së debitorit në bazë të dokumentit përmbarues, përveq nëse ndryshe parashikohet me ligj që urdhëron që përmbarimi dhe kryerja e përmbarimit të bëhet brenda juridiksionit të Gjykatës. Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbaruese të cilat do të cekim në kapitujt në vijim, duke përfshirë edhe çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbaruesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin, apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbarimi. Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbarimit dhe të zbatojë përmbarimin e vendimeve lidhur me të gjitha

¹⁷ USAID.(2007,fq.17). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

¹⁸ Neni 2- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁹ Neni 4- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

çështjet nga e drejta familjare dhe kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera.²⁰

4.2 Propozimi për përmbarrim

Procedura e përmbarrimit fillon me paraqitjen e propozimit për përmbarrim nga ana e kreditorit. Kreditori zakonisht është personi, kërkesa e të cilit përmbushet në procedurën përmbarrimore. Kreditori është gjithnjë personi të cilit debitori duhet t`ia paguaj ndonjë shumë të hollash ose t`ia kryej apo të mos ja kryej ndonjë veprim, siç përshkruhet në dokumentin i cili paraqitet si bazë për përmbarrim. Përfaqësuesi ligjor ose avokati i autorizuar mund të veproj në emër të kreditorit ose debitorit.²¹ Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor original apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit, vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit. Në rast se propozimi për përmbarrim nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të parapara të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Po qe së bashku me propozimin për përmbarrim është bërë edhe kërkesa për konstatimin e pasurisë së debitorit, për rezultatin e konstatimit të tillë organi përmbarrues do ta njoftojë kreditorin duke i lënë afat që ta rregullojë propozimin e paraqitur, respektivisht që ta ndryshojë apo plotësoj atë. Vlen të ceket që propozimi i ndryshuar dorëzohet brenda dhjetë ditëve pasi që organi përmbarrues të ia dërgojë kreditorit deklaratën e pasurive të debitorit. Megjithatë, nëse kreditori kërkon aneks të deklaratës, siç është e paraparë edhe me ligj, brenda afatit kohor të lejuar, koha e lejuar për përmbarrim të propozimit të ndryshuar për përmbarrim llogaritet nga data në të cilën shtojca e dorëzuar nga debitori i dërgohet kreditorit.

4.3 Tërheqja dhe kufizimi i propozimit

Propozimi për përmbarrim mund edhe të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbarrimore pa pëlqimin e debitorit. Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbarrim nga organi përmbarrues e përfundon përmbarrimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr si në tërësi apo vetëm pjesërisht. Propozimi

²⁰ Neni 5- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²¹ USAID. (2007, Fq.29). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarrimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

për përbarim i tërhequr plotësisht apo pjesërisht mund të paraqitet përsëri në organin përbarimor, e nëse kreditori deklaron se kërkesa është zgjidhur me ujd plotësisht apo pjesërisht, konsiderohet se propozimi për kryerjen e përbarimit është tërhequr për atë pjesë.²²

4.4 Ndërprerja e procedurës

Organi përbarues nuk mund ta ndërpresë procedurën përbarimore me qëllim që të presë vendimin e Gjykatës kompetente, apo të ndonjë organi tjetër për çështjen paraprake. Në rast të vdekjes së kreditorit që nuk ka përfaqësues me prokurë apo përfaqësues ligjor, secili nga trashëgimtarët apo personat e interesuar mund të propozojë që deri sa të zgjasë bashkësia trashëgimore, Gjykata me shpenzime të propozuesit t'ua emërojë përfaqësuesin e përkohshëm dhe ta vazhdojë procedurën. Gjykata mund të emërojë vetëm një person që nuk ka interes personal në konflikt me interesat e kreditorit, dhe përfaqësuesi i përkohshëm ka për detyrë të lënë në mirëbesim që të veprojë në interes të kreditorit. Personi i emëruar ka të drejtën që të refuzojë emërimin, dhe përbaruesi në atë rast ka të drejtën që të emërojë një zëvendësues. Gjykata do të emërojë përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita e parashtrimit të propozimit. Në rast se propozimi i këtillë i trashëgimtarit, apo personave të interesuar nuk parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e vdekjes së kreditorit, Gjykata e pezullon procedurën përbarimore. Nëse ndalemi tek rasti i vdekjes së debitorit që nuk ka përfaqësues ligjor apo me prokurë, Gjykata brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita në të cilën është njoftuar për vdekjen e debitorit, emëron përfaqësuesin e përkohshëm në emër të trashëgimtarëve të debitorit në ngarkim të shpenzimeve të kreditorit, si rregull nga rradha e personave që e kanë në posedim pasurinë që është objekt përbarimi, dhe vazhdon procedurën. Gjykata e emëron përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës. Po qe se personat e autorizuar nuk e propozojnë vazhdimin e procedurës brenda afatit që u është caktuar, Gjykata e pezullon procedurën përbarimore. Gjykata mund të emërojë vetëm një person që nuk ka interes personal në konflikt me interesat e debitorit, dhe përfaqësuesi i përkohshëm ka për detyrë që të veprojë në interes të debitorit. Personi i emëruar ka të drejtën që të refuzojë emërimin, dhe Gjykata në atë rast ka të drejtën që të emërojë një zëvendësues.

Shpenzimet definitive të kreditorit të përbarimit, realizohen nga pasuria e debitorit. Pas mbarimit të bashkësisë trashëgimore, secili nga trashëgimtarët mund ta marrë përsipër

²² Neni 42- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

procedurën përbarimore duke iu paraqitur organit përbarues, ku për marrjen përsipër të procedurës dhe shkarkimin e përfaqësuesit të përkohshëm, organi përbarues vendosë me vendim të dhënë në formë të konkluzionit.²³

5 Procedura e marrjes së vendimit

Organi përbarues vendos për propozimin e përbarimit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të propozimit. Vendimet në procedurën e përbarimit organi përbarues i nxjerrë në formë *të aktvendimit ose urdhrit për përbarim*.

5.1 Aktvendimi për përbarim dhe urdhri për përbarim

Në aktvendim për përbarim dhe urdhrin për përbarim në bazë të titullit përbarues duhet të tregohet dokumenti përbarues, kreditori dhe debitori i përbarimit, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përbarimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përbarimit. Në aktvendim për përbarim dhe urdhrin për përbarim në bazë të dokumentit të besueshëm (për të cilin do flasim në vijim) duhet të tregohet dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit urdhërohet përbarimi, kreditori dhe debitori, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përbarimit, urdhri për debitorin për të zgjidhur kredinë dhe kostot tjera brenda afatit shtatë (7) ditësh dhe në kontestet në lidhje me kambialin apo çekun, brenda afatit tre (3) ditor, dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përbarimit. Me anë të vendimit për përbarim apo urdhërit për përbarim urdhërohet përbarimi në pronën e debitorit që është e përshtatshme për objektin e përbarimit, dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përbarimit.

Në qoftë se me anë të aktvendimit për përbarim apo urdhrin për përbarim është caktuar pagimi i kamatave, atëherë llogaritjen e tyre, me shpenzime të kreditorit të përbarimit, e bënë organi përbarues, përpos kur realizimi i kamatave duhet të bëhet nga paratë e depozituara në llogarinë bankare. Përbaruesit privat, nxjerrin urdhrin për përbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përbarueshmërisë së nxjerrë nga përbaruesi privat, Gjykata kryen rishikimin e procedurës së përbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhëri nga

²³ Neni 35- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

përmbareuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbareim nga përmbareuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.²⁴

5.2 Udhëzim për zbatimin e aktvendimeve për përmbareim duke debituar llogaritë bankare të klientëve nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Përshkrimi i përgjithshëm- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka vërejtur se Kosova përballet me problemet e shumta në zbatimin e aktgjykimeve për përmbareim duke debituar llogaritë bankare të klientëve. Në veçanti raportohet se vendimet e gjykatave që kërkojnë ngrirjen apo transferin e mjeteve nga llogaria e debitorit në llogarinë e kreditorit nuk ekzekutohen në kohë të duhur, ose në disa raste nuk ekzekutohen fare, pavarësisht faktit se këto vendime janë definitive.

Në situatë të tillë është shqetësim për tërë sektorin financiar, pasi që zbatimi në pajtueshmëri me vendimin definitive të gjykatave është një nga shtyllat e besimit afarist dhe ekonomisë së tregut.

Me qëllim të zbatueshmërisë efektive të Aktvendimeve për përmbareim, respektivisht me qëllim të zbatimit dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbareimore lidhur me përmbareimin për kredinë sipas llogarisë në bankë, të avancimit të përgjegjësisë që bankat komerciale kanë për zbatimin e aktvendimeve për përmbareim duke debituar llogaritë bankare të klientëve, BQK e lëshon këtë udhëzim për të arritur qëllimet e përmendura më lartë.

Fushëveprimi- BQK me anë të këtij udhëzimi ka vendosur masat e nevojshme që pasqyrohen në mënyrën e zbatimeve të aktvendimeve për përmbareim, duke debituar llogaritë e klientëve në secilën bankë komerciale të licencuar nga BQK. Ky udhëzim ju adresohet të gjitha Bankave Komerciale që veprojnë në Kosovë dhe janë të licencuara nga BQK.

Përkufizimet- ``Zbatimi i Aktvendimeve për përmbareim`` do të kuptohet si ekzekutimi i kërkesave duke debituar llogaritë bankare të debitorit të gjykuar në bazë të një vendimi të plotëfuqishëm gjyqësor për ekzekutim ashtu siç definohet me dispozitat e Ligjit të Porcedurës Përmbareimore të Kosovës.

²⁴ Neni 43- Ligji për procedurën përmbareimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Për qëllimet e këtij udhëzimi termi `` klient `` do të kuptohet si:

1. Një person juridik që ka llogari bankare në një bankë komerciale në Kosovë ose
2. Një person fizik që ka llogari bankare të hapura në një bankë komerciale në Kosovë.

Obligimet dhe Sanksionet- Banka Komerciale me të pranuar aktvendimin për përmbarrim nga ana e Gjykatës, do të verifikoj brenda një dite pune se a përmban aktvendimi për përmbarrim informatat si më poshtë:

- emrin e gjykatës, që ka lëshuar vendimin si dhe numrin dhe datën e veprimit;
- emrin e debitorit, numrin e llogarisë bankare dhe numrin e regjistrimit të biznesit (nëse personi juridik ose personi fizik merret me biznes);
- emrin e kreditorit, adresën dhe llogarinë bankare aktuale;
- shumën e borxhit (borxhin kryesor, kamatën dhe shpenzimet) të specifikuar në aktvendim për përmbarrim; dhe
- nënshkrimin dhe vulën e gjykatës që e ka lëshuar aktvendimin për përmbarrim;

Banka Komerciale do të konfirmojë pranimin e aktvendimit për përmbarrim me vulën e saj zyrtare duke shënuar datën dhe kohën në të cilën është pranuar dokumenti duke mbajtur një kopje të vulosur për vete.

Aktvendimi për përmbarrim duhet të zbatohet nga ana e bankës komerciale në afatin e përcaktuar ligjor ndaj të gjitha mjeteve që mbahen nga klienti në llogaritë bankare sin ë euro oi ashtu edhe mjetet ekuivalente në valutë të huaj, përveç mjeteve të cilat janë të përjashtuara me ligj nga ekzekutimi. Nëse aktvendimi për përmbarrim është konstatuar se nuk është valid ose se nuk përmban të gjitha shënimet të përmendura si më lartë, dhe mungesa e këtyre shënimeve apo të dhënave sipas mendimit të bankës komerciale e bënë atë urdhër gjyqësor të pa ekzekutueshëm, një vendim i tillë do të kthehet gjykatës brenda afatit të përcaktuar me ligj, me një shkresë përcjellëse në të cilën konstatohen arsyet e kthimit. Bankat komerciale do ta përcjellin një kopje të kësaj shkrese edhe tek Drejtori për Mbikqyrje bankare në BQK. Pas përfundimit të tentimeve që të zbatoj aktvendimin për përmbarrim, banka komerciale do të raportojë rezultatet e veprimeve të veta brenda tre ditësh nga pranimi i aktvendimit për përmbarrim, gjykatës që ka lëshuar atë dhe Drejtoratit për mbikqyrje bankare të BQK-së. Nëse banka komerciale raporton mjete jo të mjaftueshme në llogaritë e specifikuar për të përmbushë aktvendimin për përmbarrim atëherë ajo duhet të i dërgojë Gjykatës dhe Bankës Qendrore kopjen e saktë me të dhënat e llogarisë bankare të debitorit për periudhën që fillon

30 ditë para se aktvendimi për përmbarrim të lëshohet dhe përfundon me ditën kur raporti i është dërguar gjykatës. Kopja e të dhënave duhet të ketë shënimet e rregullta nga llogaria dhe të përmbajë të gjitha depozitat, tërheqjet dhe të gjithë transaksionet në llogari të bëra gjatë periodës raportuese. Kopja e të dhënave duhet të verifikohet nga zyrtari i bankës komerciale dhe të nënshkruhet nga ai me deklaratën se informatat janë të vërteta. Përveç kësaj emri dhe titulli i zyrtarit bankar duhet të shkruhet qartë në raport.

BQK do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të sigurojë se bankat komerciale dhe personat përgjegjës të cilët nuk i përmbushin obligimet e tyre sipas legjislacionit në fuqi dhe këtij udhëzimi do të i nënshtrohen masave ndëshkuese nga ana e BQK-së dhe lidhur me këto masa do ta njoftojë edhe gjykatën.

Bashkëpunimi- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe të gjitha Bankat Komerciale do të bashkëpunojnë ngushtë me të gjitha Gjykatat Themelore në Kosovë duke siguruar një përkrahje të ndërsjellë me qëllim ekzekutimin efikas të vendimeve gjyqësore.²⁵

6 Dokumenti përmbarrues (Titulli ekzekutiv) dhe Dokumenti i besueshëm

Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.²⁶

Dokumente përmbarruese janë:

- a) vendimi përmbarrues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përmbarrues;
- b) vendimi përmbarrues i dhënë në procedure administrative dhe aktpajtimi (më tej ujdia);
- c) dokumenti noterial i përmbarrueshëm në pajtim me ligjin për noterinë;
- d) marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës;
- e) aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të

²⁵ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (VENDIM 01-01/2011), Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi ekzekutiv i Bankës Qendrore, mbledhja e mbajtur me datë 26 janar 2011, lëshohet ky udhëzim. Shih. https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Udhezim-zbatimi%20i%20aktvendimeve%20per%20permbarrim.pdf

²⁶ Neni 21- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës;

- f) vendimet dhe marrëveshjet përbaruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata;
- g) kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit;
- h) vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përbarues evropian;
- i) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përbarues;²⁷

Kur flasim për vendimin dhe ujdinë, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurë gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdë gjyqësore konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit. Vendimi i organit administrativ, konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse akt pajtim administrativ konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë.²⁸

Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshëm po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare. Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për mosveprim ose veprim, është i përbarueshëm po qe se është bërë i formës së prerë. Organi përbarues kompetent mund përcaktoj një afat shtesë për përmbushjen e obligimeve të debitorit. Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë. Në bazë të vendimit i cili është bërë i përbarueshëm vetëm në një pjesë të tij, përbarimi mund të lejohet vetëm për sa i përket pjesës së tillë. Përbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përbarimin.²⁹ Po qe se e shqyrtojmë ujdinë, tek ujdia gjyqësore, akt pajtimi i lidhur në procedurën administrative, marrëveshja përbaruese e arbitrazhit, marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit apo

²⁷ Neni 22- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁸ Neni 23- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁹ Neni 24- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

marrëveshja e lidhur në procedurë tjetër është e përmbarueshme në qoftë se kredia të cilën duhet përmbushur sipas saj është bërë e arritshme. Arritshmëria e kredisë provohet me anë të procesverbalit për ujdinë, me anë të dokumentit publik, ose me anë të dokumentit të vërtetuar sipas ligjit, ku arritshmëria që nuk mund të provohet në mënyrën e caktuar provohet me anë të vendimit të formës së prerë, të dhënë në procedurën kontestimore me të cilin konsiderohet bazueshmëria e kredisë (kërkesës).³⁰

Kur dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim? Lirisht mund të themi se dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit, pra këto janë faktorët që kanë rëndësi të madhe që dokumenti përmbarimor të jetë i përshtatshëm për përmbarim. Në qoftë se me anë të dokumentit përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përmbarimin, dhe urdhrit për përmbarim, për shtatë (7) ditë.³¹

Kur flasim për dokumentet e besueshme, sikurse është e paraparë edhe me Ligjin për Procedurë Përmbarimore kemi disa dokumente të cilat nuk përcaktohen si dokumente përmbaruese por mund të parashtrohen për përmbarim. Këto dokumente quhen *dokumente autentike* apo *dokumente të besueshme*. Sipas praktikës së tanishme gjyqësore, në dokumente autentike përfshihen çequet, faturat, kambiali dhe çfarëdo dokumenti tjetër që plotëson karakteristikat e një fature të vlefshme. Dokumentet autentike më të shpeshta janë faturat nga kompanitë e shërbimeve komunale.³²

Një kreditor, me dokument autentik, mund të parashtrojë kërkesën për përmbarim pa shkuar më pare në kontest civil. Borxhi do të jetë i vlefshëm, i përcaktuar dhe i pagueshëm. Megjithatë debitori ka të drejtë të kundërshtojë dhe kundërshtimi do të shndërrojë procedurën përmbarimore në kontest civil.

Fillimisht dokumentet autentike mund të dorëzoheshin drejtpërdrejtë, për përmbarim vetëm për borxhet monetare midis dy etniteteve ligjore. Në fillim të viteve të 1990-ta, Ligji

³⁰ Neni 25- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

³¹ Neni 27- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

³² USAID. (2007, fq.24). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë.Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

për Procedurë Përmbartimore është ndryshuar për të mundësuar paraqitjen e dokumenteve autentike dhe kundër personave fizikë.³³

7 Mjetet e goditjes së vendimeve në procedurën përmbartimore

Në procedurën përmbartimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: *Prapësimi* dhe *Ankesa*.³⁴ Prapësimi mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të organit përmbartues me të cilin përmbartimi është i lejuar. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim, në Gjykatën themelore e cila ka lëshuar vendimin përmbartues kundër të cilit prapësimi është paraqitur kur organi përmbartues është Gjykata. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim në Gjykatën themelore në rastet kur organi përmbartues është përmbartuesi privat. Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të dhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet. Prapësimi duhet të përmbajë të dhënat e vendimit përmbartimor kundër të cilit është bërë ankesa, arsyet e prapësimit dhe nënshkrimin e debitorit³⁵. Prapësimi duhet të paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhërit përmbartues.³⁶ Të ndalemi pak tek shkaqet e prapësimit, ku prapësimi mund të bazohet vetëm nëse:

- dokumenti, në bazë të cilit është marrë vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë;
- dokumenti, në bazë të cilit është marrë vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik;
- palët, përmes dokumentit publik ose dokumentit të çertifikuar në pajtim me ligjin, të hartuar pas krijimit të dokumentit përmbartues, janë pajtuar që të mos kërkojnë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues për një periudhë kohore të kufizuar ose përgjithmonë;
- ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbartimi;
- përmbartimi është caktuar për sendet të cilat janë të përjashtuara nga përmbartimi i detyrueshëm dhe, si rezultat i këtij përjashtimi, mundësitë për kryerjen e përmbartimit janë të kufizuara;

³³ USAID. (2007, fq.25). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbartimore në Kosovë. Shih [http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pd](http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pd)

³⁴ Neni 67- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

³⁵ Neni 69- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

³⁶ Neni 70- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

- kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin kundër debitorit;
- kushti i përcaktuar në dokumentin përmbartues nuk është përmbushur, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj;
- kredia është shuar si rezultat i ndonjë fakti të shfaqur në kohën kur debitori më nuk ka mundur të paraqes faktin e tillë gjatë procedurës nga e cila ka derivuar vendimi, pas përmbjlljes së një ujdie gjyqësore ose një ujdie administrative ose në ndonjë mënyrë tjetër;
- realizimi i kredisë është shtyrë, ndaluar, ndryshuar ose parandaluar në ndonjë mënyrë tjetër, në mënyrë të përhershme ose për një periudhë të kufizuar kohore, si rezultat i ndonjë ngjarjeje që ka ndodhur në kohën kur debitori më nuk mund ta bënte të njohur në procedure në të cilën është nxjerr vendimi, respektivisht kredia është shuar pas lidhjes së një ujdie në Gjykatë ose në organin administrativ;
- kërkesa nga dokumenti përmbartues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve;
- Gjykata që ka marr vendimin për përmbartim nuk është kompetente;
- përmbartuesi që ka lëshuar urdhrin për përmbartim nuk është kompetent.³⁷

Prapësimin kundër vendimit për përmbartim Gjykata ia dërgon palës kundërshtare në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e dorëzimit të prapësimi. Gjykata u dërgon deklaratën e prapësimi dhe provat mbështetëse palës kundërshtare dhe të gjitha palëve tjera në procedurën e përmbartimit në një afat prej tre (3) ditësh, nga dita e pranimit të prapësimi. Në rastet kur prapësimi bëhet kundër veprimi të përmbartuesi privat, Gjykata gjithashtu i dërgon deklaratën e prapësimi dhe provat mbështetëse përmbartuesi privat. Përgjigjet lidhur me prapësimin duhet të paraqiten me shkrim brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita e pranimit të prapësimi nga palët.³⁸ Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht Gjykata mund të caktojë seance publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimi. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjia ndaj prapësimi të pranohet nga Gjykata. Mos harrojmë ta cekim faktin që vendimi për prapësim nxirret nga një gjyqtar i vetëm, ku me vendim prapësimi mund të pranohet,

³⁷ Neni 71- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

³⁸ Neni 72- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar.³⁹ Nëse e citojmë formën e prerë dhe përmbarueshmërinë e vendimeve në procedurën përmbarimore atëherë: *Vendimi kundër të cilit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prapësimi, bëhet i formës së prerë dhe i përmbarueshëm. Vendimi kundër të cilit është refuzuar prapësimi bëhet i përmbarueshëm, e po qe se kundër tij nuk lejohet ankesa, ai bëhet i formës së prerë. Vendimi me të cilin refuzohet prapësimi bëhet i formës së prerë, po qe se kundër tij nuk paraqitet ankesë brenda afatit ligjor, ose në qoftë se ankesa refuzohet si e pathemeltë.*⁴⁰ Kur jemi tek prezumimi për paraqitjen e prapësimit nga pala e tretë, një person tjetër nga debitori që pretendon se ka të drejtën lidhur me objektin e përmbarimit që nuk është në pajtim me përmbarimin e atij objekti mund ta paraqes prapësimin kundër përmbarimit, me kërkesë që përmbarimi për objektin e përmbarimit të shpallet i palejueshëm në pjesën me të cilën është përfshirë e drejta e tij. Prapësimi mund të paraqitet deri në përfundimin e procedurës përmbarimore.⁴¹ Palët kanë të drejtë ankesë kundër vendimit mbi prapësimin. Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit. Një kopje e ankesës u dorëzohet palës kundërshtare dhe pjesëmarrësve tjerë të cilët mund të paraqesin përgjigje në ankesë në afat prej tre (3) ditëve. Pas pranimit të përgjigjes në ankesë ose pas kalimit të afatit për përgjigje, lënda së bashku me të gjitha shkresat tjera i dërgohet Gjykatës së shkallës së dytë në afat prej tre (3) ditësh. Lidhur me ankesën, Gjykata e shkallës së dytë do të vendosë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve. Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë. Në rast se debitori si palë ankuese është i suksesshëm në ankesën e tij dhe nëse pasuria e tij është përmbaruar në pajtim me vendimin përmbarimore, ai mund të kërkojë kundër përmbarim sipas dispozitave të këtij ligji për kundër përmbarimin.⁴²

8 Procedura a kundërpërmbarimit

Kundërpërmbarimi është mjet juridik i cili u ofrohet debitorëve për rastet në të cilat përmbarimi është kryer plotësisht para se debitori të ketë pasur mundësinë ta kundërshtojë.

³⁹ Neni 73- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁴⁰ Neni 74- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁴¹ Neni 75- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁴² Neni 77- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Qëllimi i kundërpërbarimit është që t`i kthehet debitorit çfarëdo përfitimi të cilin e ka fituar kreditori por që nuk është dashur ta fitojë përmes përbarimit.⁴³

8.1 Shkaqet për kundër përbarim

Debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përbarimore edhe pasi të ketë përfunduar përbarimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t`ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përbarimit, në qoftë se dokumenti përbarues me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar ose në ndonjë mënyrë tjetër kur konstatohet se është pa efekt juridik. Pastaj në rastet kur aktvendimi apo urdhri për përbarim me anë të vendimit të formës së prerë është anuluar apo ndryshuar, në rastet kur kreditori gjatë kryerjes së procedurave përbaruese, ka marrë më shumë se sa vlera e kredisë, përfshirë kostot e përbarimit dhe kamatat. Rasti tjetër që mund të përmendet është kur përbarimi i kryer në një objekt specifik të përbarimit është i palejuar. Në qoftë se kreditori me anë të përbarimit e ka realizuar një shumë të hollash, debitori në propozimin për kundër përbarim mund të kërkojë pagimin e kamatëvonesës që nga dita e pagimit të shumës së tillë. Propozimi për kundër përbarim mund të paraqitet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita në të cilën debitori ka marrë dijani për shkakun e kundër përbarimit por jo më vonë se një (1) vit nga dita e përfundimit të procedurës përbarimore. Pas skadimit të afatit të paraparë me ligj, debitori nuk mund të fillojë kundër përbarimin, por duhet të fillojë procedurën kontestimore për kërkesën e tij.⁴⁴

8.2 Procedura sipas propozimit për kundër përbarim

Propozimin për kundër përbarim Gjykata ia dërgon kreditorit dhe kërkon nga ai që brenda afatit prej tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të deklarohet lidhur me propozimin e tillë. Nëse procedura e përbarimit kryhet para përbaruesit privat, përbaruesi privat pa vonesë dërgon një kopje të dosjes te Gjykata kompetente dhe njofton palët se procedura sa i përket propozimit për kundër përbarim vazhdon para Gjykatës kompetente. Po qe se brenda afatit kreditori e kundërshton propozimin për kundër përbarim, atëherë Gjykata për të vendos pas mbajtjes së seancës gjyqësore. Me aktvendim me të cilin miratohet propozimi për kundër përbarim Gjykata e urdhëron kreditorin që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh t`ia kthejë debitorit, respektivisht personit të tretë atë që e ka marrë me anë të përbarimit.

⁴³ USAID. (2007, Fq.76). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përbarimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

⁴⁴ Neni 54- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Aktvendimin e këtillë Gjykata e nxjerrë edhe po qe se kreditori i përmbarrimit nuk deklarohet fare brenda afatit të caktuar, ose kur deklarohet se nuk e kundërshton propozimin për kundër përmbarrim.⁴⁵ Në cilat raste propozimi për kundër përmbarrim nuk do të pranohet? Me plot kuptimin e fjalës mund të themi që propozimi për kundër përmbarrim nuk do të pranohet po qe se me të kërkohet kthimi i sendit lidhur me të cilin kanë ndodhur ndryshime të atilla materiale apo juridike të cilat e bëjnë të pamundur kthimin e tij.⁴⁶

8.3 Kundër përmbarrimi sipas propozimit të personit të tretë

Personi nga pasuria e të cilit është realizuar kredia e kreditorit, e i cili nuk ka qenë i cilësuar si debitor në aktvendimin për përmbarrim ka të drejtë që brenda afateve të parapara, të kërkojë nga Gjykata që ta urdhërojë kreditorin që t'ia kthejë gjithë atë që i është dhënë me anë të përmbarrimit të përfunduar. Në këtë procedurë të kundër përmbarrimit propozuesi quhet kreditori i përmbarrimit, kurse kundërshtari i propozuesit quhet debitor. Kundër përmbarrimi mund të inicohet edhe sipas propozimit të pjesëmarrësit në përmbarrim, ku pjesëmarrësi në procedurën përmbarrimore ka të drejtë që brenda afateve të përmendura më lartë, pasi të ndryshohet me anë të vendimit të formës së prerë aktvendimi për përmbarrimin të kërkojë nga Gjykata që ta urdhërojë personin të cilin i është paguar shuma e caktuar e të hollave, që shuma e tillë t'i kthehet atij. Në procedurën e kundër përmbarrimit të këtillë propozuesi quhet kreditor, kurse kundërshtari i propozuesit quhet debitor.⁴⁷

9 Shtyerja, pezullimi dhe përfundimi i përmbarrimit

9.1 Shtyerja e përmbarrimit sipas kërkesës së kreditorit

Po qe se me ligj nuk është paraparë ndryshe, organi përmbarrues mund të shtyjë pjesërisht apo tërësisht përmbarrimin sipas kërkesës së kreditorit, por vetëm në qoftë se ende nuk ka filluar të zbatohet aktvendimi për përmbarrimin apo urdhri për përmbarrim. Kur në procedurën e përmbarrimit marrin pjesë më tepër kreditor e vetëm ndonjëri nga ta e kërkon shtyrjen, atëherë organi përmbarrues e shtyn përmbarrimin vetëm për atë që i përket kreditorit të tillë. Organi përmbarrues vendos për kërkesën për shtyrje me konkluzë.⁴⁸

⁴⁵ Neni 55- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁴⁶ Neni 57- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁴⁷ Neni 58- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁴⁸ Neni 60- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

9.2 Shtyerja e përmbarimit sipas kërkesës së debitorit

Në rastet kur debitori argumenton se zbatimi do t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm, organi përmbarues plotësisht ose pjesërisht do të shtyjë përmbarimin kur:

- është parashtruar ankesë kundër dokumentit përmbarues dhe pala ankuese i demonstroi Gjykatës së shkallës së parë se ka mundësi bindëse për të qenë e suksesshme në ankesë, apo
- Gjykatës i është parashtruar kërkesa për të anuluar një vendim të arbitrazhit në pajtim me Ligjin për Arbitrazhin.

Dorëzimi i kërkesës për shtyrje të përmbarimit nuk shtyn zbatimin e përmbarimit. Para lejimit të shtyrjes së përmbarimit, organi përmbarues do t'i sigurojë kreditorit të drejtën që të deklarohet në lidhje me të dhe të jep dëshmi në kundërshtim të shtyrjes. Vlen të ceket që organi përmbarues mundet plotësisht ose pjesërisht ta shtyjë përmbarimin në situatë ku debitori dëshmon përmes dokumenteve publike ose të vërtetuara se përmbarimi do t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm dhe jep si garanci shumë e cila së paku korrespondon me shumën e kërkesës. Në rrethanat të tjera dmth përveq atyre që i përmendëm, organi përmbarues mundet të kushtëzojë shtyrjen pasi që debitorit ti jep si garanci shumë e cila së paku korrespondon me shumën e kërkesës dhe kamatës. Në qoftë se organi përmbarues ka shtyrë përmbarimin e një kërkesë jomonetare me kusht të pagesës së një garancie, ajo përcakton shumën e garancisë në lidhje me të gjitha rrethanat e rastit. Organi përmbarues vendos mbi një kërkesë për shtyrjen e përmbarimit brenda pesë (5) ditëve nga marrja e saj.⁴⁹

9.3 Shtyerja e përmbarimit sipas kërkesës së palës së tretë

Personi i tretë mund të parashtrorë kërkesë për shtyrjen e përmbarimit nën kushtet e parapara me ligj. Vendimi i organit përmbarues për të shtyrë përmbarimin në bazë të kërkesës së personit të tretë do të dërgohet kreditorit dhe debitorit.⁵⁰

Përmbarimi i shtyrë mund të rifillojë me kërkesë të palës që ka kërkuar shtyrjen para skadimit të periudhës së shtyrjes. Në ato raste, pala tjetër njoftohet për rifillimin e procedurës përmbarimore përmes dërgesës standarde me postë në adresën e fundit të regjistruar të asaj pale. Po qe se kreditori nuk e kërkon vazhdimin e procedurës as pas pesëmbëdhjetë (15)

⁴⁹ Neni 61- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁵⁰ Neni 62- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

ditësh nga dita e skadimit të afatit për të cilin është shtyrë përmbarimi, atëherë organi përmbarues do ta ndërpres procedurën e rastit të përmbarimit me vendim.⁵¹

10 Pezullimi i procedurës së përmbarimit

Përveç nëse parashihet ndryshe me ligjin për procedurë përmbarimore, përmbarimi pezullohet sipas detyrës zyrtare në këto rrethana:

1. kur debitori apo pasuritë e tij nuk mund të gjenden për qëllime të njoftimit dhe sekuestrimit të pasurisë brenda tre (3) muajve nga fillimi i rastit të përmbarimit, përkundër faktit se janë bërë së paku dy (2) tentime nga organin përmbarues që të gjej atë person për qëllime të njoftimit apo sekuestrimit të pasurisë;
2. kur është tentuar nga organi përmbarues që të zbatohet përmbarimi i vendimit së paku dy (2) herë pa arritur asnjë rezultat të synuar nga këto veprime;
3. kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përmbarim vërtetohet se është e pasaktë ndërsa kreditori nuk mund të argumentojë para organit përmbarues saktësinë e adresës.

Procedura e pezulluar me konkluzion mund të vazhdojë nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar.⁵²

11 Përfundimi i procedurës së përmbarimit

Në qoftë se me ligj nuk është paraparë ndryshe, përmbarimi do të përfundojë sipas detyrës zyrtare nëse dokumenti përmbarimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt, apo në qoftë se vërtetimi për përmbarueshmërinë e tij anulohet me vendim të formës së prerë. Përmbarimi do të përfundohet sipas detyrës zyrtare edhe kur në pajtim me dispozitat ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet detyrimore, personi i tretë e përmbushë obligimin në dobi të kreditorit në vend të debitorit. Përmbarimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashikimit për përmbarim. Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit, nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore.⁵³

⁵¹ Neni 64- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁵² Neni 65- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁵³ Neni 66- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

KREU II

II. E DREJTA PËRMBARUESE GJYQËSORE

1 Nocioni i së drejtës përmbarese gjyqësore

E drejta përmbarese gjyqësore përfshin tërësinë e normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet proceduralo-juridike dhe substancialo-juridike që krijohen gjatë procedurës përmbarese gjyqësore dhe lidhur me të. E drejta përmbarese gjyqësore procedurale përfshinë tërësinë e normave juridike me anë të cilave rregullohen prezumimet procedurale, marrëdhëniet e ndërsjellta dhe efektet proceduralo-juridike të veprimeve që i kryejnë subjektët e procesit përmbarese.⁵⁴

2 Raporti në mes të procedurës përmbarese gjyqësore dhe procedurës kontestimore

Në teorinë procedurale ekzistojnë dy pikëpamje lidhur me raportin midis procedurës përmbarese dhe procedurës kontestimore. Sipas pikëpamjes së parë, procedura përmbarese është pjesë përbërëse e procedurës kontestimore, në të vërtetë sipas përfaqësuesve të kësaj pikëpamje procedura përmbarese është vetëm vazhdim i procedurës kontestimore. Ndërsa sipas pikëpamjes së dytë procedura përmbarese është procedurë e posaçme gjyqësore civile, e cila dallohet esencialisht nga procedura kontestimore për nga prezumimet, efektet, qëllimet dhe për nga natyra juridike e saj. Këto dy pikëpamje historikisht janë të kushtëzuara. Në të drejtën romake procedura përmbarese ishte procedurë e pavarur nga ajo kontestimore dhe procedurat e tjera të kognicionit. Në Mesjetë, por edhe më vonë deri në kodifikimet e shek. XIX, procedura përmbarese konsiderohej pjesë e procedurës kontestimore, vazhdim i saj dhe për iniciimin e saj mjaftonte një propozim joformal. Kodi Austriak (1986), dhe më vonë edhe Kodi Jugosllav (1930), i cili ishte bazur në atë austriak e pranojnë pikëpamjen e dytë, sipas të cilës procedura përmbarese është procedurë e posaçme dhe e pavarur nga ajo kontestimore. Shkenca e kohëve të sotme e pranon mëvetësinë e procedurës përmbarese gjyqësore si metodë për ekzekutimin e vendimeve kondemnatore. Edhe pse të dy procedurat kanë për detyrë dhënien e mbrojtjes juridike, qëllimet e tyre janë të kundërta. Detyrë e procedurës kontestimore është hetimi i ekzistimit të kushteve për dhënien e

⁵⁴ Brestovci, F. (2004, fq.155). E drejta Procedurale Civile. Prishtinë.

mbrojtjes juridike dhe konstatimi i përmbajtjes së saj, kurse detyrë e procedurës përmbimore është realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar.⁵⁵

3 Juridiksioni i gjykatave

Neni 3 i LPP parasheh që përmbarimin e caktojnë dhe zbatojnë gjykatat e rregullta.

3.1 Kompetenca lëndore

Sipas Nenit 26 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta (1976), gjykatat komunale janë kompetente të vendosin mbi procedurën përmbimore nëse nuk është paraparë ndryshe. Një përjashtim parashihet në Nenin 30 të po këtij Ligji, i cili parasheh se për përmbarimin është kompetente Gjykata Ekonomike, nëse janë përmbushur tri kriteret:

1. kur edhe debitori edhe kreditori janë persona juridik;
2. kur kontesti ka të bëjë me veprimtari biznesi; dhe
3. kur masat e përmbarimit vlejnë për pasurinë monetare apo të luajtshme.

Nëse nuk plotësohet një nga këto kriteret (p.sh nëse përmbarimi kërkohet për prone të paluajtshme), atëherë kompetente është Gjykata Komunale. Ankesat i parashtrihen Gjykatës së Qarkut. Në shkallën e dytë, për rastet vendos trupi gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë profesional. Gjykata Supreme e Kosovës, kur vendos lidhur me kërkesën e parashtruar kundër vendimit mbi procedurën e përmbarimit, aplikon dispozitat e nenit 44 të LPK.⁵⁶

3.2 Kompetenca territoriale

LPP parasheh parimin e kompetencës territoriale, në bazë të vendit ku ndodhen mjetet e përmbarimit⁵⁷. Ky parim krijon thjeshtësi dhe efikasitet në punën e gjykatës sepse garanton që gjykata e cila vendos për përmbarimin është gjykata e njëjtë e cila i zbaton masat e përmbarimit.

Tabela e mëposhtme shpjegon se cila gjykatë është kompetente, varësisht prej mjeteve të përmbarimit, të kërkuara në propozim.

⁵⁵ Brestovci, F. (2004, fq.164). E drejta Procedurale Civile. Prishtinë.

⁵⁶ USAID. (2007, Fq.20). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

⁵⁷ USAID. (2007, Fq.20). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

Mjetet e përmbartimit	Kompetenca territoriale	Neni i LPP
Sendet e luajtshme	Gjykatat në territorin e së cilës ndodhet sendet.	69
Kërkesa në të holla (debitori në Kosovë)	Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit.	91
Kërkesa në të holla (debitori jashtë Kosovës)	Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit të debitorit. (P.sh. nëse debitori ka të holla të depozituara në ndonjë bankë në Kosovë por vet nuk jeton në Kosovë, kërkesa mund t`i parashtrohet gjykatës në territorin e së cilës gjendet banka.)	91
Dorëzimi i sendeve të paluajtshme ose kthimi i paluajtshmërisë	Gjykata në territorin e së cilës ndodhen sendet.	128
Sendet e paluajtshme	Gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria.	140
Zbrazja dhe dorëzimi i pasurisë së paluajtshme	Gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria.	219
Kthimi në vendin e punës	Gjykata në territorin e së cilës ndodhet punëdhënësi.	229
Detyrimi i veprimit/mosveprimit	Gjykata në territorin e së cilës debitorit duhet të veprojë ose të mos veprojë.	223
Ndarja e pasurisë së paluajtshme ose trashëgimia e përbashkët	Gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria.	238

Në rast se kreditori nuk ka informata mbi vendndodhjen e sendeve të luajtshme të debitorit me rastin e parashtrimit të kërkesës në gjykatë, LPP parasheh që kreditori mund të parashtrorë kërkesën për përmbartim pranë gjykatës në territorin e së cilës debitori e ka vendbanimin (neni 70 LPP). Derisa informatat mbi vend ku ndodhen sendet janë të dëshirueshme, kjo nuk përbënë element obligues të propozimit mbi përmbartimin, siç parashihet me Nenin 35 al.2 të LPP.

3.3 Jokompetenca

Gjykata mund të provojë jo kompetencën para dhe pas lejimit të përmbarimit. Jo kompetenca mund të provohet në bazë të kompetencës lëndore (p.sh lënda nuk është objekt i përmbarimit) ose në bazë të kompetencës territoriale.⁵⁸

Para lejimit të përmbarimit: Gjatë shqyrtimit të propozimit për përmbarim, rëndësi të veçantë duhet kushtuar kompetencës.

Duhet të parashtrihen këto pyetje:

- A është i përshtatshëm për përmbarim dokumenti i parashtruar?
- A është lënda përbrenda juridiksionit të Gjykatës Ekonomike?
- Nëse përmenden sendet, a janë këto sende të përmendura si objekt të përmbarimit, nën kompetencën territoriale të gjykatës? Nëse nuk përmenden sendet, a e ka debitori vendbanimin nën kompetencën territoriale të gjykatës?

Nëse përgjigja në ndonjërin nga këto pyetje tregon jo kompetencën e gjykatës, atëherë përmbarimi duhet të refuzohet dhe kreditori duhet të udhëzohet që ta paraqesë rastin e tij te gjykata kompetente. Zyrtarët e përmbarimit dhe gjyqtarët mund të kursejnë kohën dhe energjinë duke e verifikuar kompetencën para se ta lejojnë përmbarimin.

Pas lejimit të përmbarimit: Gjykata mund të njoftohet *ex officio* ose me kundërshtim të debitorit për jo kompetencën. Jo kompetenca rregullohet me LPK të zbatueshëm, gjegjësisht me Nenin 14 të LPP. Neni 16 i LPK parasheh se ``gjatë tërë kohës së procedurës, gjykata duhet t'i kushtojë kujdes se a hyn zgjedhja e kontestit në kompetencën e gjykatës``. Nëse gjatë procedurës, gjykata e vëren se rasti hyn në kompetencën e ndonjë organi tjetër vendor ose ndërkombëtar, atëherë ajo shpallet jo kompetente, i pezullon veprimet e ndërmarra në procedure, dhe hedh poshtë padinë. Ky nen parasheh se gjykata, në çdo kohë, kur kupton se është jo kompetente, e përfundon rastin dhe të njëjtin ia përcjellë gjykatës kompetente vendore apo ndërkombëtare.⁵⁹

Nëse jo kompetenca është vërtetuar në bazë të kundërshtimit të debitorit, atëherë gjykata do ta abrogojë vendimin e saj mbi lejimin e përmbarimit dhe do t'i pezullojë të gjitha veprimet e saj, të ndërmarra në bazë të këtij vendimi. Propozimi për përmbarim do t'i bartet

⁵⁸ USAID. (2007, Fq.21). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

⁵⁹ USAID. (2007, Fq.22). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

gjykatës kompetente pasi që vendimi mbi jo kompetencën ta ketë marrë formën e prerë (neni 53 LPP).

Në rastet e veçanta, kur debitori gjendet jashtë Kosovës, atëherë, për njoftim apo për bartjen e lëndës deri te gjykata kompetente, mund të përdoren kanalet apo rrugët diplomatike.⁶⁰

Qarkoja e Drejtësisë 2003/03 ka rregulluar asistencën ndërkombëtare për çështjet civile dhe penale. Sipas kësaj Qarkoreje, kërkesat me shkrim duhet të bëhen nga ana e gjykatës për Drejtorin e Departmentit të Drejtësisë i cili pastaj ua përcjell ato autoriteteve përkatëse. Qarkoja udhëzon gjykatat që të lejojnë 3-4 muaj për procedimin e kërkesës për njoftim, por ky afat kohor është vetëm sugjerim. Në praktikë, këto procedura janë raportuar sit ë paefektshme dhe kanë shkaktuar vonesa të mëdha. Kur debitorët gjenden jashtë Kosovës, atëherë kemi dy situata:

1. Gjykata ka dëshmi se as debitori as sendet e tij nuk janë në Kosovë: Në këtë rast, gjykata duhet të shpallet jo kompetente dhe të përmbyllë rastin. Lënda i dërgohet Departamentit të Drejtësisë për bartje me juridiksionin kompetent me qëllim të përbarimit. Si alternativë, nëse rrugët diplomatike nuk funksionojnë, gjykata do ta përmbyllë rastin dhe do ta udhëzojë kreditorin që kërkesën e re t'ia parashtrijë juridiksionit kompetent.
2. Gjykata ka dëshmi se debitori ndodhet jashtë Kosovës por disa nga sendet e tij gjenden në Kosovë: Në këtë rast gjykata e procedon rastin, por me qëllim të njoftimit duhet t'i shfrytëzojë rrugët diplomatike. Njoftimi dërgohet përmes Departamentit të Drejtësisë.

Në bazë të një ankete, me gjyqtarët, nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në vjeshtë të vitit 2006, shihet se ka qasje kundërthënëse lidhur me aplikimin e procedurave, kur debitori dhe sendet e tij gjenden jashtë Kosovës. Për qëllime praktike, është e rëndësishme të merret parasysh se gjykatat mund ta zbatojnë përbarimin e vendimeve në suaza të kompetencave territoriale. Lejimi dhe tentimi që të zbatohet përbarimi, në rastet kur dëshmitë tregojnë se debitori është jashtë juridiksionit të gjykatës (kur hyn në juridiksionin e ndonjë gjykate tjetër

⁶⁰ USAID. (2007, Fq.22). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përbarimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

në Kosovë ose jasht Kosovës) krijon një barrë të panevojshme për gjykata dhe i mohon të drejta kreditorit për përmbushje të shpejtë.⁶¹

4 Zbatimi i akteve ndërkombëtare në përmbarimin e vendimeve gjyqësore

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila gjykon çështjet ligjore që dalin nga rastet vendore dhe që përfshijnë çështjet penale dhe civile, ka gjetur se procedurat përmbarimore duhet të shihen si pjesë e konventës integruese e gjykimit për qëllime të nenit 6 të konventës.

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut është shumë e qartë në interpretimin e kësaj dispozite: Do të ishte e pa konceptueshme që neni 6 paragrafi 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedural që i akordohen palëve në procedurë që të jenë të drejta, publike dhe ekspeditive, nëse nuk mbrohet zbatimi i aktvendimeve gjyqësore. Nëse interpretohet neni 6 se ka të bëjë vetëm me qasjen në gjykatë dhe kryerjen e procedurave, kjo do të çojë në situatë të papërputhshme me parimin e sundimit të ligjit që është marrë përsipër nga shtetet kontraktuese e që duhet respektuar gjatë ratifikimit të konventës. Përmbarimi i aktvendimit të nxjerrë nga cilado gjykatë duhet të shihet si pjesë integrale e ``gjykimit`` dhe gjykata tanimë ka pranuar këtë parim në rastet në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës. Këtu mund ta cekim rastin e Delcourt kundër Belgjikës, ku gjykata deklaroi se: `` në një shoqëri demokratike brenda kuptimit të konventës, e drejta për ushtrim të drejtë të drejtësisë në një vend kaq të rëndësishëm sa një interpretim të kufizuar nuk do ti korrespondojë synimit dhe qëllimit të asaj dispozite.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 22 parasheh: `` Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike``. Në bazë të

⁶¹ USAID. (2007, Fq.23). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

kësaj, mund të përmendet në veçanti neni 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili ka të bëjë edhe me çështjet civile.⁶²

Vendi ynë gjatë reformimit të sistemit të drejtësisë ka bërë harmonizimin e ligjeve me ato të BE-së dhe në kuadër të kësaj në Ligjin për procedurën përmbartimore nr.04/L-139 ka marrë për bazë rekomandimet e Këshillit të Evropës për përmbartimin, duke paraparë ndryshime organizative, duke ofruar mekanizma më efikase të përmbartimit, zhvillim gradual të infrastrukturës ligjore dhe logjistike, duke besuar se standardet e llogaridhënës, vlerësimit dhe performances janë të një rëndësie jetike për një system efikas të përmbartimit.⁶³

Më 17 dhjetor 2009, Komisioni Evropian për efikasitet CEPEJ ka botuar një udhëzues për zbatim më të mirë të rekomandimit të Këshillit të Evropës për përmbartimin. Rekomandimi (dhe udhëzimet) bazohet në efikasitet, transparencë dhe kuptim të lehtë të tij. Por ai nuk përshkruan sistemin ideal. Nuk ekziston sistemi ideal për përmbartim. Por ajo çka është e mundshme, është parashikimi i bazës dhe parimeve të përmbartimit. Si të tilla, këto rekomandime dhe udhëzime mund të shfrytëzohen për të vlerësuar procedurat dhe praktikat e përmbartimit. Është e qartë se rekomandimi REC (2003)17 dhe udhëzimet nuk kanë force obliguese, megjithatë ai mund të merret si pikë referente për përkufizimin e mëtejshëm të një sistemi efektiv dhe efikas të përmbartimit. Rekomandimi dhe udhëzimet parashkruajnë një numër të parimeve udhëzuese në lidhje me përmbartimin. Veçanërisht ai parashkruan disa parime dhe standarde në lidhje me përkufizimin, gamën ligjore të aplikimit të rekomandimit, procedurën e përmbartimit dhe zyrtarët përmbartimor. Ndoshta rekomandimet dhe udhëzimet mund të konsiderohen si *Rregullore* apo *Udhëzues*. Sistemet kombëtare janë aq të ndryshme sa që është shumë vështirë për të krijuar një system ideal përmbartimor apo zyrtar idela përmbartimor.⁶⁴

⁶² Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.111). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrmbartimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

⁶³ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.112). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrmbartimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

⁶⁴ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.112). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrmbartimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

5 Përmbartimi i vendimeve gjyqësore nga organet gjyqësore

Sa i përket kompetencës në praktikën gjyqësore ka pasur interpretime të ndryshme, se me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për procedurë përmbartimore nr.04/L-139 kreditorët a kanë të drejtë që për të gjitha çështjet prapë ti drejtohen gjykatës. Në nenin 5 parag.2 të këtij ligji citohet: *Gjykata kompetente ka kompetencë lëndore për të urdhëruar dhe për të kryer përmbartimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës në pajtim me dispozitat e këtij Ligji përveq nëse gjykatat dhe autoritetet tjera përmbartuese kanë juridiksionin për të urdhëruar dhe për të kryer përmbartimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës.* Ndërsa në nenin 5, parag.6 citohet: *Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbartimit dhe të zbatoj përmbartimin e vendimeve gjyqësore lidhur me:*

- Të gjithë çështjet nga e drejta familjare;
- Kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera;

Kjo dispozitë është dispozitë përjashtuese, që gjykata të vendosë në çështje tjera përveq nëse është paraparë që me ligj të vendos për çështje tjera.⁶⁵ Këto çështje të tjera janë si p.sh për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi ne procedurën përmbartuese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbartuesi privat , kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbartimi.⁶⁶ Sa i përket çështjes së vendosjes kun ë procedurën e përmbartimit në shkallë të parë e udhëheqë dhe për të vendos përmbartuesi privat, ndërsa përjashtimisht gjyqtari individual (i vetëm) kur me këtë Ligj është caktuar se përmbartimin e cakton dhe e zbaton gjykata (organi i shkallës së parë), është përcaktuar edhe një afat ku organi përmbartues vendosë për propozimin e përmbartimit brenda afatit prej 7 ditëve pas pranimit të propozimit.

⁶⁵Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.113). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrmbartimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

⁶⁶ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.114). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrmbartimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

Sipas dispozitës së lartëcekur në shkallën e dytë vendimet i nxjerrë gjyqtari individual, që nuk ka qenë praktikë e deri tashme kur dihet se në shkallën e dytë vendos kolegji për shqyrtimin e ankesës.⁶⁷

6 Sistemi i përmbarimit në Shqipëri

Para se të ndalemi tek sistemi jonë aktual i përmbarimit, pra tek përmbarimi në legjislacionin e Kosovës, tani do të njoftohemi me sistemet e përmbarimit në disa vende fqinje, pasi që tek shtjellimi i përmbarimit aktual në legjilacionin e Kosovës do të thellohemi më shumë.

Në këtë pjesë do të përshkruajmë problemet me të cilat përballen vendet fqinje në procedurën e përmbarimit, do të cekim zgjidhjet e ndryshme të cilat i kanë gjetur vendet fqinje me qëllim të përmirësimit të sistemit të përmbarimit.⁶⁸ Po fillojmë me Shqipërinë.

Raportet e progresit të Komisionit Evropian janë shumë të qarta kur jemi tek gjendja e përmbarimit në Shqipëri: Mungesa e zyrtarëve dhe pajisjeve për agjentët përmbarimor dhe ndihma e pamjaftueshme nga autoritet tjera, siç janë policia dhe Zyra për regjistrim të pronës së paluajtshme, pengon përmbarimin e aktvendimeve, i cili mbetet i ngadalshëm.

Përmbarimi i aktvendimeve të gjykatës në rastet që përfshijnë institucionet e shtetit, shpeshherë merr më gjatë sesa gjashtë muaj, sa është e lejuar me ligj. Planet për të reformuar sistemin e agjentëve përmbarimor ende nuk janë përfshirë në ligjin e ri. Është përgaditur një ligj për privatizimin e sistemit të agjentëve përmbarimor për përmbarimin e vendimeve të gjykatës civile. Megjithatë, përmbarimi i aktgjykimeve nga zyrtarët përmbarimor mbetet i ulët. Gjithashtu në raportin e Bankës Botërore për afarizëm në vitin 2008, Shqipëria është rradhitur e 74-ta në seksionin e përmbarimit të kontratave. Raporti i afarizmit për vitin 2008 deklaroi se procesi përmbarimor i Shqipërisë duhet të kalojë përmes 39 procedurave (praktika më e mire është 20) dhe zgjatë 390 ditë (praktika më e mire është 120 ditë). Janë identifikuar një sërë problemesh. P.sh. përmbarimi përmes pasurisë së paluajtshme që është kritikuar nga kreditorët, bankat dhe vet agjentët përmbarimor. Sipas dispozitave të vjetra (neneve 560-580 KPP) te përmbarimi në pronë të paluajtshme, anije dhe aeroplan agjenti përmbarimor është i

⁶⁷ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.114). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrbarimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

⁶⁸ Programi për Sistemin e Përmbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.126).

përfshirë në përmbarrimin e pasurisë së paluajtshme. Këtu u paraqitën disa probleme. Së pari, metoda e shitjes shkaktoi probleme. Sipas KPP-së, kishte mundësi që të organizohen dy ankande: Për këto ankande publike, duhet të përcaktohet vlera e pasurisë së paluajtshme. Ja këtu ishte problemi: Nuk kishte pako të standardeve për një vlerësim të tillë. KPP tani është plotësuar dhe ndryshuar dhe Këshilli i Ministrave e ka miratuar Rrregulloren. Problemi tjetër shfaqet kur nuk ka blerës në shitjen publike. Në rast të tillë, kreditori mund të marrë posedimin e pasurisë së paluajtshme në çmim të caktuar, në shkëmbim të borxhit. Kreditori mund të refuzojë, megjithatë në raste të tilla, përmbarrimi në pasuri të paluajtshme konsiderohet se ka përfunduar. Kjo nënkupton se kreditori duhet të kërkojë mënyra tjera të përmbarrimit, prandaj kreditorët janë të detyruar në mënyrë indirekte që të marrin pronësinë mbi pronën e paluajtshme. Kur vlera e pasurisë së paluajtshme është me e lartë sesa borxhi, kreditori duhet t'i paguajë debitorit dallimin në mes të vlerës së vlerësuar dhe shumës së borxhit.⁶⁹ Cilat janë pasojat? Së pari problemet ngritin koston për kreditorin ku ekipi i projektit për bankat ka identifikuar disa ndikime edhe në ekonominë vendore.⁷⁰ Në vitet e 90-ta, bankat shtetërore jepnin hua të mundësuar investime në projektet bujqësore dhe projektet tjera. Kur u shpërbën bankat shtetërore, ATK-ja u krijua me qëllim të kthimit të huave. Huat zyrtarisht janë siguruar përmes pasurisë së paluajtshme. Kjo nënkupton se edhe shteti, si kreditor (përmes ATK-së), është i përfshirë në përmbarrimin e pasurisë së paluajtshme. Në ligj janë bërë disa ndryshime edhe në këtë kuptim: Në rast se nuk paraqitet asnjë ofertues në ankandin e dytë, zyrtari përmbarrimor i propozon së pari kreditorit që të marrë objektin në emër të kredisë në çmimin e ankandit të dytë. Por, nëse kreditori nuk dëshiron të marrë objektin, zyrtari përmbarrimor e heq konfiskimin ndaj këtij objekti dhe ia kthen atë objekt debitorit dhe vazhdon me procedurat e përmbarrimit mbi pronat tjera të tij.

Shteti është gjithashtu i përfshirë si debitor, gjë që tanimë e pamë te jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: legjislacioni për kompensim të kthimit të pronës. Shteti ka pozitën e veçantë në procedurat përmbarrimore: përmbarrimi i detyrimeve në para kundër institucioneve buxhetore bëhet vetëm në xhirollogaritë e tyre përkatëse bankare apo në mjetet që ato i kanë të palët tjera. Nuk lejohet përmbarrimi në prone të luajtshme apo të paluajtshme të institucionit buxhetor. Kur institucioni buxhetor nuk ka para në xhirollogari

⁶⁹ Programi për Sistemin e Përmbarrimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.127).

⁷⁰ Programi për Sistemin e Përmbarrimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.127).

bankare , dhe nuk ka mjete te palët e treat, kërkohet nga organi përkatës më i lartë financiar që të ndaj fondet e nevojshme nga të cilat do të paguhet detyrimi.⁷¹

Kur jemi tek korniza ligjore, procedura e përbarimit bazohet në dispozitat e Kodit të procedurës civile. Për organizimin e përbarimit u miratua ``Ligji për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përbarimit gjyqësor me agjentë`` dhe aktet tjera nënligjore që e plotësojnë këtë ligj. Ky ligj u miratua në vitin 2001. Sipas këtij ligji, përbarimi tani është nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë. Akti më i rëndësishëm nënligjor është ``Rregullorja e brendshme për shërbimin e përbarimit me agjentë`` (2003).

Më 9 shtator 2005, Kryeministri i Shqipërisë Prof.Dr. Sali Berisha paraqiti para parlamentit Programin e qeverisë për periudhën 2005-2009. Programi gjithashtu i kushtoi rëndësi sistemit të përbarimit dhe konkludoi se duhet t'i jepet prioritet ``ristrukturimit dhe përforcimit të kapaciteteve të zyrës së agjentëve përbarimor dhe krijimit të mundësive për sektorin privat në këtë fushë``.⁷² Më 11 dhjetor 2008, Parlamenti shqiptar miratoi Ligjin e ri për shërbimin privat të përbarimit gjyqësor. Gjer tani organizimi i përbarimit ishte jashtë gjykatës, së paku në teori. Ndonëse zyrat, sipas ligjit, nuk konsiderohen pjesë e gjykatave, në shumë raste ato janë plotësisht të ndara nga gjykatat. Në nivelin qendror ekziston drejtoria brenda Ministrisë së Drejtësisë, që quhet Drejtoria e përgjithshme e përbarimit. Ajo përbëhet nga Drejtori i përgjithshëm, zëvendës drejtori i përgjithshëm, njësia për financa apo buxhet, sektori i inspektimit, dhe stafi mbështetës siç janë sekretarët dhe vozitësit. Në nivel lokal janë 29 zyra të agjentëve përbarimor. Zyrat gjenden nëpër qytetet ku janë të krijuara gjykatat e qarkut.

Zyrat lokale kanë gjithsej 114 agjentë përbarimor dhe stafin administrative. Zyra lokale menaxhohet nga kryesuesi i zyrës së agjentëve përbarimor. Në zyrat më të vogla, kryesuesi ka edhe detyra shtesë. Në zyrat më të mëdha (p.sh. në Tiranë), detyrat e drejtorit janë kryesisht administrative. Detyrat e kryesuesit janë: udhëheqja, kontrolli dhe monitorimi i aktiviteteve të zyrës së agjentëve përbarimor. Kryesuesi i raporton drejtorisë së përgjithshme të përbarimit në lidhje me punën e përparimit dhe rreth çështjeve tjera.

⁷¹ Programi për Sistemin e Përbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.128).

⁷² Programi për Sistemin e Përbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.128).

Ky organizim do të mbetet si i tillë. Shqipëria ka zgjedhur një sistem me dy binarë: sistemi privat i përmbarimit do të zhvillohet paralelisht me sistemin ekzistues publik të përmbarimit.⁷³

7 Sistemi i përmbarimit në Maqedoni

Edhe tek sistemi i përmbarimit në Maqedoni sikurse në Kosovë bazë për përmbarim paraqet dokumenti përmbarues. Përmbarimi fillon me kërkesën e kreditorit. Përmbarimi i dokumentit përmbarues mund të zbatohet vetëm te një përmbarues. Përmbarimi për arkëtimin e shpenzimeve të gjyqit në procedurat penale e kundërvajtëse, si dhe të dënimeve me para të shqiptuara në këto procedura, fillon me kërkesën e Avokatit shtetëror të Republikës së Maqedonisë.⁷⁴ Përmbaruesi e zbaton përmbarimin. Përmbaruesi nuk guxon ta refuzojë zbatimin e përmbarimit, përveç në rast se janë plotësuar kushtet për përjashtimin e tij, dhe nëse ka njohuri se për dokumentin e njejtë përmbarues zbatohet përmbarimi te përmbaruesi tjetër.⁷⁵ Përmbarimi për realizimin e kërkesës në para do të zbatohet në masën e duhur për përmbushjen e asaj kërkesë.⁷⁶ Përmbarimi për realizimin e kërkesës në para nuk mund të realizohet ndaj sendeve ose të drejtave, të cilat janë të domosdoshme për plotësimin e nevojave elementare jetësore të debitorit dhe të personave për të cilët ai me ligj obligohet të përkuqdeset, ose për kryerjen e veprimtarisë së pavarur që është burimi kryesor i mjeteve për jetesë të debitorit. Gjatë përmbarimit duhet të ketë kujdes për dinjitetin e debitorit., si dhe për atë që përmbarimit të jetë sa më pak i pavolitshëm për debitorin.⁷⁷

Kur jemi tek urgjenca dhe rendi i veprimit duhet të cekim se përmbaruesi gjatë zbatimit të përmbarimit obligohet të veprojë menjëherë, e lëndët ti marrë për punë sipas rendit që i ka pranuar, përveç nëse natyra e kërkesës ose rrethanat e veçanta kërkojnë të veprohet ndryshe.⁷⁸ Më tepër kreditor që i realizojnë kërkesat e tyre në para ndaj debitorit të njejtë dhe lëndës së njejtë për përmbarim, përmbushen sipas rendit me të cilin kanë fituar të drejtën të përmbushen nga ajo lëndë, përveç në rastet për të cilat me këtë ligj është përcaktuar ndryshe.⁷⁹

⁷³ Programi për Sistemin e Përmbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.129).

⁷⁴ Neni 2- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

⁷⁵ Neni 3- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

⁷⁶ Neni 4- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

⁷⁷ Neni 5- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

⁷⁸ Neni 6- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

⁷⁹ Neni 7- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

Dokumentet përmbarese tek sistemi i përbarimit të Republikës së Maqedonisë janë:

1. Vendimi gjyqësor përbarues dhe marrëveshje gjyqësore;
2. Vendimi përbarues dhe marrëveshja në procedurën administrative, nëse kanë të bëjnë për përmbushjen e obligimit në para;
3. Dokumenti përbarues i noterit;
4. Dokumenti tjetër i cili si dokument përbarues parashihet me ligj;
5. Vërtetimin për përbarim e jep gjyqi, përkatësisht organi që ka vendosur për kërkesën në shkallën e parë;
6. Vërtetimin e pabazuar për përbarim, me aktvendim e shfuqizon gjyqi i njejtë, përkatësisht organi, me propozim ose me detyrë zyrtare.⁸⁰

Si vendim gjyqësor, sipas këtij ligji, konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, urdhëresa për pagesë dhe urdhëresa tjetër e gjyqeve të zgjedhura dhe arbitrazheve, ndërsa si marrëveshje gjyqësore konsiderohet marrëveshja e lidhur me ato gjyqe. Si vendim në procedurë administrative, sipas këtij ligji, konsiderohet aktvendimi dhe konkluzioni i organit të administratës shtetërore, si dhe e personit juridik, të miratuara në kryerjen e autorizimeve të tyre publike të përcaktuara me ligj, ndërsa si marrëveshje në procedurën administrative konsiderohet marrëveshja e lidhur sipas Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.⁸¹ Vendimi gjyqësor është përbarues nëse është bërë i plotfuqishëm dhe nëse ka kaluar afati për plotësimin e obligimit të debitorit në mënyrë vullnetare, ndërsa vendimi i miratuar në procedurën administrative është përbarues nëse është bërë përfundimtar dhe nëse ka kaluar afati për plotësimin e obligimit në mënyrë vullnetare. Duhet të cekim që afati për përmbushjen e obligimit në mënyrë vullnetare, fillon nga dita e dërgimit të vendimit te debitori. Në bazë të vendimit i cili në një pjesë është bërë përbarues, përbarimi zbatohet vetëm për atë pjesë.

Përbarimi do të zbatohet edhe në bazë të vendimit gjyqësor i cili nuk është i plotfuqishëm dhe vendimit të marrë në procedurë administrative i cili nuk është bërë përfundimtar, nëse me ligj është përcaktuar se ankesa nuk e ndalon përbarimin e vendimit.⁸² Marrëveshja gjyqësore, përkatësisht marrëveshja e lidhur në procedurë administrative, është përmbarese nëse kërkesa ka arritur pas marrëveshjes, ku arritja e kërkesës dëshmohet me procesverbal për marrëveshjen ose me dokumentin e vërtetuar sipas ligjit. Arritja që nuk

⁸⁰ Neni 12- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

⁸¹ Neni 13- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

⁸² Neni 14- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

mund të dëshmohet siç e cekëm lart, dëshmohet me vendimin e plotfuqishëm të marrë në procedurën gjyqësore me të cilën konfirmohet arritja. Në bazë të marrëveshjes e cila është bërë e plotfuqishme në një pjesë, përmbarimi zbatohet vetëm për atë pjesë. Kur jemi tek përmbarimi i dokumentit të noterit, mund të themi që dokumenti i noterit është dokument përmbarues, nëse është bërë përmbarues sipas dispozitës së veçantë, e cila e rregullon karakterin përmbarues të dokumentit të atillë. Në bazë të dokumentit të noterit i cili është bërë i plotfuqishëm në një pjesë, përmbarimi do të zbatohet vetëm për atë pjesë.⁸³

Kërkesën për përmbarim të dokumentit përmbarues kreditori e paraqet tek përmbaruesi, ku përmbaruesi obligohet të veprojë sipas kërkesës për përmbarim. Me dorëzimin e dokumentit përmbarues përmbarimi i të cilit kërkohet, përmbaruesi autorizohet të zgjedh mjetet për përmbarim dhe sendet e debitorit për përmbarimin e plotë të dokumentit përmbarues.⁸⁴ Në anën tjetër kreditori gjatë procedurës, pa pajtimin e debitorit, mund ta tërheq kërkesën për përmbarim tërësisht ose pjesërisht dhe në këtë rast përmbaruesi e ndërpret përmbarimin. Vlen të theksohet që kreditori pas tërheqjes së kërkesës mund të paraqesë kërkesë të re për përmbarim.⁸⁵ Duhet të përmendim edhe disa raste si p.sh ato rastet nëse gjatë zbatimit të përmbarimit pala ose përfaqësuesi i saj ligjor vdes, përmbarimi ndërpritet. Për ndërprerjen e përmbarimit, përmbaruesi i njofton trashëgimtarët e palës, nëse njihen dhe nëse dihet vendqëndrimi i tyre, si dhe palën e kundërt. Nëse trashëgimtarët dhe përfaqësuesi ligjor nuk njihen ose nuk dihet vendqëndrimi i tyre, përmbaruesi do të kërkojë nga gjyqi kompetent pa prolongim t`u caktojë përfaqësues të përkohshëm. Kur e kemi rastin kur pala e cila është person juridik pushon së ekzistuari, ose kanë ndodhur pasoja juridike nga hapja e procedurës falimentuese, përmbarimi ndërpritet.⁸⁶

Ligji për procedurë përmbarimore të vitit 2005, është themeluar sistemi i agjentëve privat përmbarimor pra të përmbaruesve privat. Ligji i tillë ka pasur efektet e tij. Komisioni evropian ka raportuar që: ``Sistemi i ri i përmbarimit ka pasur sukses të përzier. Në fund të vitit 2007, u përfunduan vetëm 27% të aktvendimeve të transferuara të agjentëve përmbarimor, në krahasim me 45% në fund të vitit 2006. Kjo përqindje u ngritë në 45% edhe gjatë vitit 2008. Afati për transferimin e lëndëve përmbarimore te agjentët përmbarimor është zgjatur nga fundi i vitit 2007 gjer në fund të vitit 2008, gjë që vonoi përmbarimin e duhur dhe të plotë të një numri të madh të aktvendimeve. Prej 27 gjykatave themelore, 22 arritën që të zvogëlojnë

⁸³ Neni 15- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

⁸⁴ Neni 27- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

⁸⁵ Neni 28- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

⁸⁶ Neni 29- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Maqedonisë, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.35/2005).

numrin shumë të lartë të rasteve të mbetura, që kryesisht përbëheshin nga rastet e përmbarimit dhe kundërvajtjes si dhe lëndët administrative që duhet të trajtoheshin nga gjykata e re administrative.⁸⁷

8 Sistemi i përmbarimit në Kroaci

Në periudhën 1998-2004, numri i lëndëve të pazgjidhura përmbarimore në gjykatat kroate u rritë dukshëm. Për këtë arsye, në janar të vitit 2006, Parlamenti kroat miratoi ``Strategjinë e reformës së sistemit gjyqësor dhe planin e tij të veprimit``. Zvogëlimi i numrit të lëndëve të mbetura nëpër gjykata është një nga synimet më të rëndësishme të reformës së sistemit kroat të drejtësisë në Kroaci, sepse vetëm kur zvogëlimi i numrit të lëndëve të mbetura në nivel të arsyeshëm, u mundëson gjykatave dhe gjyqtarëve që të merren me lëndë e jo lëndët të merren me ta. Kjo strategji u rishikua në mars të vitit 2008. Mund të thuhet që kjo strategji dha rezultate. Raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin 2008 thotë: ``Është bërë përparim i mëtejshëm në zvogëlimin e lëndëve të mbetura nëpër gjykata kroate. Gjatë vitit 2007, numri i tyre u zvogëlua për 6.1% në krahasim me vitin 2006. Megjithatë, ende ekziston një numër i madh i lëndëve të mbetura (969.100 në fund të vitit 2007) prandaj sistemi gjyqësor mbeti joefikas. Dobësitë e sistemit gjyqësor mund të dekurajojnë aktorët ekonomik nga dërgimi i lëndëve në gjykatë dhe shkatërrojnë përmbarimin efektiv të lëndëve të kreditorit dhe realizimin e të drejtave pronësore. Një nga fushat kryesore problematike mbeten lëndët përmbarimore, prej të cilave rreth 50% dështojnë për shkak të mungesës të sistemit të duhur për njoftimin e palëve. Reformimi i sistemit të përmbarimit të aktvendimeve gjyqësore kishte filluar. Megjithatë, kjo vazhdon të përbëjë pengesë kryesore për funksionimin efikas të gjykatave.⁸⁸

Kur jemi tek korniza ligjore, Kroacia tanimë është në Bashkimin Evropian. Kjo nënkupton se të gjithë fushat politike monitorohen nga afër. Kjo nënkupton se monitorohet edhe sistemi i gjyqësorit. Në fund të vitit 2010 Kroacia miratoi dy ligje të reja: kodi i ri i përmbarimit dhe ligji për agjentët publik të përmbarimit. Kroacia ka zgjedhur një sistem me dy binarë: përmbarimi mund të bëhet nga agjentët privat të përmbarimit si dhe përmes agjentëve përmbarimor të gjykatës. Ajo çfarë është interesante në sistemin Kroat është

⁸⁷ Programi për Sistemin e Përmbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.135).

⁸⁸ Programi për Sistemin e Përmbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.133).

përfshirja e noterive: kreditori përmbartimor mund të parashtrojë kërkesë për përmbartim në bazë të dokumentit autentik të noterit publik, dhe të kërkojë nga noteri publik që të nxjerrë vendimin përmbartues në bazë të atij dokumenti.⁸⁹

9 Sistemi i përmbartimit në Bosnje dhe Hercegovinë

Bosnja dhe Hercegovina kishte sistem të koklavitur kushtetues. Sipas marrëveshjes së Dejtonit, Bosnja dhe Hercegovina kishte 14 kushtetuta të ndara: e para Kushtetuta e Bosnjës dhe Hercegovinës (shtojca 4 e marrëveshjes së Dejtonit), më pas dy kushtetuta të etniteteve kushtetuese (Federata dhe Republika Serbe), më pas 10 kushtetuta të kantoneve të Federatës kroato-myslimane të Bosnjës, dhe në fund (si komponent i katërt kushtetues), kushtetuta e qarkut të Bërçkos.

Kështu struktura e qeverisë si dhe e sistemit gjyqësor të Bosnjës dhe Hercegovinës është organizuar në nivel të shtetit dhe në nivel të tri etniteteve: Federata (me 10 kantone), Republika Serbe dhe qarku i Bërçkos. Më 1 shkurt të vitit 2008 u publikua ``Plani i veprimit për reduktim të lëndëve të mbetura``. Në koordinim të Këshillit të lartë gjyqësor prokurorial, Bosnaja dhe Hercegovina tani synon që të zgjidhë problemin e numrit të madh të rasteve të mbetura nëpër gjykata.⁹⁰

Tani dua t`ju jap një pasqyrë: Më 1 janar 2006 ekzistonte një numër i lëndëve të mbetura të përmbartimit prej 132.085 sosh. Më 31 dhjetor 2006 ky numër u rrit në 134.936. Numri i lëndëve të mbetura të përmbartimit për shërbime publike ishte edhe më i lartë: Më 1 janar 2006, ky numër ishte 843.383 lëndë, më 31 dhjetor 2006 ky numër u rrit në 1.083.371 lëndë. Rreth 56% të këtyre rasteve lidhen me rastet e përmbartimit për kërkesa me vlerë të ulët (kryesisht për shërbimet publike siç janë rryma elektrike dhe shërbimet e telefonisë).⁹¹

Në bazë të këtyre statistikave, në mes të dhjetorit 2006 dhe dhjetorit 2007, autoritetet përkatëse boshnjake siç janë ministrinë e drejtësisë së shtetit, etniteteve, kantoneve dhe Komisioni gjyqësor i qarkut të Bërçkos e kordinuar nga Ministria e shtetit dhe e drejtësisë hartoi ``Strategjinë për reformë në sektorin e drejtësisë në Bosnje dhe Hercegovinë për

⁸⁹ Programi për Sistemin e Përmbartimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.133).

⁹⁰ Programi për Sistemin e Përmbartimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.130).

⁹¹ Programi për Sistemin e Përmbartimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.130).

periudhën 2008-2012``. Deklarata e vizionit sipas strategjisë është: ``një sistem efikas, efektiv dhe i koordinuar i drejtësisë në BH që është llogaridhënës ndaj të gjithë qytetarëve të BH-së dhe është plotësisht në pajtim me standardet dhe praktikat më të mira të BE-së, që garantojnë sundimin e ligjit.⁹²

Kur jemi tek korniza ligjore, në nivel të shtetit, roli i përmbarimit është mjaft i kufizuar. Gjyqësori dhe përmbarimi janë përgjegjësi të etniveve (Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republikës Serbe), 10 kantoneve të Federatës kroato-myslimane të Bosnjës, dhe qarkut të Bërçkos. Secili nga këto etnitete ka legjislacionin e vet, rregulloret e veta, p.sh për pagesa, etj. Ndonëse janë miratuar ligje të reja, ndryshimet janë ende të bazuara në ligjin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1978.⁹³

Procedurat përmbarimore nuk dallojnë shumë ndërmjet etniveve. Bazë për procedurat e përmbarimit janë dokumentet e përmbarueshme dhe të besueshme. Procedurat e përmbarimit nisen përmes kërkesës për përmbarim nga kreditori në gjykatën kompetente të shkallës së parë. Kërkesa e tillë bazohet në dokumentet e përmbarueshme apo dokumentet e besueshme: aktvendimet e gjykatës dhe ujdite gjyqësore në rastet civile apo procedurat administrative, dokumentet e përmbarueshme të noterit publik, dokumentet tjera të shpallura me ligj sit ë përmbarueshme. Gjithashtu është e mundshme që të niset procedura civile për faktet e kontestuara në procedurën përmbarimore ku e tërë procedura kryhet nga gjykata.⁹⁴

⁹² Programi për Sistemin e Përmbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.130).

⁹³ Programi për Sistemin e Përmbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.131).

⁹⁴ Programi për Sistemin e Përmbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.131).

Kreu III

III. PËRMBARUESI PRIVAT

1 Kuptimi

Përmbaruesi privat është personi fizik i emëruar nga Ministri i Drejtësisë në pajtim me dispozitat e ligjit për përmbarim, i cili në kryerjen e autorizimeve publike të besuara sipas ligjit, vendos për veprimet nga kompetenca e tij në zbatimin e përmbarimit të lejuar dhe ndërmerr veprime për përmbarim.⁹⁵

Funksionalizimi i sistemit privat në Kosovë nga momenti i hyrjes në fuqi rriti pritjet për ofrim të zgjidhjeve për të gjitha problemet që ekzistonin në Kosovë. Agjentët privat të përmbarimit kanë tendencë të jenë tejet të motivuar dhe profesionist në punën e tyre, dhe ofrojnë nivel të lartë të shërbimeve për të siguruar suksesin e tyre konkurrues. Ata kanë kontroll të drejtpërdrejtë në menaxhimin e zyrave që i udhëheqin dhe përfitojnë personalisht nga performanca e tyre, duke sjellë një nivel të lartë të përgjegjësisë për çështjet siç janë: angazhimi dhe largimi, buxhetimi, sistemet e teknologjisë informative për të mbështetur punën e tyre dhe menaxhimin e zyrës.⁹⁶

Përveç kësaj, për shkak se procesi i përmbarimit bëhet biznes privat në vend të funksionit publik, shpenzimet e furnizimit dhe mirëmbajtjes së zyrave të përmbarimit dhe të trajnimeve të agjentëve dhe punonjësve të tyre janë hequr krejtësisht nga buxheti i shtetit edhe pse shteti mban shumicën prej shpenzimeve të monitorimit të agjentëve të përmbarimit për të siguruar ligjshmërinë e funksioneve të tyre, dhe disponueshmërinë e tyre atëherë kur kërkohet. Sistemi privat ka gjithashtu përparësinë e heqjes së përgjegjësisë së menaxhimit të procesit të përmbarimit nga gjyqtarët dhe zyrtarë përmbarues të gjykatave. Këto përgjegjësi i kalojnë agjentët privat.⁹⁷

Vlen të ceket që sistemi i përmbarimit i bazuar rreth agjentëve privat të përmbarimit janë bërë standarde në pjesën më të madhe të Evropës Perëndimore dhe në shtetet ish socialiste dhe në Evropën Qendrore si dhe Evropën Lindore. Është poashtu e drejtë të thuhet se edhe Shtetet e Bashkuara si dhe shumë shtete që zbatojnë ligjin e të drejtës zakonore kanë sistem të

⁹⁵ Neni 2- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

⁹⁶ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.117). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrmbarimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

⁹⁷ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.118). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrmbarimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

përbarimit privat edhe pse të paktën në SHBA është i strukturuar shumë më ndryshe se në sistemet e shteteve ballkanike.

Profesioni i agjentit privat nuk është i rehatshëm por shumë i rëndësishëm. Se sa i rëndësishëm është ky profesion tregon fakti se në disa shtete si është Bullgaria përbaruesi i parë privat është emëruar ish Ministri i Drejtësisë, ndërsa në Belgjikë numri i përbaruesve është i kufizuar dhe për t'u emëruar në këtë pozitë duhet të presësh shumë vite, ndërsa procedura është shumë e veçantë sepse emërimet bëhen nga mbreti.⁹⁸

1.1 Statusi dhe kompetencat e përbaruesit privat

Përbaruesi privat ndërmerr veprime për zbatimin e përbarimit edhe jashtë territorit për të cilin ai është emëruar, personalisht apo nëpërmes përbaruesit privat të territorit tjetër. Organet e administratës shtetërore mund t'i besojnë përbaruesit privat zbatimin e përbarimit në procedurat të cilat aplikohen në bazë të vendimeve të këtyre organeve shtetërore, vetëm nëse parashihet ndryshe me ndonjë ligj të veçantë. Selia e përbaruesit privat do të jetë e vendosur brenda territorit të Gjykatës themelore për të cilin ai është emëruar.⁹⁹ Kryerja e funksioneve mbikqyrëse apo menaxhues në subjektet komerciale, institucionet shtetërore, shërbimet financiare, çështjet komerciale dhe detyrat e noterisë dhe avokatisë është mos pajtueshmëri me veprimet përbarimore të përbaruesit privat. Përbaruesi privat nuk mund të themelojë marrëdhënie pune me ndonjë subjekt shtetëror apo komercial. Kufizimi i përmendur më lart nuk vlen për aktivitetet shkencore, teknike, artistike apo arsimore apo kryerjen e aktiviteteve në Odë dhe shoqatat ndërkombëtare të përbaruesve privat.¹⁰⁰

Është me rëndësi të dihet që përbaruesi privat në Kosovë, nuk ka drejtë të kryej veprime tjera shtesë gjatë ushtrimit të profesionit, si në disa vende tjera, p.sh në Holandë përbaruesi privat ka të drejtë të kryej edhe rolin e avokatit për kreditorin nëse shuma e cila duhet të realizohet nuk kalon shumë pre 5000 euro e që është duke u diskutuar që ai të kryej rolin e avokatit edhe për rastet ku shuma është deri në 25000 euro, ndërsa nëse e krahasojmë

⁹⁸ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.118). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrbarimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

⁹⁹ Neni 323 - Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁰⁰ Neni 324- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

me Belgjikën përmbaresit mund të bëjnë edhe vlerësimin e objekteve para se të bëhet shitblerja e tyre, apo vlerësimi objekteve afër rrugëve të cilat do të ndërtohen¹⁰¹.

1.2 Kushtet për emërimin e përmbaresit privat

Përmbares mund të emërohet personi i cili plotëson kushtet në vijim:

1. *të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;*
2. *të ketë zotësi të plotë për të vepruar, dhe duhet të jetë i aftë në aspektin shëndetësor;*
3. *të jetë jurist i diplomuar në fakultetin juridik, apo të ndonjë fakulteti juridik të ndonjë vendi tjetër, pas nostrifikimit të diplomës në Republikën e Kosovës;*
4. *të ketë kryer provimin e jurisprudencës;*
5. *të ketë së paku tri (3) vjet përvojë pune juridike;*
6. *të ketë dhënë provimin për përmbares;*
7. *që kundër tij nuk zhvillohet procedurë hetimore për vepër penale, përkatësisht që nuk është i dënuar për vepër penale me dënim me burg e cila vepër është e dënueshme më së paku gjashtë (6) muaj, apo për vepër penale e cila e bënë të padenjë në ushtrimin e punës së përmbaresit;*
8. *të paraqes deklaratë te noteri për gjendjen e tij materiale, me të gjitha pasojat nga dhënia e deklaratës së rrejshme.*

Në qoftë se kundër kandidatit që ka dorëzuar kërkesë për emërim për përmbares është duke u zhvilluar procedurë penale, vendimi për emërim shtyhet deri sa të arrihet vendimi në procedurën penale.¹⁰²

1.3 Caktimi i numrit të përmbaresve privat

Numrin e përmbaresve privat e cakton Ministri në përputhje me dispozitat e ligjit për përmbares të Republikës së Kosovës. Për territorin e Gjykatës themelore një pozitë e përmbaresit privat, sipas rregullit caktohet në njëzet e pesë mijë (25.000) banorë. Numri i përmbaresve privat në territorin e Gjykatës themelore, mund të rritet derisa numri i përmbaresve privat të emëruar në secilin rajon të arrijë proporcionin e paraparë si më lartë.

¹⁰¹ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.119). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%3ABrmbarimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

¹⁰² Neni 326- Ligji për procedurën përmbaresimorë i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Përfundim kemi, kur Ministri varësisht nga nevojat apo sipas kërkesës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ose Odës së përmbauesve cakton edhe numër më të madh të përmbauesve privat.¹⁰³

2 Procedura e emërimit të përmbauesit privat

Ministri emëron përmbauesin privat në bazë të konkursit publik. Ministria e Drejtësisë shpall konkursin në sërë paku dy (2) gazeta ditore, ku afati për konkurim nuk do të jetë më pak se tridhjetë (30) ditë nga data e shpalljes. Kandidatët aplikacionit për konkurim duhet t'ia bashkangjesin dokumentacionin me të cilin vërtetohet se i plotësojnë kushtet e parapara që i përmendëm më lartë tek kushtet për emërimin e përmbauesve privat.

Komisionin për vlerësimin e kandidatëve (Komisioni Vlerësues) e emëron Ministri, i cili përbëhet si në vijim:

1. një gjyqtar nga Gjykata Supreme i propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
2. dy përmbaues të propozuar nga Oda e Përmbauesve privat;
3. një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë i cili ka sërë paku dhjetë vjet përvojë pune në fushën e drejtësisë;
4. një profesor i rregullt i lëmis civile;¹⁰⁴

2.1 Mënyra e emërimit të përmbauesve privat

Ministri, brenda tridhjetë ditëve nga dita e pranimit të listës me propozime të kandidatëve merr vendim për emërimin e përmbauesve privat . Vendimi i ministrit për emërim i dërgohet përmbauesit privat dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë, ku ky vendim nuk mund ti nënshtrohet ankimimit administrativ, kundër tij mund të ngritet konflikt administrativ. Ministri do të organizoj përsëritjen e provimit dhe procesit të emërimit brenda nëntë muajve pas mbajtjes së provimit paraprak, nëse ka vende të zbrazëta të cilat janë shpallur më parë por kanë mbetur të paplotësuara ose të cilat kanë mbetur vakante gjatë kësaj periudhe.¹⁰⁵

Komisioni Vlerësues pas vlerësimit të aplikacioneve dhe dokumentacionit të kandidatëve do të përpilojë listën me propozime për emërimin e kandidatëve e cila i dorëzohet Ministrit. Me rastin e përzgjedhjes në mes të më shumë kandidatëve posaçërisht do të merret

¹⁰³ Neni 327- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁰⁴ Neni 328- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁰⁵ Neni 330- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

parasysh rezultati i tyre në provimin për përmbarues privat. Ministri nxjerr akt nënligjor për punën e Komisionit Vlerësues.¹⁰⁶

2.2 Betimi dhe fillimi i ushtrimit të veprimtarisë të përmbaruesit privat

Personi i emëruar si përmbarues privat e jep betimin para Ministrit, në afat prej tridhjetë ditësh nga dita e emërimit. Teksti i betimit është sin ë vijim:

`` Beto hem se do të kryejë veprimet e përmbarimit me dinjitet, nderë dhe paanshmëri në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës dhe duke mbrojtur interesat e palëve``

Përmbaruesi privat është i detyruar që në afat prej gjashtëdhjetë ditëve nga dhënia e betimit, ministrisë të ia dërgoj dëshmitë se i ka plotësuar kushtet e parapara. Ditën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbaruese e cakton Ministri dhe për këtë njoftohet përmbaruesi privat dhe Oda e Përmbaruesve.¹⁰⁷

2.2.1 Kushtet që duhet plotësuar pas dhënies së betimit

Pas dhënies së betimit, përmbaruesi privat:

- lidh marrëveshje për sigurimin e përgjegjësisë për dëmin i cili mund t'i shkaktohet palëve të treta gjatë shërbimit të tij;
- lidh marrëveshje për sigurimin e lokalit dhe objekteve të pranuar si depozitë në rastin e dëmtimit, shkatërrimit apo humbjes së tyre;
- hap llogarinë e veçantë në njërin nga bankat komerciale, ku vetëm paratë e rasteve përmbarimore do të depozitohen dhe do të shfrytëzohen ekskluzivisht për shlyerjen e borxheve ndaj kreditorëve;
- siguron hapësirën për zyre në territorin e Gjykatës themelore ku do ta ketë selinë;
- siguron pajisje të nevojshme për të zbatuar përmbarimin;
- duhet të ketë vulën katrore dhe vulën e rrumbullakët zyrtare;
- duhet të depozitojë nënshkrimin dhe inicialet e tij në kuadër të Gjykatës themelore në rajonin në të cilin është emëruar. Në rast të ndërrimit të selisë jashtë territorit të Gjykatës themelore, pas emërimit si përmbarues privat në vendin e ri, ai depoziton

¹⁰⁶ Neni 329- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁰⁷ Neni 331- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

nënshkrimin dhe inicialet e tij në kuadër të regjistrimit të Gjykatës themelore në territorin e së cilës është rivendosur. Në rast të shpërnguljes jashtë territorit të Gjykatës themelore, pas emërimit të përmbauesit privat, ai do të depozitojë nënshkrimin dhe inicialet me regjistrin e Gjykatës themelore në territorin ku ai është shpërngulur.

Kemi edhe raste kur konsiderohet se përmbauesi privat nuk është emëruar, e ato raste janë nëse:

- refuzon dhënien e betimit;
- pa shkaqe të arsyeshme nuk i përgjigjet thirrjes për dhënien e betimit;
- në afatin e përmendur më lartë të paraparë me ligj, ku nuk i dërgon provat për plotësimin e kushteve të parapara për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë apo nu fillon veprimtarinë përmbauese në ditën që i është caktuar;¹⁰⁸

Përmbauesi privat ka vulën zyrtare dhe të rrumbullakët. Mostra e çertifikuar e vulës dhe nënshkrimi i çertifikuar i përmbauesit privat do të vendoset në Ministri dhe Gjykatën themelore në territorin e së cilës përmbauesi privat është emëruar. Vula përmban logon e Republikës së Kosovës, shenjën e përmbaimit, emrin personal të përmbauesit privat dhe selinë e përmbauesit privat. Përmbauesi privat shfrytëzon vulat vetëm pas fillimit të detyrës si përmbaues privat dhe vetëm për veprimet për të cilat përmbauesi privat i ka ndërmarrë në kuadër të aktivitetit të tij ligjor. Përmbauesi privat, zëvendësuesi i përmbauesit privat dhe zëvendësi i tij kanë kartelën identifikuese të përmbaimit të lëshuar nga Ministria. Përmbauesi privat, zëvendësuesi i përmbauesit privat dhe zëvendësi shfrytëzojnë kartelën pas fillimit të detyrës dhe shfaqin kartelën gjatë kryerjes së veprimeve të përmbaimit. Duhet të ceket që forma dhe përmbajtja e kartelës identifikuese e përmbauesit privat përcaktohet me akt nënligjor nga Ministri.¹⁰⁹

2.3 Regjistrimi në regjistrin e përmbauesve privat

Me ditën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbauese kryhet regjistrimi i përmbauesit privat, zëvendësuesit të përmbauesit privat, dhe zëvendës përmbauesit privat në regjistrin e përmbauesve privat, në bazë të njoftimit dhe dëshmive të caktuara me ligj. Të dhënat për regjistrim dhe fillim të ushtrimit të veprimtarisë përmbauese, ministria i shpallë në faqen zyrtare të Ministrisë dhe në faqen zyrtare të Odës së Përmbauesve privat. Përmbauesi privat nuk mund të fillojë ushtrimin e veprimtarisë përmbauese para ditës që është caktuar si

¹⁰⁸ Neni 332- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁰⁹ Neni 333- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

ditë e fillimit të kryerjes të veprimtarisë përmbarese. Regjistri i përmbareseve privat përmban këto të dhëna:

1. numrin rendor të regjistrimit;
2. emrin personal dhe datën e lindjes të përmbaresit privat;
3. numrin personal;
4. territorin e Gjykatës për të cilën është emëruar, selinë zyrtare dhe adresën;
5. numrin dhe datën e vendimit për emërim;
6. datën e dhënies së betimit;
7. data e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbarese;
8. masat disiplinore të cilat i janë shqiptuar përmbaresit privat;

Përmbaresi privat, zëvendësuesi apo zëvendësuesi i përmbaresit privat njofton në afat prej 15 ditësh ministrinë dhe oden për ndryshimet e të dhënave në evidence zyrtare.¹¹⁰

Përveç kësaj përmbaresit privat kanë edhe provimin për përmbares privat, të cilin mund ta japë personi i cili është jurist i diplomuar në fakultetin juridik, sipas programit 4 vjeçar ose studimet master, dhe të ketë së paku 3 vite përvojë pune juridike. Ky provim jepet në pajtim me aktin nënligjor për mënyrën dhe programin e dhënies së provimit për përmbares privat. Aplikacioni për dhënien e provimit për përmbares privat me dëshmitë për plotësimin e kushteve të parapara i dorëzohen ministries. Ministri nxjerr vendim me të cilin lejohet dhënia e provimit të përmbaresit privat, personi i cili plotëson kushtet e përcaktuara me ligj. Pas dhënies së provimit, përmbaresit privat i lëshohet çertifikata e nënshkruar nga Ministri, ku Ministri mban evidencat për personat të cilët kanë dhënë provimin e përmbaresit privat.¹¹¹Nuk kryhet me kaq, provimi për përmbaresit privat jepet para Komisionit për dhënien e provimit për përmbares privat, ku përbërja e Komisionit për provim përcaktohet nga ministri me vendim. Për punën në Komisionin për provim, kryetari, anëtarët e komisionit dhe sekretari i komisionit kanë të drejtë për kompensim në shumën e caktuar nga ministri.¹¹²

3 Të drejtat dhe obligimet e përmbareseve privat

Tek të drejtat dhe obligimet e përmbareseve hyn pavarësia, ku përmbaresi privat është i pavarur dhe kryen funksionet vetëm në pajtim me ligjin.

¹¹⁰ Neni 334- Ligji për procedurën përmbarese i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹¹¹ Neni 335- Ligji për procedurën përmbarese i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹¹² Neni 336- Ligji për procedurën përmbarese i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Në rast se përmbaruesi privat arrestohet apo akuzohet si i padehur për veprë penale të karakterit të përgjithshëm, Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli i Odës njoftohen.¹¹³ Kompani partneriteti të përmbaruesve privat mund të themelojnë vetëm përmbaruesit privat për të mundësuar zhvillimin e afarizmit sipas kushteve dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.¹¹⁴

3.1 Kryerja e veprimeve përmbarimore

Përmbaruesi privat është përgjegjës për kryerjen e veprimeve përmbarimore në pajtim me dispozitat e Ligjit për përmbarim. Përmbaruesi privat kryen veprimet përmbarimore në bazë të autorizimeve të tij. Personat e autorizuar nga përmbaruesi privat veprojnë në emër dhe për llogari të përmbaruesit privat. Përmbaruesi privat, sipas nevojës, për disa veprime të përmbarimit, mund të angazhojë palën e tretë që t'i ndihmojë në këto veprime. Përmbaruesi privat është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga personat e caktuar gjatë kryerjes së veprimeve të caktuara përmbarimore. Të punësuarit e përmbaruesit privat janë të obliguar që të mbajnë sekretin zyrtar nën kushtet të cilat vlejné edhe për përmbaruesin privat.¹¹⁵

Për administrimin e drejtë të drejtësisë, është e rëndësishme që cilësia e përmbarimit të garantohet. Një cilësi e lartë të trajnimit të profesionistëve është e rëndësishme për shërbimin e drejtësisë dhe poashtu për ta rritur besimin e përdoruesve në sistemin e tyre të drejtësisë. Prandaj, agjentëve të përmbarimit privat i kërkohet që ta ndjekin trajnimin e detyrueshëm dhe të vazhdueshëm. Atyre duhet ti sigurohen ti jepen kurrikula adekuate të trajnimit dhe duhet t`ju percaktojnë standard minimale të përbashkëta. Trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm mund të përfshijë:

- parimet dhe objektivat e zbatimit;
- fazat në procesin e përmbarimit;
- përshtatshmërinë, organizimin dhe zbatimin e masave të përmbarimit;
- kuadrin ligjor;
- ushtrimet praktike sipas rastit;
- vlerësimin e njohurive të të trajnuarve;

¹¹³ Neni 337- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹¹⁴ Neni 338- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹¹⁵ Neni 339- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

- zbatimin ndërkombëtar të vendimeve gjyqësore dhe titujve të tjerë të ekzekutueshëm;¹¹⁶

3.2 Obligimet për përmbarrim

Përmbarruesi privat ka detyrim që të kryej obligimet zyrtare për të cilat është i autorizuar në territorin e Gjykatës themelore për të cilin është emëruar përveç në qoftë se:

- ekzistojnë arsyet për përjashtim;
- propozuesi përmbarrimor nuk paguan avansin për kryerjen e detyrave zyrtare siç kërkohet nga përmbarruesi privat në bazë ligjit për përmbarrim.

Nëse lindin rrethana të parapara, përmbarruesi privat, përderisa kjo bie në kompetencat e tij, ndërmerri masat e nevojshme për të siguruar që veprimet përmbarrimore mund të kryhen në nivel lokal nëse kjo kërkohet. Për këtë, përmbarruesi privat mund të kërkojë nga Ministri që të emërojë zëvendësuesin e përmbarruesit privat. Ai mund të rekomandojë zëvendësuesin e përmbarruesit privat. Nëse përmbarruesi privat ka qenë i paguar të kryej detyrat sipas mandatit të tij për më shumë se 30 ditë, ai do të informojë për këtë Ministrin duke deklaruar masat të cilat ai i ka ndërmarrë.¹¹⁷ Agjentët e përmbarrimit duhet të jenë të detyruar të kryejnë rolin e tyre sa herë që kërkohet ligjërisht, përveç rasteve të pengesës ose kur ato lidhen me gjak ose martesë me një palë.¹¹⁸ Agjentët e përmbarrimit gjatë gjithë kohës duhet të veprojnë brenda ligjit edhe nëse ata paguhet ose veprojnë të nxitur nga parashtruesit e kërkesës. Rregullimi i rolit, përgjegjësi pra obligimeve dhe kompetencave të agjentëve përmbarrimor konsiderohet të jetë i rëndësishëm së veçantë. Kjo poashtu i mundëson palëve që të kuptojnë më mirë autoritetin dhe rolin e agjentëve pra përmbarruesve privat.¹¹⁹

4 Detyrat e përmbarruesit privat

Përmbarruesi privat në procedurën e caktimit dhe të zbatimit të përmbarrimit, në pajtim me dispozitat dhe kufizimet e parapara me ligjin për procedurë përmbarrimore:

¹¹⁶ European Commission On the Efficiency of Justice (CEPEJ), Guidelines for a Better Implementation of the Existing Council of Europe's Recommendation On Enforcement, adopted by the CEPEJ at its 14th plenary meeting. Strasbourg, 9-10 December 2009. Shih. <https://rm.coe.int/16807473cd>.

¹¹⁷ Neni 340- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹¹⁸ European Commission On the Efficiency of Justice (CEPEJ), Guidelines for a Better Implementation of the Existing Council of Europe's Recommendation On Enforcement, adopted by the CEPEJ at its 14th plenary meeting. Strasbourg, 9-10 December 2009. Shih. <https://rm.coe.int/16807473cd>.

¹¹⁹ Programi për Sistemin e Përmbarrimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.77).

1. nxjerr urdhër për përmbarim dhe zbaton përmbarimin në pajtim me autorizimet e tij;
2. pranon dhe vepron sipas propozimeve për përmbarim të kërkesave dhe të propozimeve për zbatim të përmbarimit të kërkesave dhe cakton mënyrën e përmbarimit nëse kreditori nuk e ka caktuar në propozim;
3. të dorëzojë urdhra, akte dhe shkresa;
4. të identifikojë palët dhe pjesëmarrësit në procedurën përmbarimore;
5. të mbledh të dhëna për gjendjen pasurore të debitorit;
6. të nxjerr konkluzione, përpilojë procesverbale, kërkesa dhe të dhëna tjera zyrtare në pajtim me autorizimet e parashikuara me ligjin për përmbarim;
7. të kryejë regjistrimin, vlerësimin e pronës, sekuestrimin dhe shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme;
8. të pranojë dhe ruajë pasurinë e regjistruar dhe të siguruar të debitorit, urdhërojë transferin e pronësisë dhe kryejë ndarjen e pasurisë dhe mjetet tjera monetare të realizuara me shitjen e pasurisë;
9. të kryejë zhvendosjen dhe veprimet tjera përmbarimore për qëllime të përmbarimit në pajtim me ligjin për përmbarim dhe aktet nënligjore;
10. sipas kërkesës së debitorit apo kreditorit, përmbaruesi privat ndërmjetëson ndërmjet tyre për qëllime të arritjes së marrëveshjes;
11. të pranojë dhe transferojë mjete monetare në pajtim me ligjin për përmbarim;
12. të mbajë evidence të rasteve në të cilat ai vepron në pajtim me formën e përcaktuar nga Ministri;
13. të ndërmarrë veprime të tjera siç parashikohet me ligjin për përmbarim.¹²⁰

Në ushtrimin e autorizimeve të tij, përmbaruesi privat mundet të kërkojë bashkëpunim nga organet shtetërore, zyrtarët dhe organizatat, të cilët janë të obliguara të ofrojnë këtë. Mund ta citojmë faktin që organet e policies janë të obliguara që menjëherë të ofrojnë bashkëpunim për përmbaruesin privat në çdo rast që ai e konsideron të domosdoshëm në realizimin e funksioneve të tij, por policia nuk ka të drejtë të refuzojë kërkesën për bashkëpunim dhe ndihmë nga ana e përmbaruesit.¹²¹ Agjentët përmbarimor poashtu mund të autorizohen që të kryejnë aktivitete dytësore që janë në përputhje me rolin e tyre, duke u përpjekur të ruajnë dhe sigurojnë njohje të drejtave të palëve dhe me synim të përshejtimit të procesit gjyqësor

¹²⁰ Neni 341- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹²¹ Neni 346- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

ose zvogëlimit të numrit të lëndëve me të cilat janë të ngarkuara gjykatat. Këto mes tjerash, mund të jenë:

- kthimi i borxhit;
- shitja vullnetare e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në ankand publik;
- konfiskimi i mallit;
- regjistrimi dhe raportimi i dëshmive;
- shërbimi si postier të gjykatave;
- ofrimi i këshillave ligjore;
- procedurat e falimentimit;
- kryerja e detyrave që u caktohen atyre nga gjykatat;
- përfaqësimi i palëve në gjykata;
- hartimi i akteve dhe dokumenteve private;
- mësimi.¹²²

Agjentët përbarimor duhet të jenë të obliguar që të luajnë rolin e vet sa herë që ligji ua kërkon që ta bëjnë këtë gjë, përveç në rastet e pengimit ose kur ata janë në lidhje gjaku ose përmes martesës me palën. Kur agjentët përbarimor janë nëpunës të shtetit, ata duhet të jenë të obliguar që të hapin një llogari të veçantë me qëllim specifik për të depozituar fondet e mbledhura në emër të klientëve, ku kjo llogari duhet ti nënshtrohet inspektimit.¹²³

5 Mbrojta e të drejtave të debitorit

Gjatë përbarimit të kërkesave, përbaruesi privat i përmbahet ligjit për përbarim, vendimeve gjyqësore dhe kërkesave të parashikuara në aktvendimin për përbarim duke u kufizuar në përbarimin e veçantë të instrumenteve dhe objekteve të caktuara. Gjatë zbatimit të përbarimit duhet pasur kujdes për mbrojtjen e dinjitetit të personalitetit të debitorëve, dhe përbarimi duhet të jetë sa më i përballeshëm për debitorin¹²⁴ Debitori duhet ta përmbush detyrimin në afat të caktuar kohor, në Republikën e Maqedonisë nëse debitori nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar kohor, përbaruesi privat do të zbatoj vendim për dënim

¹²² Programi për Sistemin e Përbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.82).

¹²³ Programi për Sistemin e Përbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.83).

¹²⁴ Neni 342- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

me para. Në këtë rast përmbaruesi privat njëherësh miraton dekretin e ri me të cilin është përcaktuar korniza e re kohore për përmbushjen e detyrimit nga debitori, ku debitori informohet që nëse brenda afatit kohor nuk e përmbush detyrimin, gjykata në afat kohor prej 48 orësh me vendim do të miratojë dënim të ri në para. Nëse përmbaruesi privat nuk ka mundësi ta zbatojë dënimin në para ndaj personit fizik, për këtë ai do ta informoj gjykatën e cila në bazë të informacionit nga përmbaruesi do ta zëvendësojë atë me dënim me burgim sipas rregullave që janë të zbatueshme në ligjin penal¹²⁵.

Kur jemi tek debitorët, duhet ti përmendim edhe problemet lidhur me sigurimin e adresave të debitorëve. Njëra ndër arsytet për grumbullimin e lëndëve është edhe sigurimi i adresave të sakta për debitorët. Zyrtarët e përbarimit gjatë procedimit lidhur me këto lëndë, për të dërguar njoftimet për përbarim hasin në adresa të pa sakta. Për shkak të numrit të madh të rasteve që paraqiten, ata procedojnë për njoftime lidhur me rastet që janë paraqitur për afërsisht para tre viteve, prandaj nuk është e çuditshme nëse adresat kanë ndryshuar dhe natyrisht gjatë kësaj dekade ka pasur lëvizje të mëdha të popullsisë në drejtim të zonave urbane dhe se palët në procedure nuk banojnë aty ku kanë banuar në kohën kur janë paditur¹²⁶.

Gjykata e as kreditori nuk kanë ndonjë metodë të lehtë për ti gjetur ata. Regjistri i gjendjes civile, të cilin gjykata mund ta kontaktoj është i vetmi burim i informative në dispozicion për verifikimin e adresave të debitorëve. Në fakt ky nuk përmban informacionet për adresat aktuale të individëve, edhe pse kërkesat për këto të dhëna shpesh i dërgohen Regjistrisë Civile, ku zyrtarët vendor përgjegjës për mbajtjen e regjistrisë ka raste edhe kur nuk i pranojnë kërkesat e gjykatës për dhënien e informacioneve, ose i pranojnë por nuk kthejnë kurrë përgjigje. Mund të konstatojmë se Regjistria Civile në Kosovë nuk ofron asnjë ndihmë klidhur me këtë problem. Regjistria civile është me sa duket duke bërë projekte për të rregulluar këtë çështje dhe thuhet se ndoshta do të jenë në gjendje që të japin informacione rreth adresave në këtë vit. Në disa raste si justifikim i shpeshtë për mungesë të suksesit të zyrtarëve të përbarimit në përbarimin e rasteve nga dokumentet autentike është se debitorët kanë lëvizur dhe nuk mund të gjenden.¹²⁷

¹²⁵ Zendeli Emine, The process of enforcement of court decisions as integral part of fundamental human rights, Tirana 2015, "INTERNATIONAL INSTITUTE FOR PRIVATE, COMMERCIAL AND COMPETITION LAW".

¹²⁶ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.123). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrbarimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

¹²⁷ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.123). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrbarimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

5.1 Mbrojta e të dhënave

Dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave personale janë gjithashtu të aplikueshme për përmbaruesit privat. Përmbaruesi privat duhet të mënjanojë që të procedojë të dhënat që nuk janë të nevojshme për këtë arsye. Përmbaruesi privat mban të fshehta të dhënat në të cilat ai ka qasje gjatë kryerjes së detyrës së tij dhe nuk mund t'i përdorë ato për përfitim personal apo të personave tjerë. Përmbaruesit privat duhet të bartin përgjegjësi për ruajtjen e konfidencialitetit kur hasin në informatat sekrete, konfidenciale apo të ndjeshme gjatë procedurës përmbarimore. Në rast të shkeljes së kësaj përgjegjësie, aplikohen masat e përgjegjësisë disiplinore së bashku me sanksionet civile dhe penale.¹²⁸

Përmbaruesi privat mund të kryen aktivitete tjera përpos atyre të përmendura më herët por vetëm nëse ato nuk ndikojnë apo pengojnë në kryerjen e duhur apo të pavarur të zyrës së tij apo në reputacionin e tij. Duhet të cekim që me akt nënligjor të Ministrisë, mund të ndalohen aktivitetet e caktuara të përmbaruesit përveç:

- mbledhjen e parave për palët e treat;
- bërjen e inventarit dhe vlerësimeve;
- përpilimin e deklaratës me shkrim përkitazi me faktet materiale të vërejtura nga përmbaruesi privat personalisht.¹²⁹

Organet e administratës publike, organet e qeverisë qendrore dhe organet tjera në vartësi të tyre, bankat, ndërmarrësit dhe personat tjerë juridik janë të obliguar që pas kërkesës së përmbaruesit privat të sigurojnë qasjen në të dhënat të cilat janë të nevojshme për kryerjen e veprimeve përmbarimore.¹³⁰ Tek bashkëpunimi, në ushtrimin e autorizimeve të tij, përmbaruesi privat mund të kërkojë bashkëpunim nga organet shtetërore, zyrtarët dhe organizatat, të cilat janë të obliguara ta ofrojnë këtë. Organet e policisë janë të obliguara që menjëherë të ofrojnë bashkëpunim për përmbaruesin privat në çdo rast që ai e konsideron të domosdoshëm në realizimin e funksioneve të tij. Përmbaruesi mund të paraqes një kërkesë të tillë në rast se ka pengesa gjatë zbatimit të funksioneve të tij, por policia nuk ka të drejtë të refuzojë kërkesën për bashkëpunim dhe ndihmë nga ana e përmbaruesit.¹³¹

¹²⁸ Neni 343- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹²⁹ Neni 344- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹³⁰ Neni 345- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹³¹ Neni 346- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

6 Mirëmbajtja e evidencave afariste – Arkivi zyrtar

Përmbaruesi privat është i detyruar të mbaj evidence e të gjitha propozimet të pranuar për caktimin dhe zbatimin e përmbarimit dhe të kërkesave tjera. Përmbaruesi privat duhet të mbajë evidencë për rastet e pranuar dhe ato të përfunduara, në arkivin zyrtar. Evidenca përfshin të dhënat sin ë vijim:

1. emrin e Gjykatës e cila urdhëron përmbarimin ose sigurimin e kërkesës;
2. numrin e lëndës përmbarimore;
3. numrin e objektit të përmbarimit apo objektin në bazë të cilit sigurohet kërkesa;
4. të dhënat për kreditorin dhe debitorin të cilat janë të deklaruara në aktvendim për përmbarim;
5. data e pranimit të kërkesës për përmbarim dhe për mbledhjen e borxhit;
6. data e vendimit për caktimin në detyrë të përmbaruesit privat dhe data e pranimit të këtij vendimi;
7. objekti dhe mjeti i përmbarimit nëse të dhënat e tilla munden të gjinden në aktvendimin për përmbarim;
8. shuma që kërkohet;
9. vendimet të cilat i merr gjatë përmbarimit;
10. shuma e borxhit të mbledhur;
11. koha dhe rezultati i përmbarimit të kryer;
12. të dhënat për personat nga të cilët janë mbledhur borxhet dhe shuma e borxhit të mbledhur;
13. shuma përfundimtare e shpërblimit dhe kompensimit të shpenzimeve nga përmbaruesi privat;
14. numri i përgjithshëm i lëndëve në nivelin vjetor, në të cilat përmbaruesi privat ka vepruar;

Me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri së afërmi, rregullohet mënyra e mbajtjes së evidencës, mënyra e qasjes në evidencë dhe veprimi me evidence në rast vdekje, shkarkimit apo të pushimit të ushtrimit të veprimtarisë së përmbaruesit privat.¹³²

¹³² Neni 348- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

6.1 Afarizmi dhe të dhënat personale

Me qëllim të administrimit të mirë të drejtësisë, është e dëshirueshme që agjentët e përbarimit të organizohen në një organ profesional që do t'i përfaqëson të gjithë anëtarët e këtij profesioni, duke mundësuar përfaqësimin e tyre kolektiv si dhe mbledhjen e informatave.¹³³ Përbaruesi privat do të mban të dhënat për punën e tij dhe për asetet e afarizmit të tij. Këto të dhëna gjatë gjithë kohës tregojnë të drejtat dhe detyrimet e tij. Përbaruesi privat gjithashtu mban të dhënat për asetet e tij personale, gjithashtu duke përfshirë këtu edhe pasurinë e përbashkët sipas martesës ose atë të cilën e ka lidhur me një partneritet të regjistruar. Çdo vit përbaruesi privat përpilon bilancin e gjendjes sa i përket aseteve të biznesit të tij dhe aseteve të tij personale gjithashtu edhe bilancin e gjendjes së biznesit të tij duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet. Kushtet dhe procedura përkitazi me mënyrën me të cilën të dhënat e biznesit dhe ato personale aranzhohen dhe mbahen dhe specifikohen me aktin nënligjor të Ministrit të nxjerrë pas marrjes së mendimit nga Oda.¹³⁴ Përbaruesi privat, zëvendësuesi apo zëvendës përbaruesi privat janë të obliguar që të vijnë aftësimin profesional. Oda mban evidencën e seminareve dhe formave të tjera të aftësimit profesional të përbaruesit privat dhe i raporton Ministrit.¹³⁵

6.2 Detyrat përkitazi me menaxhimin dhe mbajtjen e mjeteve monetare

Përbaruesi privat mban së paku një llogari bankare e cila do të shfrytëzohet ekskluzivisht për depozitat monetare që rezultojnë nga procedurat e përbarimit. Paratë që i besohen përbaruesit privat në lidhje me punën e tij për palët e treat paguhen në këtë llogari. Nëse këto para paguhen në ndonjë llogari tjetër të përbaruesit privat gabimisht ose nëse paratë janë paguar gabimisht në një llogari të posaçme, përbaruesi privat paguan këto para në llogarinë e saktë pa vonesë. E njëjta vlen edhe nëse paratë i jepen përbaruesit privat drejtpërdrejtë. Përbaruesi privat deklaron numrin e llogarisë së posaçme në dokumentin e tij. Përbaruesi privat është ekskluzivisht i autorizuar për të administruar dhe disponuar me llogarinë e posaçme. Ai mundet t'i jep autorizim personit i cili punon nën përgjegjësinë e tij. Përbaruesi privat plotëson menjëherë defiçitin në bilancin e llogarisë së posaçme dhe është përgjegjës për defiçitin e tillë përpos nëse mundet të demonstrojë se ai nuk duhet fajësuar për defiçitin. E drejta e të gjithë parashtruesve të kërkesës mjetet e të cilëve gjinden në këtë

¹³³ Programi për Sistemin e Përbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.82).

¹³⁴ Neni 349- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹³⁵ Neni 351- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Ilogari llogariten proporcionalisht deri në shumën e paguar në këtë llogari të posaçme për dobinë e tij. Për shkak se nuk buron ndryshe nga natyra e kësaj të drejte, parashtruesi i kërkesës tërë kohën ka të drejtë në pagesën e pjesës së tij në llogari të bilancit të kësaj llogarie të posaçme. Nëse shuma e gjendur në këtë llogari të posaçme është joadekuate për të paguar shumën për pjesët e secilit kreditor valid, përmbaruesi privat mundet të i paguj kreditorin valid vetëm atë shumë që e lejojnë të drejtat e kreditorëve të tjerë valid. Në këtë rast shuma (bilanci) do të shpërndahet ndërmjet parashtruesve të kërkesës proporcionalisht sipas pjesës që i takon secilit duhet marrë parasysh se nëse përmbaruesi privat është vetë parashtrues i drejtë i kërkesës, atij i ndahet shuma e cila ka mbetur pasi të gjithë kreditorët valid të kenë pranuar pjesën në të cilën kanë të drejtë. Mjetet të cilat mbahen në llogarinë e posaçme mundet të mos jenë objekt i konfiskimit për qëllime të shlyerjes së borxheve të përmbaruesi privat. Nëse urdhri për mbledhjen e borxhit është nxjerrë kundër agjentit gjyqësor për pjesën e kreditorit valid në llogarinë e posaçme, agjenti gjyqësor i cili e ka bërë deklaratën në pajtim me dispozitat e ligjit për përmbarim, mundet të paguajë kreditorin në pajtim me deklaratën apo urdhrin pa pasur nevojë të udhëzohet nga kreditori për një gjë të tillë. Me akt nënligjor të cilin e nxjerrë Ministri rregullohet mënyra e llogaritjes, shuma më e ulët nën të cilën nuk mund të paguhet interesi dhe pagesa e interesit për paratë e paguara në llogarinë e posaçme. Interesi nuk do të paguhet më i ulët se shuma e përcaktuar nga Ministri. Përmbaruesi privat gjithashtu mban llogari të veçanta për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve si dhe për çfarëdo mjete tjera nga aktivitetet shtesë të cilat janë të përcaktuara. Nëse disa përmbarues punojnë së bashku në partneritet, llogaria e posaçme mundet të mbahet në emra të përbashkët të këtyre përmbaruesve privat, partneritetit apo kompanisë.¹³⁶

Kur jemi tek pasqyra e shpenzimeve, përmbaruesi privat ka të drejtë për shpërblim të punës së tij apo kompensim të shpenzimeve të shkaktuara në lidhje me punën e tij në pajtim me tarifën për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbarues privat. Tarifat për përmbaruesit, metoda e llogaritjes dhe shuma e shpërblimit dhe shpenzimet tjera që ndërlidhen me procedurën e cila është në zhvillim të sipër dhe transferi i rasteve dhe të dhënave nga përmbaruesi privat i shkarkuar tek përmbarues privat tjetër, përcaktohet nga Ministri me propozim të Odës dhe në konsultim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Debitori nuk është përgjegjës për çfarëdo kompensimi ose pagese të shpenzimeve përmbaruesit privat nëse ato të tejkalojnë shumat e definuara me tarifa.¹³⁷ Qartësia e tarifave është faktor i i

¹³⁶ Neni 350- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹³⁷ Neni 352- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

transparences së shpenzimeve të përbarimit. Në rastet kur agjenti I përbarimit e ka për detyrë të ofrojë këshilla të duhura, ai/ajo duhet që t'ia sqarojë qartë situatën parashtruesve të kërkesës si dhe rëndësinë e veprimeve që ata sugjerojnë të ndërmerren.¹³⁸ Shpenzimet e përbarimit duhet të barten nga të paditurit në rastet kur ai ose ajo ka mundësi që të paguajë, së bashku me mundësinë e bartjes së tarifës së performances që bartet nga parashtruesi i kërkesës. Në rastet kur përbarimi konsiderohet i gabuar apo i parregullt, përgjegjësia për shpenzimet duhet të bartet nga personat apo organet përgjegjëse për aktin e gabuar apo të parregullt.¹³⁹

7 Zëvendësuesi dhe Zëvendësi i përbaruesit privat

7.1 Zëvendësuesi i përbaruesit privat

Zëvendësuesi i përbaruesit privat zëvendëson përbaruesin privat kur ai pengohet në kryerjen e veprimeve përbarimore për shkak të sëmundjes, mungesës apo revokimit të përkohshëm të drejtës për ushtrimin e profesionit. Personat si në vijim mund të emërohen si zëvendësues të përbaruesit privat:

- përbaruesi privat;
- personi i cili plotëson kushtet për emërimin si përbarues privat;

Ministri me vendim emëron zëvendësuesin e përbaruesit privat. Vendimi i ministrit për emërimin e zëvendësuesit të përbaruesit privat është përfundimtar. Personi i cili emërohet si zëvendësues i përbaruesit privat për here të pare jep betimin para ministrit.

Mandati i zëvendësuesit përfundon:

- pas kthimit të përbaruesit privat për të cilin ka qenë zëvendësues;
- pas skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur si zëvendësues;
- pas shkarkimit nga ministri.¹⁴⁰

7.2 Të drejtat dhe detyrat e zëvendësuesit të përbaruesit privat

Personi i emëruar si zëvendësues i përbaruesit privat ka të njëjtat të drejta, detyra dhe përgjegjësi sikur përbaruesi privat. Dispozitat e ligjit për përbarim në lidhje me paraqitjen, imazhin dhe përmbajtjen e legjislacionit, kryerjen e detyrës, përgjegjësi dhe masave

¹³⁸ Programi për Sistemin e Përbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.86).

¹³⁹ Programi për Sistemin e Përbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.87).

¹⁴⁰ Neni 354- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

disiplinore të përmbaruesit privat, mos pajtueshmërinë me veprimet përmbarimore, kontrollin e punës së përmbaruesit privat dhe shkarkimin nga detyra të përmbaruesit privat vlej në mënyrë të njëjtë dhe për zëvendësuesin e përmbaruesit privat. Zëvendësuesi i përmbaruesit privat është i autorizuar të përmbrojë kërkesën për zbatimin e akteve zyrtare të adresuara për përmbaruesin privat që zëvendësohet. Ai informon kreditorin për zëvendësimin. Përmbaruesi privat i cili duhet zëvendësuar i jep zëvendësuesit të përmbaruesit privat qasjen në të dhënat e tij siç kërkohet për zëvendësimin.

Në rast të zëvendësimit për shkak të vdekjes, sëmundjes apo mungesës së përmbaruesit privat, zëvendësuesi mundet të vazhdojë me dorëzimin e të dhënave të përmbaruesit privat gjë e cila është objekt i marrëveshjes me këtë të fundit. Gjatë kryerjes së detyrave zyrtare zëvendësuesi i përmbaruesit privat e deklaron kapacitetin e vet veprues. Në rast të shkarkimit nga detyra ai nuk përmend vetëm emrin e tij por edhe emrin dhe vendin e ushtrimit të praktikës së përmbaruesit privat të cilin e zëvendëson.¹⁴¹

7.3 Zëvendës përmbaruesi privat

Përmbaruesi privat nuk mund të ketë më shumë se dy zëvendës përmbarues. Personi i cili i plotëson kushtet e parashikuara me ligjin për procedurën përmbarimore për emërimin si përmbarues privat mundet të emërohet në detyrën e zëvendësit të përmbaruesit privat. Zëvendësi i përmbaruesit privat zëvendëson përmbaruesin privat, në baza ditore, kur ai pengohet gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore për shkak të sëmundjes, festive apo mungesës së përkohshme. Gjatë veprimit në procedurën e përmbarimit dhe sigurimit të kërkesës, zëvendës përmbaruesi privat përdor logon dhe vulën e përmbaruesit për të cilin vepron. Gjatë veprimit në procedurën e përmbarimit dhe sigurimit të kërkesës zëvendës përmbaruesi privat e nxjerr kartelën e tij identifikuese dhe shenjën dalluese me emër dhe titull *zëvendës i përmbaruesit privat*. Personi i emëruar si zëvendës i përmbaruesit privat ka të njëjtat të drejta, detyra dhe përgjegjësi si përmbaruesi privat. Përmbaruesi privat është përgjegjës për punën e zëvendësit të përmbaruesit privat dhe në mënyrë solidare është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga puna e zëvendës përmbaruesit privat. Kur jemi tek dispozitat e ligjit për përmbarim, përkritazi me paraqitjen, imazhin, përmbajtjen e legjislacionit, kryerjen e detyrës, përgjegjësi dhe masave disiplinore të përmbaruesit privat, mos pajtueshmërisë me veprimet përmbarimore, kontrollin e punës së përmbaruesit privat dhe shkarkimin nga detyra të përmbaruesit privat vlej në mënyrë të njëjtë dhe për zëvendës

¹⁴¹ Neni 355- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

përmbauesin privat. Ministria përcakton me një akt të posaçëm mandatin valid dhe numrin e zëvendës përmbauesve privat të cilët do të punojnë në të njëjtën kohë nën përgjegjësinë e një përmbauesi privat.¹⁴²

Tani kur ndalemi tek emërimi i zëvendës përmbauesit privat, Ministri me vendim emëron zëvendësin e përmbauesit privat me propozim të përmbauesit privat. Vendimi i Ministrit për emërimin e zëvendës përmbauesit privat është përfundimtar. Personi i emëruar si zëvendës i përmbauesit privat merr përsipër detyrën e tij në ditën kur ai jep betimin para ministrit. Betimi do të jetë sin ë vijim:

*``Beto hem se do të respektojë ligjet e Kosovës dhe do të kryejë detyrën e zëvendësit të përmbauesit privat me ndërgjegje, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme``.*¹⁴³

7.4 Përfundimi i mandatit si zëvendës përmbaues

Mandati i zëvendës përmbauesit privat përfundon me:

- 1) njoftimin me shkrim nga ana e përmbauesit privat dërguar Ministrit dhe zëvendësit të tij se përmbauesi privat tërheq përzgjedhjen e bërë për zëvendësin;
- 2) lirim nga detyra apo vdekjen e përmbauesit privat që ka caktuar zëvendësin;
- 3) tërheqjen e miratimit apo skadimin e mandatit për të cilin është dhënë emërimi;
- 4) emërimin e zëvendës përmbauesit privat si përmbaues privat.¹⁴⁴

8 Mbikqyrja

8.1 Kontrolli ndaj punës së përmbauesve privat

Mbikqyrja ndaj ligjshmërisë së punës së përmbauesit privat dhe të Odës e kryen Ministria nëpërmjet të personave të autorizuar (inspektorëve) të Ministrisë, sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e Kryetarit të Gjykatës kompetente për territorin e së cilës është emëruar përmbauesi privat, Kryetarit të Odës, si dhe me iniciativën e palëve dhe të pjesëmarrësve në procedurë. Ministria është autorizuar të:

- 1) bëjë shikimin në librat afarist, evidencën, shkresat dhe të sendeve të magazinuara;

¹⁴² Neni 356- Ligji për procedurën përmbauesve i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁴³ Neni 357- Ligji për procedurën përmbauesve i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁴⁴ Neni 358- Ligji për procedurën përmbauesve i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

- 2) kerkojë nga përmbauesi publik të gjitha të dhënat e nevojshme për afarizmin e tij;
- 3) marrin nga organet kompetente dhe organizatat të dhëna për afarizmin e përmbauesve privat;
- 4) inicojnë procedurën disiplinore kundër përmbauesit public apo zëvendësuesit të përmbauesit publik.

Në kuadër të kryerjes së mbikëqyrjes së ligjshmërisë së punës të përmbauesit privat dhe Odës, personi i autorizuar zyrtari i Ministrisë, mund të urdhëroj masa për mënjanimin e të metave në punën e përmbauesit privat, dhe të caktojë afatin për të vepruar sipas atyre masave.¹⁴⁵

Në mënyrë që të bëjë kontrollin e cilësisë së procedurës përmbaimore, çdo shtet anëtar duhet t'i përcaktojë kriteret/standardet evropiane të cilësisë të cilat synojnë të bëjnë vlerësimin vjetor të shërbimeve të përmbaimit përmes një sistemi të pavarur shqyrtimi dhe inspektimi të rastësishëm në terren. Të dhënat e performancës duhet të bazohen në mostra përfaqësuese dhe duhet të publikohen. Këto kritere të vlerësimit mund të përcaktohen në nivel evropian, në mënyrë që të forcohet besimi mes shteteve anëtare, veçanërisht kur merret parasysh tendenca në rritje e numrit të rasteve të përmbaimit ndërkombëtar.¹⁴⁶ Autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen ose kontrollin e agjentëve të përmbaimit kanë një rol të rëndësishëm edhe në garantimin e cilësisë së shërbimeve të përmbaimit. Duhet të sigurohen që aranzhimet për monitorimin e aktiviteteve të agjentëve të përmbaimit nuk e pengojnë vazhdimin e qetë të punës së tyre. Medoemos duhet të cekim edhe procedurat disiplinore dhe sanksionet, ku shkelja e ligjeve, rregulloreve dhe rregullave të etikës nga agjentët e përmbaimit, dhe nëse është jashtë fushëveprimit të aktiviteteve të tyre profesionale, duhet t'i ekspozojë ata ndaj sanksioneve disiplinore pa parajgykuar sanksionet eventuale civile dhe penale. Procedurat disiplinore duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur. Duhet të hartohet një listë e hollësishme e ndëshkimeve që përcakton shkallën e masave disiplinore sipas peshës së shkeljes.¹⁴⁷

¹⁴⁵ Neni 359- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁴⁶ Programi për Sistemin e Përmbaimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.89).

¹⁴⁷ Programi për Sistemin e Përmbaimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.89).

8.2 Komisioni profesional për vlerësimin e përmbartimit

Për të siguruar që vlerësimi për zbatimin e përmbartimit të kryhet në kontinuitet dhe që mbikëqyrja e aktiviteteve të përmbartuesve të mos rrezikoj punën e tyre të papengueshme, Ministri emëron komisionin profesional për vlerësimin e përmbartimit prej shtatë anëtarëve dhe zëvendësuesve të tyre. Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e komisionit emërohen për periudhën prej katër vitesh.

Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e komisionit, Ministri i emëron nga rradhët e: Gjykatës themelore (dy anëtar dhe zëvendës anëtar); Gjykatës së Apelit (një anëtar dhe një zëvendës anëtar); Gjykatës Supreme (një anëtar dhe një zëvendës anëtar); Këshilli Gjyqësor (një anëtar dhe një zëvendës anëtar); Fakulteti juridik (një anëtar dhe një zëvendës anëtar); Ministria e drejtësisë (një anëtar dhe një zëvendës anëtar). Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Gjykatës themelore, Gjykatës themelore, Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme i propozon Këshilli Gjyqësor. Kryesuesin e Komisionit e zgjedhin anëtarët e Komisionit përmes votimit të fshehtë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, në takimin e saj konstitutiv. Për kryerjen e punëve profesionale dhe administrative për Komisionin, Ministria i cakton zyrtarët nga rradhët e të punësuarve në Ministrinë e Drejtësisë.¹⁴⁸

8.3 Mbledhjet dhe mbikëqyrja e punës së përmbartuesve privat nga Oda

Komisioni punon në mbledhje, në të cilën marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit. Komisioni vendos me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Në punën e Komisionit mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, edhe ekspertë në çështjet të cilat gjenden në rend dite të Komisionit, me ftesën e kryesuesit të Komisionit, përfaqësuesit e institucioneve tjera dhe të shoqërisë civile kur bëhet fjalë për çështjet lidhur me përmbartimin. Komisioni, pas marrjes së pëlqimit të ministrit, nxjerrë rregulloren e punës, me të cilën më për së afërmi rregullon mënyrën e punës, konvokimit dhe mbajtjes së mbledhjeve, punës publike si dhe çështje tjera me rëndësi për punën e Komisionit.¹⁴⁹ Ministria siguron kushtet dhe mjetet e domosdoshme për punën e Komisionit, në pajtim me dispozitat e ligjit për përmbartim. Anëtarëve të Komisionit për punën e tyre në takime u takon e drejta në shpërblim në pajtim me vendimin e veçantë të Ministrit.¹⁵⁰ Mbikëqyrja ndaj punës së përmbartuesit privat dhe zëvendës përmbartuesit privat

¹⁴⁸ Neni 360- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁴⁹ Neni 361- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁵⁰ Neni 362- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

do të kryhet edhe nga Oda. Oda kryen mbikqyrjen sipas detyrës zyrtare së paku një herë në vit.

Oda mundet të inspektojë objektet, të dhënat dhe materialin tjetër arkivor të përmbaruesit privat, llogarinë bankare, menaxhimin e objekteve të ruajtura dhe paratë e vendosura si sigurim, dëftesat për paratë e mbledhura si shpërblim apo tarifë e përmbaruesit privat sikurse edhe merr masa tjera në pajtim me ligjin dhe aktet tjera ligjore dhe së këndejmi urdhëron përmbaruesin privat në fjalë të largojë parregullsitë dhe të caktojë afatin kohor për respektimin e tyre. Oda është e autorizuar të urdhërojë përmbaruesin privat të eliminojë të gjitha mangësitë në punën e tij/saj në kuadër të afatit të specifikuar kohor dhe shqipton masat tjera disiplinore në pajtim me ligjin dhe dispozitat tjera. Raportin për kontrollin e kryer Oda ia dërgon Ministrisë. Mënyrën e kryerjes së kontrollit së punës së përmbaruesve privat e përcakton Kuvendi i Odës.¹⁵¹

8.4 Raporti për punën e përmbaruesit privat

Para se të ndalemi tek raporti për punën e përmbaruesit privat, është mirë të cekem raportimet e procedurave të përmbarimit në përgjithësi siç janë:

- a) Raportimi për secilën masë të përmbarimit - I pandehuri duhet të informohet për nivelin e përgjegjësisë së tij gjatë procesit të përmbarimit;
- b) Raportimi për procedurën e përfunduar të përmbarimit – Sapo të jenë përmbaruesit interesat e parashtruesit të kërkesës, ky informacion duhet t`i komunikohet atij.

Nëse ndalemi tek mënyra e raportimit, shtetet anëtare inkurajohen fuqishëm që të hartojnë së bashku standardet evropiane të cilësisë për informacionin që duhet t`ju jepet palëve dhe publikut të gjerë në lidhje me procedurat e përmbarimit.¹⁵²

Tani kur jemi tek raporti për punën e përmbaruesit privat, përmbaruesi privat është i detyruar që një herë në vit Ministrisë dhe Odës të ia dorëzojë raportin vjetor të punës brenda tre muajve. Ministri nxjerr akt nënligjor për mënyrën e raportimit dhe të përmbajtjes së raportit.

Raportet vjetore përfshijnë të dhënat si në vijim:

- numrin e përgjithshëm të lëndëve në punë;
- numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura;

¹⁵¹ Neni 363- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁵² Programi për Sistemin e Përmbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.88.)

- numrin e përgjithshëm të lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit dhe, dhe
- raporti i shumicës së mjeteve të përgjithshme të realizuara me veprime përmbarimore dhe shuma e përgjithshme e kërkesave;
- të dhënat nga raporti vjetor i përmbaruesit privat shpallen ne ueb faqen zyrtare të Ministrisë dhe Odës, të dhënat nga ai raport janë publike derisa nuk shpallen të dhënat për vitin e ardhshëm.¹⁵³

8.5 Përgjegjësia disiplinore e përmbaruesit privat

Përmbaruesi privat ka përgjegjësi disiplinore nëse me veprimet e tij në ushtrimin e veprimtarisë së vetë shkel dispozitat e ligjit dhe të dispozitave tjera, nëse nuk i plotëson detyrimet e parapara me statut dhe me akte tjera të Odës, dhe nëse shkel prestigjin e profesionit të përmbaruesit privat.

Përmbaruesit privat në procedurën e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore mund ti shqiptohen vetëm masa disiplinore të cilat janë të parapara me ligjin për procedurë përmbarimore. Përgjegjësia për vepër penale apo kundërvajtje nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të përmbaruesit privat.¹⁵⁴

8.5.1 Fillimi i procedurës disiplinore

Propozimin për fillimin e procedurës disiplinore mund ta paraqesin Ministria dhe kryetari i Odës, sipas iniciativës së vet si dhe sipas ankesave dhe iniciativave të palëve në procedurë, të përfaqësuesve të palëve dhe të autorizuarve të tyre. Propozim sipas ankesës dhe iniciativës së palëve mund ta paraqes edhe kryetari i Gjykatës kompetente për territorin e së cilës është emëruar përmbaruesi privat.¹⁵⁵

8.5.2 Shkeljet disiplinore

Shkeljet e ligjeve, rregulloreve apo rregullave të etikës të kryera nga agjentët e përmbarimit, madje edhe jashtë fushëveprimit të aktiviteteve të tyre profesionale, duhet të ekspozohen me sanksione disiplinore, pa paragjykuar sanksionet civile dhe penale eventuale. Procedurat disiplinore duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur. Shtetet anëtare duhet të marrin në konsideratë futjen e një sistemi për filtrimin paraprak të rasteve që paraqiten thjesht si taktika vonuese. Duhet të hartohet një listë e qartë e sanksioneve, duke përcaktuar një

¹⁵³ Neni 364- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁵⁴ Neni 365- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁵⁵ Neni 366- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

shkallë masash disiplinore sipas seriozitetit të veprës penale. Largimi ose "goditja" duhet të përfshijë vetëm shkeljet më të rënda (parimi i proporcionalitetit midis shkeljes dhe sanksionit duhet të respektohet).¹⁵⁶

Shkeljet disiplinore mund të jenë:

- 1) nëse përmbaruesi privat tejkalon autorizimet e besuara me ligjin;
- 2) nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit;
- 3) nëse përmbaruesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 4) nëse përmbaruesi privat ka shkeluar detyrat e parashikuara me ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;
- 5) nëse përmbaruesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 6) nëse përmbaruesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;
- 7) nëse përmbaruesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 8) nëse përmbaruesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;
- 9) nëse përmbaruesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbarimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;
- 10) shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera;
- 11) nëse përmbaruesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.¹⁵⁷

8.5.3 Masat disiplinore

Masat disiplinore për shkeljet disiplinore janë si në vijim:

- 1) vërejtja;
- 2) vërejtja publike;
- 3) gjoba në të holla nga pesëqind deri tremijë Euro;
- 4) ndalimi i ushtrimit të profesionit në kohëzgjatje prej tre muaj deri në një vit;
- 5) shkarkimi nga detyra.

¹⁵⁶ European Commission On the Efficiency of Justice (CEPEJ), Guidelines for a Better Implementation of the Existing Council of Europe's Recommendation On Enforcement, adopted by the CEPEJ at its 14th plenary meeting. Strasbourg, 9-10 December 2009. Shih. <https://rm.coe.int/16807473cd>.

¹⁵⁷ Neni 367- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Ministri mund ta suspendoj përmbaruesin privat gjatë kohës sa zgjat procedura disiplinore. Me rastin e shqiptimit të masave disiplinore merren për bazë të gjitha rrethanat të cilat mund të ndikojnë në llojin e masave dhe atë posaçërisht pasojat e shkeljes, dëmi i shkaktuar, shkalla e përgjegjësisë dhe masat e mëhershme disiplinore.¹⁵⁸

8.6 Komisioni disiplinor

Komisioni disiplinor zbaton procedurën disiplinore për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit privat dhe shqipton masat disiplinore në pajtim me ligjin për përmbarim.¹⁵⁹

8.6.1 Përbërja e komisionit

Komisioni disiplinor, të cilën e emëron Ministri, përbëhet nga tre anëtar edhe atë:

- dy anëtarë nga rradhët e gjyqtarëve, të cilët i propozon këshilli gjyqësor i Kosovës; dhe
- një anëtarë nga rradhët e përmbaruesve privat të cilin e propozon Oda.

Kryetari dhe anëtarët e komisionit disiplinorë kanë zëvendësit e tyre. Anëtarët e komisionit disiplinorë emërohen për një mandat dy vjeçar, dhe mund përsëri të emërohen. Anëtarët e komisionit disiplinor kanë të drejtë në shpërblimin për punën nga mjetet e Odës, në lartësi të cilën e cakton ministri sipas propozimit të Odës së përmbaruesve. Duhet të cekim që dispozitat e ligjit për përmbarim për përgjegjësinë dhe për procedurën disiplinore të përmbaruesve privat përshtatshëmrishtë zbatohet edhe për zëvendësit dhe zëvendësuesit e përmbaruesit privat.¹⁶⁰

8.7 Procedura disiplinore

Procedura disiplinore konsiderohet se ka filluar në ditën e dorëzimit të propozimit për ngritjen e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat. Komisioni disiplinor menjëherë ai dërgon përmbaruesit privat propozimin për ngritjen e procedurës disiplinore, i cili në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh ka të drejtë që të paraqes mbrojtje me shkrim lidhur me propozimin.¹⁶¹

¹⁵⁸ Neni 368- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁵⁹ Neni 369- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁶⁰Neni 370- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁶¹ Neni 372- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

8.7.1 Seanca dëgjimore

Kryesuesi cakton datën e seancës dëgjimore për rastin. Komisioni disiplinor fton përmbartesin privat dhe palën ankuese që të paraqiten në seancë dëgjimore së paku dhjetë ditë përpara seancës. Propozuesit për ngritjen e procedurës disiplinore së bashku me ftesën i dërgohet edhe përgjigjia me shkrim. Nëse gjatë dëgjimit shqyrtimi i rastit shtyhet apo pezullohet për një periudhë kohore, asnjë njoftim i ri nuk ka efekt sikurse u referua më lartë. Seanca dëgjimore e komisionit disiplinor është publike. Për arsye me rëndësi, Komisioni disiplinor mund të urdhërojë që dëgjimi plotësisht apo pjesërisht të mbahet pa publikun. Përmbartuesi privat dhe ankuesi mund të ndihmohen apo përfaqësohen nga një avokat. Komisioni disiplinor mund të refuzojë individët e caktuar si mbrojtës nëse ata nuk janë jurist. Komisioni disiplinor poashtu i jep përmbartesit privat dhe ankuesit si dhe avokatëve të tyre apo të tjerëve të cilët i ndihmojnë ata, një mundësi për të marrë shënime për dokumentet që ndërlidhen me rastin. Përmbartesit privat dhe ankuesit apo avokatëve të tyre dhe të tjerëve të cilët i ndihmojnë ata, u jepet mundësi t'i drejtohen komisionit disiplinor dhe të shtjellojnë qëndrimin e tyre. Komisioni disiplinor mund të thirrë dhe dëgjojë dëshmitarët dhe ekspertët. Një nga anëtarët e komisionit disiplinor mundet të udhëzohet të dëgjojë dëshmitarët dhe ekspertët. Çdokush i thirrur si dëshmitar apo ekspertë respekton thirrjen. Më tej nga ai kërkohet që të përgjigjet në pyetjet e bëra apo të ofroj shërbimet e kërkuara. Dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore vlejnë përshtatshëm për dëshmitarët dhe ekspertët. Pas zbatimit të procedurës disiplinore komisioni disiplinor nxjerr vendim. Procedura disiplinore më hollësisht do të rregullohet me akt nënligjor të Ministrisë.¹⁶²

8.7.2 Vendimi i komisionit disiplinor

Si rrjedhojë e vendimit të komisionit disiplinor përkitazi me aktesën kundër përmbartesit privat, ankesa shpallet e paparanueshme, e pabazë apo e bazuar. Vendimi duhet të përmbajë arsyetimin dhe të shpallet. Nëse komisioni disiplinor shpall ankesën plotësisht apo pjesërisht të bazuar, ai do të shqiptojë masa disiplinore siç parashikohen. Veprimi disiplinor merret vetëm pasi që vendimi është bërë i plotfuqishëm apo shtyhet për më vonë nëse është përcaktuar në vendim. Pa vonesë komisioni disiplinor i përcjell vendimin me shkrim Ministrisë, përmbartesit privat dhe Odës. Vendimi shpallet publikisht në faqen zyrtare të Ministrisë dhe të Odës. Vendimi i komisionit disiplinor është përfundimtar. Kundër vendimit

¹⁶² Neni 373- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

të komisionit disiplinor mund të ngritet konflikti administrativ.¹⁶³ Procedura disiplinore mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një vit nga dita e shkeljes.¹⁶⁴

8.8 Përfundimi, pezullimi dhe lirimi nga detyra i përmbaruesit privat

Funksioni i përmbaruesit privat pushon:

- *në rast të vdekjes;*
- *kur e mbushë moshën shtatëdhjetë vjeçar;*
- *në rast të dorëheqjes me shkrim;*
- *në rast se me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës është dënuar për vepër penale në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj burgim, apo për ndonjë vepër që e bënë të padenjë në ushtrimin e funksionit të përmbaruesit privat;*
- *në rast se përmbaruesi privat nuk fillon punën e tij brenda periudhës së paraparë me ligjin për përmbarim;*
- *në rast të shkarkimit.*

Për pushimin e ushtrimit të funksionit të përmbaruesit privat Ministria e njofton oden dhe Gjykatën kompetente në territorin e të cilës përmbaruesi privat ka pasur selinë. Me kërkesë të Ministrit përmbaruesi privat kryen shërbimet e përmbarimit gjatë tre muajve të ardhshëm derisa Ministri të nxjerr vendim për emërimin e përmbaruesit të ri privat apo zëvendësuesit të përmbaruesit privat.¹⁶⁵ Kur jemi tek dorëheqja, përmbaruesi privat në çfarëdo kohe, mund të kërkojë të lirohet nga detyra e tij. Kërkesa i paraqitet me shkrim Ministrit. Afati kohor për lirim e tij nga detyra është tre muaj. Pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar, me të cilën detyra e përmbaruesit privat pushon, Ministri nuk e cakton ndonjë afat tjetër kohor. Ministri duhet të merr vendim para skadimit të afatit kohor të përcaktuar më parë.¹⁶⁶

Tani ndalemi tek shkarkimi i përmbaruesit privat, ku Ministri me vendim shkarkon përmbaruesin privat nëse:

- *dëshmohet se ai nuk përmbush kushtet për emërimin e përmbaruesit privat;*
- *përmbaruesi privat pranon çfarëdo funksioni siç parashikohet me ligjin për përmbarim;*

¹⁶³ Neni 374- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁶⁴ Neni 375- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁶⁵ Neni 376- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁶⁶ Neni 377- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

- *ai fillon të përdor pensionin e pleqërisë;*
- *zotësia për të vepruar e përmbaruesit privat merret apo kufizohet me aktvendim të Gjykatës;*
- *përmbaruesi privat humb në mënyrë të përhershme zotësinë për të kryer funksionin;*
- *përmbaruesit privat i shqiptohet masa disiplinore e marrjes së autorizimit të tij për përmbarimin dhe sigurimin e kërkesës;*
- *nëse përmbaruesi privat dënohet me vepër penale me aktgjykim të plotëfuqishëm dhe kundër të cilit shqiptohet dënimi prej më së paku gjashtë muaj burgim, e cila e bën atë të padenjë të kryejë funksionin e përmbaruesit privat.¹⁶⁷*

Kur jemi këtu tek shkarkimi duhet të përmendim faktin se shkarkimi i përmbaruesit privat tek ne dhe në disa vende në Evropë dallon. Ndonjëherë agjentët përmbarimor në Evropë emërohen për pesë vite p.sh. në Belgjikë, Franë, Greqi, Hungari, Letoni, Portugali, pra shkarkimi mund të bëhet automatikisht pas pesë viteve.¹⁶⁸

Vendimin për shkarkim tek ne e nxjerr Ministri. Në vendimin për shkarkim të përmbaruesit privat Ministri cakton zëvendësuesin e përmbaruesit privat. Vendimi për pushimin e ushtrimit të funksionit të përmbaruesit privat dhe vendimi për shkarkim të përmbaruesit privat nuk mund të ankimohet në procedurën administrative, por kundër tyre mund të fillohet konflikti administrativ.¹⁶⁹

8.9 Oda e përmbaruesve privat të Kosovës

Oda e përmbaruesve privat të Kosovës është organizatë profesionale në të cilën bashkohen të gjithë përmbaruesit privat. Selia e odës është në Prishtinë. Oda e ka statusin e personit juridik dhe punon si organizatë jo profitabile.¹⁷⁰ Oda përfaqësohet nga kryetari dhe kur ai mungon nga zëvendësit e tij bazuar nga vjetërsia e përvojës juridike.¹⁷¹ Kur jemi tek autorizimet e odës , mund te themi që Oda:

- *ruan prestigjin, dinjitetin dhe të drejtat e profesionit të përmbaruesit privat;*
- *nxjerr statutin, kodin e etikës së përmbaruesve privat dhe aktet tjera në pajtim me ligjin dhe statutin e odës;*

¹⁶⁷ Neni 378- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁶⁸ Programi për Sistemin e Përmbarimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.121.)

¹⁶⁹ Neni 379- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁷⁰ Neni 380- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁷¹ Neni 381- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

- përfaqëson përmbauesit para institucioneve publike për qëllime të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të profesionit;
- kujdeset që përmbauesi privat që të veprojë në mënyrë të ndërgjegjshme dhe në pajtim me ligjin ti kryejnë punët e tyre;
- kujdeset për avancimin profesional të përmbauesve privat nëpërmjet organizimit të takimeve profesionale, seminareve dhe punëtorive profesionale në fushën e përmbaimit;
- vendos dhe realizon bashkëpunimin me odat e përmbauesve të shteteve tjera; dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin e odës.¹⁷²

Statuti dhe aktet e përgjithshme të odës rregullojnë organizimin dhe aktivitetet e odës si dhe organet, përbërjen e tyre dhe procedurat e emërimit të tyre. Ministri jep pëlqimin në statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Odës.¹⁷³

8.9.1 Organet e Odës

Organet e Odës janë:

1. Kuvendi i Odës;
2. Bordi Ekzekutiv;
3. Këshilli i Kontrollit dhe Kryetari i Odës.¹⁷⁴

8.9.2 Kuvendi

Kuvendi i Odës përbëhet nga të gjithë përmbauesit privat dhe zëvendësit e përmbauesve privat të regjistruar në regjistrin e Ministrisë.

Kuvendi i Odës është kompetent për:

- nxjerrjen e statutit të Odës, rregullave të procedurës së përmbauesve privat dhe kteve tjera të përgjithshme të Odës;
- përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv dhe anëtarëve të tjerë të Odës;
- vendos për shumën e pagesës së anëtarësisë dhe mënyrën e pagesës së saj;
- vendos për çështjet e parashikuara me ligjin dhe statutin e Odës.¹⁷⁵

¹⁷² Neni 382- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁷³ Neni 383- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁷⁴ Neni 384- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁷⁵ Neni 385- Ligji për procedurën përmbaimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Mbledhjet e jashtëzakonshme të kuvendit të odës thirren në rastet e parapara me statutin e odës. Puna publike dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e kuvendit të odës rregullohen me statutin e odës.¹⁷⁶

8.9.3 Bordi Ekzekutiv

Bordi ekzekutiv ka kompetencë për të:

- *zgjedhur kryetarin e bordit ekzekutiv nga rradhët e anëtarëve të vet;*
- *propozon draftin e statutit dhe aktet tjera të përgjithshme të odës;*
- *përgaditur seancat dhe zbatimin e vendimeve të kuvendit të odës;*
- *kujdeset për afarizmin e odës;*
- *vendos për çështjet tjera në pajtim me ligjin për përmbarim dhe statutin e odës.*

Çdo vit bordi përpilon një raport për aktivitetet e kuvendit të odës. Këtë raport t`ia përcjell Ministrit jo më vonë se 31 Mars të secilit vit. Çdo vit bordi përpilon politikën e tij financiare dhe buxhetin për vitin e ardhshëm financiar me shënime sqaruese dhe i dërgon këto dokumente kuvendit për miratim.¹⁷⁷

Bordi ekzekutiv përbëhet nga një numër tek më së paku shtatë anëtarë. Përbërja e bordit sa më shumë që është e mundur pasqyron përpjesëtimin në kuadër të kuvendit ndërmjet përmbaruesve privat dhe zëvendës përmbaruesve privat. Kryesuesi dhe zëvendësi i tij duhet të jenë përmbarues privat. Anëtarët emërohen për mandate tre vjeçar dhe pas dorëheqjes kanë të drejtë për riemërimin edhe njëherë për të njejtën periudhë.¹⁷⁸

8.9.4 Kryetari dhe Këshilli i Kontrollit

Kryetari i odës prezanton dhe përfaqëson odën. Kryetari i bordit ekzekutiv është edhe kryetar i odës. Kryetari i odës ka autorizime të:

- kujdeset se a po respektohen parimet e kryerjes së ndërgjegjshme të detyrave të përmbaruesit privat;
- kujdeset që oda po punon dhe zhvillon aktivitetet në pajtim me ligjin;
- implementon vendimet e organit të odës kur parashikohet me statut të odës;
- emëron personelin e odës dhe
- kryen punë tjetër siç parashihet me statut të odës.

¹⁷⁶ Neni 386- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁷⁷ Neni 387- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁷⁸ Neni 388- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Kryetarit të odës në cilësinë e tij i besohet kryesimi i Kuvendit.¹⁷⁹

Këshilli i kontrollit ka tre anëtar me mandat prej tre vjetëve. Këshilli i kontrollit kryen kontrollin e ligjshmërisë së punës dhe afarizmit financiar të odës. Këshilli i kontrollit për aktivitetin e tij i përgjigjet kuvendit të odës. Kur këshilli i kontrollit gjen shkelje të statutit, akteve nënligjore apo vendimeve të kuvendit të odës, ai përpilon raport dhe ia prezanton bordit ekzekutiv respektivisht kuvendit të odës.¹⁸⁰

9 Pasuria e Odës

Pasuri e odës do të përbëhet nga:

- *kontributet e detyrueshme vjetore dhe kontributet plotësuese nga ana e anëtarëve të saj;*
- *pagesat për shërbime;*
- *donacionet dhe lënja e pronës me testament;*
- *burime të tjera.*¹⁸¹

Oda bart tërë shpenzimet që burojnë nga ekzekutimi i detyrave të besuara me ligjin për përmbarrim, ku për të mbuluar këto shpenzime ajo mundet të ngarkojë anëtarët e vet me pagesa vjetore të anëtarësisë. Me propozim të bordit ekzekutiv, kuvendi përcakton madhësinë e pagesës së anëtarësisë për vitin financiar. Shuma mund të jetë e ndryshme për kategoritë e ndryshme të anëtarëve. Përmbarruesit privat i bëjnë pagesat e kërkuara odës duke u bazuar në kushtet e specifikuar në aktet nënligjore të odës dhe në pajtim me vendimet e kuvendit të odës.¹⁸² Oda nxjerr dhe akte nënligjore. Aktet nënligjore miratohen sa i përket temave që në pajtim me ligjin për përmbarrim rregullohen me akte nënligjore. Aktet nënligjore nuk përmbajnë detyrime apo kërkesa të cilat nuk janë të domosdoshme për të realizuar objektivin e parashikuar me akt nënligjor. Propozimet për akte nënligjore i paraqiten kuvendit të odës nga bordi ekzekutiv. Aktet nënligjore të odës janë obligative vetëm për anëtarët dhe organet e saj. Një akt nënligjor mund t'i jep pushtet bordit ekzekutiv që të përcaktojë rregulla më të detajuara përkitazi me temën me të cilën merret ky akt nënligjor.¹⁸³ Propozimi për akt nënligjor së bashku me shënimet sqaruese i kumtohen anëtarëve të odës së paku dy muaj para

¹⁷⁹ Neni 389- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁸⁰ Neni 390- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁸¹ Neni 391- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁸² Neni 392- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁸³ Neni 393- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

dates në të cilën do të diskutohen në kuvendin e odës¹⁸⁴. Aktet nënligjore të propozuara nga oda duhet të marrin miratimin e Ministrit. Miratimi mund të kthehet prapa nëse ky akt është në kundërshtim me ligjin ose interesin publik.

Pas miratimit nga ana e bordit ekzekutiv, bordi angazhohet që akti nënligjor të bëhet i njohur me botimin e tij në gazetën zyrtare. Akti nënligjor bëhet obligativ vetëm pas botimit. Ai hyn në fuqi një muaj pas publikimit apo edhe më herët nëse e përcakton bordi me mirëkuptimin ku së paku dhjetë ditë duhet të kalojnë nga data e publikimit dhe e hyrjes në fuqi.¹⁸⁵

¹⁸⁴ Neni 394- Ligji për procedurën përmbareme i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁸⁵ Neni 395- Ligji për procedurën përmbareme i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Kreu IV

IV. PËRMBUSHJA E PËRMBARIMIT: BORXHET NË TË HOLLA-IDENTIFIKIMI, SEKUESTRIMI DHE SHITJA E SENDEVE. BORXHET JO MONETARE.

1 Pasuria monetare

Përmbarimi i borxhit në të holla ka për qëllim mbledhjen e të hollave për ta përmbushur obligimin ndaj kreditorit. Të hollat mund të mblidhen drejtpërdrejt përmes pagesës vullnetare ose përmes bartjes së mjeteve monetare, siç janë të ardhurat apo gjendja në llogarinë bankare. Të hollat poashtu mund të mblidhen nëpërmjet shitjes së sendeve të luajtshme ose të paluajtshme. Mënyra dhe fushëveprimi i përmbarimit përcaktohet me vendimin mbi përmbarimin. Parimisht, gjykata e cila e nxjerr aktvendimin për përmbarim është edhe gjykatë që e zbaton atë aktvendim.

Përmbarimi mbi pasurinë monetare është mënyra e preferuar e përmbarimit sepse pasuria monetare bartet shpejtë te kreditori me qëllim të përmbushjes së obligimit monetar. Pasuria monetare përfshinë paratë e gatshme ose ekuivalentin e tyre, detyrimin monetar ndaj debitorit, gjendjet në llogaritë bankare, dhe të ardhurat.¹⁸⁶

Kemi raste kur tek rradha e realizimit të kredive janë më shumë kreditor. Në qoftë se janë më shumë se një propozues të përmbarimit që duhet t'i realizojnë kreditë e tyre ndaj debitorit të njëjtit dhe nga i njëjti objekt i përmbarimit, atëherë ata i realizojnë ato sipas rradhës me të cilën e kanë fituar të drejtën që nga objekti i tillë ta realizojnë kredinë, përveçse kur me ligj parashihet ndryshe.¹⁸⁷ Përmbarimi për realizimin e kredive në të holla caktohet dhe zbatohet në vëllimin që është i domosdoshëm për realizimin e kërkesave të tilla.¹⁸⁸

¹⁸⁶ USAID. (2007, fq.37). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbimore në Kosovë. Shih.

[http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

¹⁸⁷ Neni 80- Ligji për procedurën përmbimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁸⁸ Neni 81- Ligji për procedurën përmbimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

2 Përrjashtimi nga përmbbarimi

Përrjashtohen nga përmbbarimi sendet në vijim:

- veshjet, këpucët, ndërresat dhe gjësendet tjera personale, çarçafët, veglat e kuzhinës, orenditë, stufa, frigoriferi dhe objektet tjera me vlerë të zakonshme që shërbejnë për përmbushjen e nevojave themelore të familjes, nëse janë të nevojshme nga debitori dhe familjarët e tij;
- furnizimi me ushqim për tre muaj dhe materialet për nxehje që shfrytëzohen nga debitori dhe familjarët e tij;
- kafshët e punës dhe mbarështimit, pajisjet bujqësore dhe mjetet tjera, farërat, ushqimi për kafshë, mjetet, makinat dhe objektet tjera që i duhen debitorit, bujkut apo zanatliut për vazhdimin e punës në bujqësi, respektivisht në kryerjen e aktivitetit të zanatit, të nevojshme për të fituar të ardhurat minimale të nevojshme për të mbajtur veten dhe familjarët e tij;
- librat dhe objektet tjera që janë të nevojshme nga debitori që në mënyrë të pavarur dhe me punë personale të kryej një aktivitet shkencor, artistik apo aktivitet tjetër profesional;
- të hollat e gatshme të debitorit i cili ka të hyra mujore të përhershme deri në shumën mujore që sipas ligjit përjashtohet nga përmbbarimi e proporcionalisht me afatin kohor deri në pagesën e ardhshme;
- dekorimet, medaljet, çertifikatat ushtarake të nderit apo dekoratat tjera të debitorit për vlerësimin e nderit, unazën e martesës, letrat personale, manuskriptet apo dokumentet tjera personale që i përkasin debitorit si dhe fotografitë e familjes; dhe
- mjetet mjekësore që i jepen personave me aftësi të kufizuara apo personave tjerë me paaftësi fizike në pajtim me rregulloret, apo që i ka përvetësuar personalisht dhe që janë të domosdoshme për kryerjen e funksioneve jetësore.¹⁸⁹

¹⁸⁹ Neni 85- Ligji për procedurën përmbbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Përveç përjashtimeve që i cituam më lartë, do e ilustruam dhe një tabelë:

Përjashtimet (92 LPP) Sendet që nuk mund të sekuestrohen	Kufizimet (93 LPP) Sendet që mund të sekuestrohen pjesërisht
<ul style="list-style-type: none"> *Alimentacioni, kompensimet e dëmit nga humbja e shëndetit (humbja e aftësisë për punë), kompensimi i dëmit për shkak të vdekjes së kujdestarit; *Kompensimi për shkak të lëndimit; *Të ardhurat e ndihmës sociale; *Të ardhurat në bazë të papunësisë së përkohshme; *Shtesat fëmijërore; *Bursa dhe ndihma për studentë; *Të ardhurat e ushtarëve; *Kompensimi për punë i personit të dënuar, përveç për pagesat e alimentacionit ose kompensim të demit të shkaktuar nga vepra penale; *Të ardhurat në bazë të medaljeve dhe dekoratave të luftës; *Kompensimet për udhëtime dhe ushqimi ditor. 	<ul style="list-style-type: none"> *Deri në 1/2 e të ardhurave personale ose pensionit për kërkesat që kanë të bëjnë me alimentacion, kompensim të dëmit nga humbja e shëndetit (humbja e aftësisë për punë), kompensim të dëmit për shkak të vdekjes së ushqyesit; *Deri në 1/3 e të ardhurave personale ose pensionit për të gjitha kërkesat tjera; *Deri më 1/3 e të ardhurave personale minimale të garantuara për kërkesat që kanë të bëjnë me alimentacion, kompensim të dëmit nga humbja e shëndetit (humbja e aftësisë për punë), kompensim të dëmit për shkak të vdekjes së ushqyesit; *Deri më 1/4 të ardhurave personale minimale të garantuara për të gjitha kërkesat tjera; *Të ardhurat personale të invalidëve të luftës dhe invalidëve ushtarak për të njëjtat kërkesa.

Në tabelën e mësipërme përfshihen vlerat të cilat nuk mund të konfiskohen (përjashtimet) dhe ato që mund të merren pjesërisht (kufizimet). Këto janë pak a shumë të përafërta me ato që i cekëm më lartë, por kjo është një formë pak më ndryshe.¹⁹⁰

3 Kompetenca territoriale në rast të përmbarrimit gjyqësor dhe nga përmbarruesi privat

Për të vendosur mbi propozimin për përmbarrim për sendet e luajtshme, si dhe për zbatimin e përmbarrimit të tillë, kompetente në pikëpamje territorial është Gjykata në territorin e së cilës ndodhen ato sende sipas të dhënave të shkruara në propozimin për përmbarrim. Këto dispozita zbatohen në mënyrë të përshtatur edhe në rastet në të cilat përmbarrimi fillon sipas detyrës zyrtare. Kreditori mund të kërkojë që organi përmbarrimor të nxjerrë aktvendimin për përmbarrimin për sendet e luajtshme, duke mos e përmendur vendin e

¹⁹⁰ USAID. (2007, fq.37). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarrimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

ndodhjes së tyre. Për vendosje për këtë propozim, të kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit, e nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i tij, kur kemi të bëjmë me personin fizik. Kur debitori është person juridik, kompetente është Gjykata në territorin e së cilës ai e ka selinë e tij. Të cekim që kreditori i përmbarrimit aktvendimin për përmbarrim mund t`ia parashtrijë secilës Gjykatë me kompetencë lëndore në territorin e së cilës ndodhen sendet e luajtshme të debitorit, me propozim që kjo Gjykatë të zbatojë përmbarrimin.¹⁹¹

Kur jemi tek kompetenca në rast të përmbarrimit nga përmbarruesi privat, për të vendosur mbi propozimin për përmbarrim për sendet e luajtshme, si dhe për zbatimin e përmbarrimit të tillë, përmbarruesi privat ka kompetencë për të vendosur për propozimin përmbarrimor dhe të zbatojë përmbarrimin për sendet e luajtshme duke përfshirë edhe sendet e luajtshme që nuk i dihet vendi.¹⁹² Në qoftë se Gjykata e ka caktuar përmbarrimin për sendet e luajtshme që ndodhen në territorin e saj dhe të Gjykatës tjetër, atëherë pas kryerjes së përmbarrimit për sendet e luajtshme në territorin e saj, aktvendimin për përmbarrimin do t`ia dërgojë Gjykatës tjetër për përmbarrim të mëtejme deri në realizimin e plotë të kredisë së kreditorit të përmbarrimit. Gjykata nga e cila është larguar rasti, me përfundimin e largimit, nuk ka më kompetencë në lidhje me rastin.¹⁹³

4 Veprimet përmbarrimore

Përmbarrimi për sendet e luajtshme zbatohen me anë të regjistrimit dhe vlerësimit të tyre, sekuestrimit, shitjes së sendeve dhe përmbushjen e kredisë së kreditorit nga shuma e fituar nga shitja e atyre sendeve.¹⁹⁴

4.1 Njoftimi dhe objekti i sekuestrimit

Tek njoftimi për sekuestrim, organi përmbarrues në parim para se të filloj sekuestrimin, debitorit ia dorëzon aktvendimin për përmbarrimin dhe e urdhëron që ta paguaj menjëherë shumën e të hollave bashkë me kamatat dhe shpenzimet procedurale, për të cilën është lejuar përmbarrimi. Nëse është e pamundshme që t`i dorëzohet debitorit aktvendimi apo urdhri përmbarrimor në rastin e sekuestrimit, atëherë lejohet kryerja e njoftimit duke vendosur një

¹⁹¹ Neni 82- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁹² Neni 83- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁹³ Neni 84- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁹⁴ Neni 86- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

njoftim për datën e sekuestrimit në tabelën e shpalljeve të organit përbarimor dhe të lihet një kopje e vendimit përbarues në lokalet ku bëhet sekuestrimi. Për kohën dhe vendin e sekuestrimit të sendeve të luajtshme, kreditori do të njoftohet nga organi përbarimor. Mos prania e palëve nuk e pengon kryerjen e sekuestrimit. Për sekuestrimin e kryer njoftohet pala e cila nuk ka qenë e pranishme në vendin e sekuestrimit të kryer.¹⁹⁵ Kur jemi tek objekti i sekuestrimit, mund të themi që sekuestrimi bëhet me anë të përpilimit të regjistrit të inventarizimit. Inventarizohen sendet e luajtshme që ndodhen në posedim të debitorit, si dhe sendet e debitorit që ndodhen në posedim të kreditorit. Në qoftë se personat e tretë nuk e njoftojnë organin përbarimor për të drejtat e tyre për sendet në posedim të debitorit, e as nuk i provojnë të drejtat e tyre për to në afat prej tridhjetë ditëve nga data e njoftimit dhe më së voni tre muaj nga data e sekuestrimit, merret se të drejtat e tilla të personave të tretë nuk ekzistojnë dhe se debitori është pronar i sendeve që ndodhen në posedimin e tij. Supozohet se bashkëshortët martesor dhe jashtëmartesor janë bashkëpronar në pjesë të barabarta të gjitha sendeve të luajtshme që gjenden në shtëpinë, banesën ose lokalit afarist të tyre. Sendet e debitorit që ndodhen në posedim të personit të tretë mund të inventarizohen vetëm me pëlqimin e këtij të fundit që e përmendëm. Në qoftë se personi i tretë nuk e jep pëlqimin për inventarizim, organi përbarues me propozimin e kreditorit, këtij të fundit ia kalon të drejtën e debitorit që t'i dorëzohen sendet nga i treti.¹⁹⁶

Kemi edhe raste kur kemi mungesë të sendeve që ligji lejon të sekuestrohen, ku me plot kuptimin e fjalës mund të themi që një ndër arsytet që lëndët e grumbulluara për përbarim nuk janë përbaruar me sukses është mungesa e sendeve të debitorit që do të ishin objekt përbarimi ashtu si e kërkon ligji. Në shumicën e raste ku është lejuar përbarimi në bazë të dokumenteve të besueshem-faturave nuk ka asgjë për të sekuestruar sepse te debitori nuk gjenden sende, nëse përdorim shprehjen e SHBA-ve, debitori është rezistent ndaj aktvendimit. Ky problem është evident në një vend si Kosova që ka shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë.¹⁹⁷

¹⁹⁵ Neni 87- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁹⁶ Neni 88- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁹⁷ Revistë shkencore juridike, Opinio Juris, nr.1/2015 (Fq.123). Shih. http://jus.igjk.rks-gov.net/572/1/P%C3%ABrbarimi%20i%20vendimeve%20gjyq%C3%ABsore_Shqip_OK.pdf

4.2 Ruajtja dhe ndalimi i disponimit me sendet e inventarizuara

Sendet e inventarizuara organi përmbaues ia lenë për ruajtje debitorit. Me propozimin e kreditorit organi përmbaues mund të vendosë që ato t'i dorëzohen për ruajtje atij. Rrezikun e asgjësimit apo të dëmtimit të sendeve të inventarizuara të dhëna për ruajtje kreditorit e bartë ky i fundit, përveçse kur asgjësimi ose dëmtimi është pasojë e fuqisë madhore. Paratë e gatshme, letrat me vlerë dhe sendet e çmueshme të inventarizuara dorëzohen në depozitën e organit përmbaues. Në depozitën e autoritetit përmbaues mund të dorëzohen edhe sendet tjera me vlerë më të madhe, po qe se janë të papërshtatshme për këtë lloj ruajtje.¹⁹⁸ Tek ndalimi i disponimit me sendet e inventarizuara, secili person që i posedon apo mbikqyrë sendet e inventarizuara, i ndalohet që të disponojë me sendet e tilla pa urdhrin e organit përmbaues¹⁹⁹. Duhet ta cekim edhe faktin që kreditori e fiton të drejtën e pengut për sendet e luajtshme të inventarizuara. Në qoftë se inventarizimi është bërë në dobi të më tepër kreditorëve, rradha e përparësisë së të drejtës së pengut, e fituar me anë të inventarizimit apo shënimit në regjistrin e inventarizimit sekuestrues, caktohet sipas dates në të cilën ka arritur tek organi përmbaues propozimi përmbaues. Po qe se propozimet e tilla kanë arritur tek organi përmbaues në të njëjtën ditë, atëherë të drejtat e pengut konsiderohen se janë të rradhës së njëjtë. Propozimi për përmbauesim i dërguar tek organi përmbaues me anë të letrës rekomande, konsiderohet se është dorëzuar tek organi përmbaues në ditën kur ajo i është dorëzuar postës. Propozimi për përmbauesim i dorëzuar tek organi përmbaues përmes komunikimit elektronik, nëse lejohet nga organi përmbaues, konsiderohet se i është dorëzuar organit përmbaues në datën kur është dërguar komunikimi elektronik, në pajtim me ligjin për procedurën kontestimore.²⁰⁰ Po qe se me rastin e sekuestrimit, në pasurinë e debitorit nuk gjenden sende të luajtshme që mund të bëhen objekt përmbauesimi, organi përmbaues për një gjë të tillë do ta njoftojë kërkuesin e përmbauesimit nëse nuk ka qenë i pranishëm gjatë sekuestrimit.²⁰¹

4.3 Vlerësimi dhe rivlerësimi i sendeve të sekuestruara

Në rastin e sekuestrimit të sendeve, organi përmbaues e bënë edhe vlerësimin e vlerës së sendeve të luajtshme. Vlerësimin e bënë organi përmbaues, po qe se Gjykata nuk e ka

¹⁹⁸ Neni 90- Ligji për procedurën përmbauesimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

¹⁹⁹ Neni 91- Ligji për procedurën përmbauesimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁰⁰ Neni 92- Ligji për procedurën përmbauesimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁰¹ Neni 93- Ligji për procedurën përmbauesimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

caktuar për një gjë të tillë vlerësuesin gjyqësor apo ekspertin e posaçëm, ose përmbaruesi privat ka caktuar një ekspert të posaçëm.

Pala mund të propozojë që vlerësimin ta bëjë eksperti edhe kur një gjë e tillë nuk e ka paraparë organi përmbarues. Nëse organi përmbarues e miraton propozimin e tillë, shpenzimet e ekspertimit është i detyruar ti parapaguaj propozuesi brenda afatit të caktuar nga organi përmbarues. Nëse parapagimi nuk bëhet brenda afatit të caktuar, nga organi përmbarues, konsiderohet se propozuesi ka hequr dorë nga propozimi i tij. Shpenzimet e ekspertizës mbeten barrë e propozuesit, pavarësisht se çfarë mund të jetë përfundimi i procedurës përmbarimore.²⁰²

Secila palë ka të drejtë që brenda afatit prej tre ditësh, nga dita e vlerësimit të bërë të sendeve të sekuestruara, që t'i propozojë organi përmbarues caktim të vlerës më të vogël apo më të madhe të sendeve të sekuestruara nga ajo e caktuar më parë, apo caktim të vlerësimit të ri. Një gjë e tillë nuk lejohet po që se vlerësimin e parë e ka bërë eksperti.²⁰³

Për regjistrimin dhe vlerësimin sekuestrues Gjykata përpilon procesverbal. Në procesverbal veç e veç tregohen sendet e sekuestruara dhe vlera e tyre e caktuar, si dhe shënohen deklaratat e palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë të procedurës, e edhe ato të personave të tretë për ekzistimin eventual të të drejtave të tyre që mund ta pengojnë përmbarimin për sendet e sekuestruara. Në sendet e sekuestruara vihet shenja e caktuar nga e cila shihet se janë të sekuestruara. Kreditori ka të drejtë që në procesverbalin e organit përmbarues të përpiluar me rastin e sekuestrimit të sendeve të debitorit ta publikojë në mjetet e informimit publik.²⁰⁴ Në qoftë se pas sekuestrimit të bërë caktohet përmbarimi tjetër për sendet e sekuestruara me qëllim të realizimit të kërkesës tjetër të njëjtit kreditor, apo të kërkesës së kreditorit tjetër, nuk do të bëhet regjistrimi dhe vlerësimi i sërishëm i sendeve të sekuestruara, veçse në vazhdimin e procesverbalit do të bëhet vetëm shënimi i të dhënave nga aktvendimi i mëvonshëm për përmbarimin.²⁰⁵

4.4 Koha dhe mënyra e shitjes së sendeve të sekuestruara

Shitja e sendeve të sekuestruara kryhet jo më herët se pesëmbëdhjetë ditë dhe jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e sekuestrimit. Shitja mund të bëhet edhe para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë ditë, po që se debitori propozon, apo pajtohet me propozimin e kreditorit

²⁰² Neni 94- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁰³ Neni 95- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁰⁴ Neni 96- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁰⁵ Neni 97- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

që shitja e sendeve të sekuestruara të bëhet më herët. Shitja e sendeve të sekuestruara mund të bëhet para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh, po qe se sendet e këtilla prishen shpejtë, apo kur ekziston mundësia që të bie dukshëm çmimi i tyre pas një kohe të shkurtër. Në qoftë se kreditori jep garancinë për dëmin eventual që do të duhej kompenzuar debitorit në rast të anulimit të vendimit për përmbarrimin, shitja e sendeve të sekuestruara mund të bëhet edhe para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh.²⁰⁶

Kur jemi tek mënyra e shitjes së sendeve të sekuestruara, mund të themi se shitja e sendeve të sekuestruara bëhet me anë të ankandit verbal publik ose me ujdinë e drejtpërdrejtë midis blerësit, nga njëra anë dhe organi përmbarrues apo subjekti tjetër të autorizuar, nga ana tjetër. Mënyra e shitjes së sendeve caktohet me anë të konkluzionit të organit përmbarrues, duke pasur parasysh faktin që të arrihet çmimi më i volitshëm për debitorin. Ankandin publik të shitjes e administron organi përmbarrues, apo personi tjetër i caktuar nga organi përmbarrues. Shitja me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë bëhet midis blerësit, nga njëra anë dhe organit përmbarrues, apo personit që kryen veprime komisioni nga ana tjetër. Organi përmbarrues sendet e sekuestruara i shet në emër dhe në llogari të debitorit, kurse personi që merret me veprime komisioni, në emër të vet por për llogari të debitorit. Shitja me anë të ankandit do të caktohet në qoftë se është fjala për sendet e sekuestruara që kanë vlerë të madhe, ndërkaq mund të pritet se ato do të shiten sipas çmimit më të lartë nga sa është shuma e vlerësuar.²⁰⁷ Shitja me ankand e rrit koston e përmbarrimit dhe e zgjat procedurën. Kurdo që është e mundshme, zyrtarët për përmbarrim duhet të favorizojnë shitjen me marrëveshje, përveç nëse ligji në mënyrë eksplicite e parasheh shitjen në ankand. Shitja me ankand ka qenë problematike në praktikë.²⁰⁸

4.4.1 Seanca e parë e shitjes publike

Sendet e sekuestruara mund të shiten në ankandin e parë me çmim më të vogël se ai i caktuar, por jo me çmimin më të vogël se tetëdhjetë përqind (80%) e vlerës së caktuar me rastin e regjistrimit dhe vlerësimit të sendeve të luajtshme të debitorit, respektivisht në afatin që e ka caktuar organi përmbarrues për shitjen e tyre me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë. Ankandi i parë mbahet brenda tridhjetë ditëve nga data e sekuestrimit. Nëse sendet e

²⁰⁶ Neni 98- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁰⁷ Neni 99- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁰⁸ USAID. (2007, fq.47). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarrimore në Kosovë. Shih.

[http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

sekuestruara nuk shiten me çmimin minimal të lejuar, organi përbarues konstaton dështimin e shitjes dhe fton kreditorin që të propozojë ankandin e dytë brenda pesëdhjetë ditëve.²⁰⁹

4.4.2 Seanca e dytë e shitjes publike

Me propozimin nga palët, organi përbarues e cakton ankandin e ri në të cilin sendet e sekuestruara mund të shiten me çmim jo më të vogël se sa pesëdhjetë përqind (50%) e çmimit të përcaktuar gjatë vlerësimit së tyre. Propozimin për ankand tjetër, ose për shitjen me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë, pala mund ta paraqesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e ankandit të parë, respektivisht nga dita e skadimit të afatit të caktuar nga organi përbarues për shitje me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë. Ankandi i dytë mbahet brenda tridhjetë ditëve të propozimit për ankandin e dytë. Në qoftë se pasuritë nuk shiten brenda afatit prej gjashtëdhjetë ditësh nga dita e ofertës së parë për shitje apo në rast të tentimit të pasuksesshëm për shitje, atëherë kreditori mund të kërkojë transferimin e sendeve në pronësi të tij, për mbulim të pjesshëm apo të plotë të kredisë në çmim të vlerësuar të atyre sendeve.²¹⁰ Shitja me ankand ka qenë problematikë në praktikë. Ankandet kanë qenë të pasuksesshme për shkak të mungesës së interesimit të blerësve. Mirëpo, kjo është duke u përmirësuar, posaçërisht në qendrat urbane.²¹¹ Ta përmendim edhe faktin që organi përbarues e pezullon përbarimin në qoftë se asnjëra nga palët nuk paraqet propozim për ankandin e dytë, apo për shitjen me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë, respektivisht nëse kreditori nuk paraqet propozim për transferin e sendeve në pronësi të kreditorit, brenda afatit të paraparë.²¹² Nëse i çekim të drejtat dhe detyrimet e blerësit, atëherë themi se blerësi ka për detyrë ta depozitojë çmimin blerës dhe sendet t'i marrë përsipër menjëherë pas përfundimit të ankandit, apo të shitjes me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë. Organi përbarues do t'ia dorëzojë blerësit sendet edhe para se do ta ketë depozituar shumën e caktuar, në qoftë se për këtë gjë në rrezik të vet e jep pëlqimin kreditori brenda suazave të shumës që do t'i takonte nga çmimi i realizuar i shitjes.²¹³

²⁰⁹ Neni 100- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²¹⁰ Neni 101- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²¹¹ USAID. (2007, fq.47). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përbarimore në Kosovë. Shih.

[http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²¹² Neni 102- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²¹³ Neni 103- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

5 Kalimi (transferi) i kredisë

Kredi e sekuestruar i kalohet kreditorit në pajtim me propozimin e tij për arkëtim ose në vend të pagesës. Në qoftë se kreditori nuk e cakton në mënyrë decitive llojin e kalimit të kredisë, konsiderohet se e propozon kalimin me qëllim arkëtimi.²¹⁴ Aktvendimi apo urdhri për kalimin e kredisë nxirret vetëm pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi apo urdhri për sekuestrimin. Në qoftë se kreditori ka propozuar që debitori i debitorit të deklarohet për kredinë për të cilën propozohet përmbarimi, organi përmbarues do të nxjerrë aktvendimin apo urdhrin për propozimin për kalimin, pas skadimit të afatit prej tre ditësh, nga dita kur kreditorit i është dërguar njoftimi për deklarimin e debitorit të debitorit.²¹⁵ Në aktvendimin për përmbarimin, urdhrin për përmbarim apo në aktvendimin e posaçëm për kalimin e kredisë, do të ftohet debitori i debitorit që shumën e detyruar të hollave t'ia deponojë organit përmbarues duke paguar në llogarinë e caktuar dhe për një gjë të tillë ta njoftojë organin përmbarues.²¹⁶ Kredia që bazohet në letrën me vlerë, që kalohet me nënshkrim, ose për realizimin e së cilës nevojitet parashtrimi i kësaj letre, ose që për shkaqe tjera nuk mund të pjesëtohet lidhur me kalimin ose realizimin, mund të kalohet vetëm në shumën e saj të plotë. Në qoftë se kjo shumë e tejkalon shumën e kërkesës së kreditorit të ekzekutimit, kredia e sekuestruar do të kalohet vetëm pasi kreditori të depozitoj garancion se këtë tepricë do t'ia dorëzojë organi përmbarues.²¹⁷ Kredia që pjesërisht është e përjashtuar nga përmbarimi i detyrueshëm, apo e cila është sekuestruar në dobi të personave të tjerë, kalohet vetëm pasi që kreditori të depozitoj garancion se organi përmbarues do t'ia dorëzojë pjesën që është përjashtuar nga përmbarimi i detyrueshëm. Po qe se më tepër kreditor kanë paraqitur propozime për kalim të kredisë jo në ditë të njëjtë, organi përmbarues do ta bëjë kalimin e kredisë në kreditorin e përmbarimit që e ka paraqitur propozimin i pari. Në qoftë se më tepër propozues të përmbarimit kanë paraqitur propozimin në të njëjtën ditë, kredia do të kalohet në propozuesin e përmbarimit kërkesa e të cilit është më e madhe.²¹⁸

Shtrohet pyetja se cila ka qenë mënyra e zgjidhjes së rastit konkret kur kanë qenë më shumë kreditor por nuk kanë ekzistuar përmbaruesit privat? Si ka vepruar gjykata? Në rastet kur ka pasur më tepër kreditor, gjykata ka mbajtur një seancë për të vendosur mbi

²¹⁴ Neni 126- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²¹⁵ Neni 127- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²¹⁶ Neni 128- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²¹⁷ Neni 129- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²¹⁸ Neni 130- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

shpërndarjen e çmimit të shitjes. Të gjithë kreditorë janë thirrur në seancë. Kriteret për vlerësimin e prioriteteve kanë qenë më poshtë:

1. Pranueshmëria- kreditorët për t'u konsideruar të pranueshëm, duhet të kenë vendim të vlefshëm dhe efektiv në kohën e shitjes
2. Prioriteti- kreditorët të cilëve ligji u jep prioritet përmbushen të parët. Të gjithë kreditorët tjerë përmbushen në bazë të rradhës sipas të cilës e kanë marrë të drejtën e pengut mbi sendet, p.sh kreditori me vendim më të vjetër të përmbartimit përmbushet i pari.²¹⁹

Në seancë, kreditorët mund kanë pasur mundësinë të kontestojnë nivelin e çmimit dhe rradhën e përparësisë së kërkesave. Nëse gjykata konstaton se ka çështje për të cilat duhet vendosur, atëherë do ta udhëzojë personin që të parashtrorë padi në procedurën kontestimore.²²⁰ Nëse është parashtruar padi në procedurën kontestimore, procedura e përmbartimit pezullohet deri në zgjidhjen e kontestit. E nëse nuk ngriteshte kontesti gjatë seancës, gjykata nxjerrte vendim sipas të cilit çmimi i shitjes zbatoheshte sipas këtij prioriteti:

1. Gjykatës për pagesën e shpenzimeve të procedurës së përmbartimit. P.sh. shpenzimet e mbajtjes në depo, shpenzimet e ankandit, etj;
2. Kreditorit për pagesën e shpenzimeve të kërkuara në dokumentin e parashtruar si bazë për përmbartim;
3. Kreditorit për pagesën e kamatës së akumuluar që nga dita e shitjes;
4. Kreditorit për pagesën e borxhit kryesor, sipas të drejtës së prioritetit;
5. Debitorit nëse ka tepricë.²²¹

Kalimi i kredisë së bazuar në letrën me vlerë, e cila pas sekuestrimit të bërë i merret debitorit të debitorit, quhet e kryer në momentin kur organi përmbartues letrën në të cilën shënohet vendimi për kalimin i dorëzohet kreditorit. Kalimin e kredisë së bazuar në letrën me vlerë që kalohet me nënshkrim, apo për realizimin e së cilës nevojitet parashtrimi i saj, quhet e kryer në momentin kur organi përmbartues në letrën e tillë e vë vendimin për kalimin dhe letrën e pajisur me vendimin e tillë ia dorëzon kreditorit.²²²

²¹⁹ USAID. (2007, fq.48). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbartimore në Kosovë.Shih.
[http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²²⁰ USAID. (2007, fq.48). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbartimore në Kosovë.Shih.
[http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²²¹ USAID. (2007, fq.49). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbartimore në Kosovë.Shih.
[http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²²² Neni 131- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

Ti përmendim të detyrimet e debitorit dhe të kreditorit, ku debitori ka për detyrë që në afatin e caktuar nga organi përmbarues, e me kërkesën e kreditorit në të cilin është bartur kredia, t'i jep shpjegime kreditorit që i janë të nevojshme për realizimin e kredisë së tillë dhe t'ia dorëzojë dokumentet që kanë të bëjnë me këtë kredi. Kreditori në të cilin është bartur vetëm një pjesë nga kredia, ka për detyrë që në qoftë se debitori e kërkon këtë, brenda afatit të cilin e cakton organi përmbarues të jep garancion se pas realizimit të kredisë së tillë, do t'i kthejë dokumentet që kanë të bëjnë me kredinë. Organi përmbarues, me propozimin e kreditorit, do ta zbatojë përmbarimin e detyrueshëm kundër debitorit për dorëzimin e dokumenteve, po qe se ai vetë nuk i dorëzon. Dorëzimin e dokumenteve që ndodhen te personi i tretë, kreditori mund ta kërkojë me anë të padisë, po qe se këtë të drejtë e ka debitori. Në dokumentin që i dorëzohet kreditorit, organi përmbarues do të shënoj se është kryer kalimi i kredisë për të cilën është caktuar përmbarimi.²²³ Debitori i debitorit të cilit i është dorëzuar aktvendimi për përmbarimin, apo urdhri për përmbarim, ose aktvendimi i posaçëm për kalimin, e përmbushë obligimin e vet duke depozituar shumën e të hollave, apo letrat me vlerë, te organi përmbarues. Në qoftë se me qëllim të realizimit të kredisë në të holla të kaluara, kreditori është dashur të fillojë procedurë gjyqësore apo procedurë tjetër, atëherë Gjykata apo organi tjetër që zhvillon procedurën, në vendimin me të cilin e miraton kërkesën e kreditorit të përmbarimit do ta urdhërojë debitorin e debitorit që shumën e detyruar ta depozitoj te organi përmbarues. Në bazë të vendimit me të cilin debitori i debitorit është urdhëruar që shumën e detyruar ta depozitoj te organi përmbarues, sipas kreditorit të propozuesit të përmbarimit në të cilin është bartur kredia, do të zbatohet përmbarimi kundër debitorit dhe të hollat e realizuar me këtë përmbarim pas pagimit të shpenzimeve procedurale sipas detyrës zyrtare, do t'i dërgohen organit përmbarues.²²⁴ Me kalimin e kredisë me qëllim arkëtimi, dhe për qëllim të njoftimit të debitorit të debitorit për transferimin, autorizohet kreditori që të kërkojë nga debitori i debitorit përmbarimor pagimin e shumës së shënuar në aktvendimin apo urdhrin e përmbarimit, apo në aktvendimin e posaçëm për kalimin, në qoftë se kjo shumë është bërë e kërkueshme, t'i kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për ruajtjen dhe realizimin e kredisë së kaluar, si dhe t'i shfrytëzojë të gjitha të drejtat lidhur me pengun të dhënë për sigurimin e kredisë së këtillë. Me kalimin e kredisë me qëllim arkëtimi, kreditori nuk ka të drejtë që në barrë të debitorit të lidhë ujdi, apo që debitorit të debitorit t'ia falë borxhin, ose që të disponoj me kredinë e kaluar, si dhe që me debitorin e debitorit të merret vesh që vendimin për kredinë, po qe se është kontestuese ajo të nxjerrë arbitrazhin. Kreditorit

²²³ Neni 132- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²²⁴ Neni 133- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

në të cilin është bartur kredia për arkëtim, debitori i debitorit mund t'ia bëjë vetëm ato prapësime që do të mund t'ia bënte debitorit. Cedimi i kredisë së bartur i bërë nga debitori pas kalimit të saj, nuk ka efekt juridik kundrejt të drejtave që i ka fituar që i ka fituar kreditori në momentin e kalimit të saj.²²⁵

Për të garantuar qasje në drejtësi, skemat e ndihmës juridike, apo skemat alternative të financimit, duhet të jenë në dispozicion të paditësve të cilët nuk janë në gjendje të paguajnë tarifat e përmbartimit. Ku ndihma juridike është siguruar, shteti mund nëse konsiderohet e drejtë, të pajisë veten me mekanizmat që lejojnë kthimin e shpenzimeve të tij nga të ardhurat e përmbartimit.²²⁶

6 Përmbartimi për kredinë sipas llogarisë në bankë

Përmbartimi për realizimin e kredisë në të holla kundër debitorit, mund të zbatohet për të gjitha mjetet monetare që i ka në llogaritë e tija në bankë, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe. Me aktvendim për përmbartimin ose urdhrin për përmbartimin në mjetet monetare që evidentohen në llogarinë e transaksionit të debitorit, urdhërohet banka që shumën e të hollave për të cilën është caktuar përmbartimi, ta kalojë nga llogaria e transaksioneve të debitorit në llogarinë e transaksioneve të kreditorit, kurse për kreditë për të cilat nuk është paraparë pagimi nëpërmjet llogarisë në bankë, që t'ia paguajë shumën e tillë kreditorit me para të gatshme. Përmbartimi me kredi në të holla, e cila sipas kursimit të depozituar, llogarisë rrjedhëse, llogarisë devizore, apo llogarisë tjetër në bankë, duke përjashtuar llogarinë e transaksionit të debitorit, i takon debitorit dhe caktohet ashtu që me anë të aktvendimit apo urdhri për përmbartimin, urdhërohet banka që shumën e të hollave për të cilën është caktuar përmbartimi, t'ia paguaj kreditorit shumën e përcaktuar për përmbartim.²²⁷ Kemi :

- Kompetencën territoriale në rast të përmbartimit gjyqësor- ku, kërkesa për përmbartim në para të gatshme në xhirollogarinë e debitorit futet në juridiksionin e Gjykatës ku gjendet selia e bankës apo në territorin ku gjendet njësi organizative e bankës në të cilën debitori mban xhirollogarinë e tij;²²⁸

²²⁵ Neni 134- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²²⁶ Programi për Sistemin e Përmbartimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i Misionit të USAID-it në Kosovë. (Tetor 2011, Fq.196.)

²²⁷ Neni 152- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²²⁸ Neni 153- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës.Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

- Kompetencën në rast të përmbarrimit nga përmbarruesi privat- ku, për të vendosur për propozimin përmbarrimor për përmbarrim në para të gatshme në xhirollogarinë, përmbarruesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbarrimor dhe ta zbatojë përmbarrimin.²²⁹

Në fakt, gjendja në llogarinë bankare është rast special i borxhit monetar që i detyrohet debitorit. Në fakt kur personi e hap një llogari bankare dhe depoziton të holla në atë llogari, banka bëhet debitor i atij personi për shumën e cila gjendet në atë llogari. Janë disa dispozita të cilat e mbështesin përmbarrimin në llogarinë bankare të debitorit:

- përmbarrimi në xhirollogarinë e debitorit, llogarinë devizore ose ndonjë llogari tjetër në atë bankë si një rast special të përmbarrimit në të hollat që i detyrohen debitorit.
- Përmbarrimi në mjetet publike nëpërmjet llogarisë së debitorit. Në këtë pjesë, në mënyrë specifike ceket `` Shërbimi i kontabilitetit shoqëror``. Ky shërbim nuk ekziston më. Mirëpo derisa bankat komerciale, nën mbikqyrjen e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës``, kryejnë aktivitete të njëjta sikurse Shërbimi i Kontabilitetit Shoqëror, mund të thuhet se ato janë institucione pasardhëse.²³⁰

Në secilin rast, më praktike duket që kërkesat për përmbarrim në llogarinë bankare të debitorit të trajtohen si rast special i përmbarrimit mbi debitorin e debitorit. E vërteta është se deponimi i të hollave në llogari bankare krijon obligim për bankat ndaj deponuesit për atë shumë të deponuar.²³¹

Organi përmbarrues do të dorëzojë drejtpërdrejtë bankës vendimin për përmbarrim ose urdhrin për përmbarrim. Personi zyrtar i bankës do të regjistron datën dhe kohën kur i është dorëzuar bankës aktvendimi apo urdhri për përmbarrim. Një kopje e këtij aktvendimi apo urdhri për përmbarrim i dërgohet edhe Bankës Qendrore të Kosovës. Me aktvendimin për përmbarrim ose urdhrin për përmbarrim, organi përmbarrues e obligon bankën që të informojë me kohë organin përmbarrues se a ka debitori llogari në bankë dhe që të ia zbulojë asaj të gjitha numrat e llogarive që i ka debitori në bankë. Nëse debitori i cili është borxhli vërtetohet që është klient apo ka qenë klient, se ka ndonjë llogari në atë bankë, banka është e obliguar që të ia dërgojë organit përmbarrues të gjithë historinë e transaksioneve në të gjitha llogaritë e debitorit në atë bankë së paku për periudhën që fillon tridhjetë ditë para ditës së nxjerrjes së

²²⁹ Neni 154- Ligji për procedurën përmbarrimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²³⁰ USAID. (2007, fq.38). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarrimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²³¹ USAID. (2007, fq.39). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarrimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

aktvendimit apo urdhrin për përbarim nga ana e organit përbarues e që përfundon me përfundimin e orarit të punës një ditë para ditës kur i dërgohet organit përbarues historia e transaksioneve. Kjo histori e transaksioneve do të jetë transkript i saktë i shënimeve normale të bankës për llogaritë, e përpiluar nga banka gjatë aktiviteteve të tyre të parregullta të punës, dhe do të përmbajë çdo transaksion në ato llogari, duke përfshirë edhe tërheqjen e parave të gatshme, shumat e zbritura ose tërheqjet nga llogaritë e debitorit, e po ashtu edhe transferet brenda bankës dhe ndërmjet bankave.

Banka është e obliguar të përgjigjet në kërkesën e organit përbarues për informacione, për ekzistencën e llogarive në bankë që janë në pronësi të debitorit, jo më larg se njëzet e katër orë pas pranimit të kërkesës nga organi përbarues. Banka është e obliguar të paraqes historinë e transaksioneve për secilën llogari brenda 3 dite nga pranimi i kërkesës. Banka do të mbaj shënime ku tregohet data dhe koha kur janë pranuar të gjitha urdhrat e organit përbarues. Banka do ti dërgoj organit përbarues njoftimin për të gjitha ndryshimet e bëra pas dates në të cilën historia e transaksioneve, i është dërguar bankës. Këto njoftime do ti dërgohen organit përbarues brenda një dite pune për secilin transaksion në llogari, përfshirë edhe depozitat ose tërheqjet e parave të gatshme, shumat e zbritura apo tërheqjet nga llogaritë e debitorit, si dhe transferet e tyre brenda bankës apo ndërmjet bankave. Pasi banka të ketë marrë nga organi përbarues urdhrin për transferet, agjenti i bankës që pranon urdhrin e regjistron kohën dhe datën e saktë në të cilën është pranuar urdhri për transferet, dhe ai informacion do të regjistrohet në shënimet normale të punës së bankës. Nëse ka fonde të mjaftueshme në ndonjërin apo në të gjitha llogaritë e debitorit për të paguar kredinë në kohën kur merret urdhri për transferet, banka brenda 60 minutash nga koha e pranimit të urdhrin për transferet, do t'i transferojë fondet nga llogaria e debitorit në llogarinë e organit përbarues në emër të kreditorit të shënuar në urdhrin për transferet. Koha e saktë e transferit regjistrohet në shënimet e zakonshme të punës së bankës dhe i raportohet organit përbarues si pjesë e raportit që banka ia dërgon organit përbarues duke shënuar kohën e marrjes së urdhrin të organit përbarues, kohën dhe shumën e transferit, numrin ose numrat e llogarive nga të cilat janë tërhequr fondet dhe pala ose numri i llogarisë që e pranon transferin.²³²

Si një pikë që duhet poashtu të ceket është edhe identifikimi se a ka apo jo debitori llogari bankare e cila është treguar e vështirë në praktikë. Kur kanë qenë kompetent gjykatat për përbarim, bankat iu kanë ofruar shumë pak bashkëpunim për qëllime përbarimi. Ligji ka

²³² Neni 155- Ligji për procedurën përbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

paraparë se gjykata mund të kërkojë informata nga debitori i debitorit lidhur me borxhet që i detyrohen debitorit, ku këto dispozita zbatoheshin ndaj bankës e cila mbante llogarinë e debitorit.²³³ Në rastet në të cilat gjykatat nuk kanë qenë të informuara mbi numrin e llogarisë bankare, këto informata duhet ti merrnin nga banka në të cilën gjendej llogaria pasi që këto informata nuk merreshin nga Autoritet qendror bankar i Kosovës sepse nuk ka bazë qendrore të të dhënave mbi llogaritë bankare. Kërkesa për informata (apo për përmbarim) duhet të shkojë te banka përkatëse me qëllim të marrjes së informative për zbatimin e suksesshëm të përmbarimit. Është me rëndësi të kihet parasysh se debitorët mund të kenë disa llogari bankare në disa banka të ndryshme, posaçërisht debitorët e mëdhenjë.²³⁴

Nëse fondet në llogari janë të pamjaftueshme për të përmbushur urdhrin për transfer, banka do të bëjë menjëherë bllokimin e të gjitha llogarive të debitorit në fjalë, duke parandaluar çdo tërheqje të fondeve, për çfarëdo qellimi apo në çfarëdo forme, derisa banka të ketë përmbushur shumën e cekur në urdhrin e organit përmbarues për vendosjen e bllokimit, do të theksojë numrin e llogarisë, apo llogarive që janë bllokuar, kohën dhe datën kur është bërë bllokimi i atyre llogarive, dhe për shumën që gjendet në secilën llogari. Pas marrjes së urdhrin për transfer, debitori i përmendur në urdhër nuk do të lejohet të hap llogari të tjera në bankë derisa të jetë përmbushur urdhri, ose derisa të hiqen urdhrat e organit përmbarues për bllokimin e llogarisë. Banka nuk mund të përmbushë asnjë urdhër të debitorit deri sa ai të ia ketë paguar organit përmbarues shumën e plotë të kredisë ose deri sa të informohet nga organi përmbarues se është hequr urdhri. Organi përmbarues e njofton bankën për lirimin e llogarive të debitorit pas pagesës së plotë të kredisë, ose pas përfundimit të procesit të përmbarimit. Me kërkesën e organit përmbarues, banka është e obliguar që të ofrojë sqarime dhe dokumente Gjykatës që demonstrojnë se ajo ka respektuar urdhrin e transferit dhe të gjithë urdhrat e tjerë të organit përmbarues. Të dhënat që banka ia dërgon organit përmbarues dhe që kanë të bëjnë me transferin e mjeteve monetare ndërmjet bankave duhet të përmbajë, mes tjerash, edhe emrin e marrësit dhe numrin e llogarisë së tij në bankën që ka pranuar transferin.²³⁵

Tani kur jemi tek rrada e pagesave, banka e bënë pagesën me rradhë sipas kohës së dorëzimit të aktvendimeve apo urdhrave për përmbarimin, përveç se kur me ligj parashikohet ndryshe. Banka mban evidence të veçantë për rradhitjen e aktvendimeve apo urdhrave për

²³³ USAID. (2007, fq.39). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²³⁴ USAID. (2007, fq.39). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²³⁵ Neni 155- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

përmbarimin, sipas ditës dhe kohës së pranimit dhe kreditorit sipas kërkesës së tij, i jep vërtetim për vendin e kredisë së tij në rradhitjen e tillë. Banka nuk mund ta zbatojë urdhrin e debitorit para se ta përmbushë kredinë e caktuar me aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim, po qe se me ligj nuk është paraparë ndryshe. Me aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim barazohet dokumenti publik, për të cilin një gjë e tillë parashihet me ligj të veçantë.²³⁶ Kemi dhe pagesat periodike, ku në qoftë se me anë të aktvendimit për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim, banka është urdhëruar që të bëjë pagesa të shumave të caktuara në periudha kohore të caktuara, atëherë debitori duhet bërë pagesat në pajtim me urdhëresën nga aktvendimi për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim. Llogaritë e debitorit duhet të mbesin të bllokuara derisa nuk është transferuar shuma e plotë e borxhit apo derisa organi përmbarues nuk ka urdhëruar zhbllokimin e llogarive. Banka e mban evidencën e posaçme të aktvendimeve për përmbarimin dhe urdhrin për përmbarim me të cilat janë urdhëruar pagesat e ardhshme periodike. Banka duhet të informojë organin përmbarues apo personin zyrtar të Gjykatës për çfarëdo pengesash në lidhje me pagesën, veçanërisht me mos vazhdimësinë e depozitimit periodik të pagesave në llogarinë e debitorit.²³⁷ Ekzistojnë edhe raste kur nuk ka mjete në llogari ku, në qoftë se në llogarinë e shënuar në aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim nuk ka mjete, banka në llogarinë e tillë do t'i bartë mjetet monetare të debitorit nga llogaritë tjera që ai i ka te kjo bankë. Një gjë e tillë banka e bënë sipas radhës që e cakton kreditori dhe në shumat e caktuara me aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim. Po qe se banka nuk arrin që në tërësi ta përmbushë kredinë përmbarimore nga shkak i mosekzistimit të mjeteve të mjaftueshme në llogarinë e debitorit, atëherë ajo do të mbajë në evidence të posaçme dhe sipas tij do ta bëjë bartjen posa të arrijnë mjetet në llogari, përveç se kur me aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim parashihet ndryshe. Për faktin e mosekzistimit të mjeteve në llogarinë e debitorit, banka pa vonesë duhet ta njoftojë organin për përmbarim. Bashkë me njoftimin banka ia dërgon organit për përmbarim edhe njoftimin për ndryshimet në gjendjen e llogarisë së debitorit.²³⁸

²³⁶ Neni 156- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²³⁷ Neni 157- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²³⁸ Neni 158- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

7 Dispozitat e përgjithshme lidhur me sendet e luajtshme

Përmbartimi në pasuri të luajtshme është paraparë edhe me ligj. Kreditori mund të kërkojë përmbartimin në sendet e luajtshme të identifikuar ose të kërkojë në mënyrë të përgjithshme përmbartimin në sendet e luajtshme që gjenden në shtëpinë apo vendin e punës së debitorit. Opsioni i dytë e mbrohet kreditorin nga tentimet e debitorit për t'i fshehur apo tjetërsuar sendet.²³⁹

Përfshirjet (71 LPP) *Sendet që nuk mund të sekuestrohen*

Lloji i sendeve	Kushtet	Komentet
Domosdoshmëritë shtëpiake: rrobat, këpucët, ndërresat, çarçafët, enët, mobiljet, frigoriferi, rrobalarësja etj.	Nëse janë të domosdoshme për debitorin dhe anëtarët e familjes duke pasur parasysh kushtet e jetesës.	Fjala kyçe është ``e domosdoshme``. ``E domosdoshme`` zakonisht definohet si minimum i kërkuar për jetesën ose punën në familje.
Ushqimi dhe karburanti	Për gjashtë muaj	
Kafshët shtëpiake, makinat dhe mjetet bujqësore.	Nëse janë të domosdoshme për mbajtjen e fermës dhe për aq sa janë të nevojshme për mbështetjen e familjes.	Aplikohet vetëm nëse debitori është bujk.
Ushqimi i kafshëve	Për katër muaj	Aplikohet vetëm nëse debitori është bujk.
Veprat, makinat dhe sendet	Nëse janë të domosdoshme për punën e debitorit si zejtar.	Aplikohet vetëm nëse debitori është zejtar.
Lëndët e para dhe lëndët energjetike	Nëse janë të domosdoshme për punën e debitorit si zejtar për katër muaj.	Aplikohet vetëm nëse debitori është zejtar.
Librat dhe sendet tjera	Nëse janë të domosdoshme për punën e debitorit si profesionist.	Aplikohet vetëm nëse debitori është profesionist.
Paratë e gatshme të debitorit me të ardhura mujore	Në kuadër të kufizimeve të përcaktuara për të ardhurat	
Sendet personale si dekoratat, medaljet, unazat e martesës, letrat personale, dorëshkrimet etj.		Kjo është e limituar në sendet personale të rëndësishme të veçantë. P.sh. aplikohet në unazat e martesës, në sendet me vlerë të familjes, por jo në të gjitha stolitë.

²³⁹ USAID. (2007, fq.42). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbartimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,_ALB\).pdf](http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,_ALB).pdf)

Përveç sendeve që i çekëm më lart mund ti përmendim edhe aparatet për ndihmë, nëse janë të domosdoshme për mbajtjen e funksioneve jetësore. Aplikohet për debitorët e hendikepuar p.sh karroca e invalidit.²⁴⁰

Procedura e përmbarimit në sendet e luajtshme kalon nëpër tri faza: 1) *regjistrimi, sekuestrimi dhe vlerësimi*; 2) *shitja*, dhe 3) *pagesa*.

- 1) *Regjistrimi, sekuestrimi dhe vlerësimi*: kjo fazë korrespondon me identifikimin e sendeve të luajtshme e të përshtatshme për përmbarim. Pas njoftimit të kreditorit dhe debitorit me vendimin e përmbarimit dhe pas skadimit të afatit të përmbushjes vullnetare, faza e regjistrimit, sekuestrimit dhe vlerësimit mund të fillojë dhe duhet të fillojë menjëherë. Regjistrimi madje mund të ndodhë krahas njoftimit.²⁴¹
- 2) *Shitja*: kjo fazë në parim kryhet pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit, përmes ankandit public të sendeve të regjistruara. Afati prej pesëmbëdhjetë ditësh mund të zvogëlohet në dy raste:
 - rreziku i dëmtimit të sendit (p.sh sendet që prishen lehtë), ose
 - rreziku i dëmtimit të çmimit.²⁴²
- 3) *Pagesa*: pagesa e kreditorit ose e kreditorëve është faza e fundit e përmbarimit në sendet e luajtshme. Këtu është me rëndësi të dihet se nëse çmimi i shitjes nuk është i mjaftueshëm për të paguar borxhin kryesor pas përmbushjes së borxheve prioritare, atëherë procedura e përmbarimit përfundon. Kriteret për vlerësimin e prioriteteve janë: Pranueshmëria- kreditorët, për t`u konsideruar të pranueshëm, duhet të kenë vendim të vlefshëm, efektiv në kohën e shitjes; dhe Prioriteti- kreditorët të cilëve ligji u jep prioritet përmbushen të parët. Të gjithë kreditorët tjerë përmbushen në bazë të rradhës sipas të cilës e kanë marrë të drejtën e pengut mbi sendet, p.sh. kreditori me vendim më të vjetër të përmbarimit përmbushet i pari.²⁴³

²⁴⁰ USAID. (2007, fq.43). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë.Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²⁴¹ USAID. (2007, fq.44). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë.Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²⁴² USAID. (2007, fq.46). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë.Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²⁴³ USAID. (2007, fq.48). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbarimore në Kosovë.Shih. [http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

8 Dispozitat e përgjithshme lidhur me sendet e paluajtshme

Përmbartimi i pasurisë së paluajtshme parashihet dhe rregullon në mënyrë eksplicite procedurën mbi sendet e paluajtshme për përmbushjen e borxheve monetare, për shkak të rëndësisë së madhe që në Kosovë i jepet sendeve të paluajtshme. Teoricientët ligjor definojnë paluajtshmëritë si çdo send që nuk mund të transportohet nga një vend në tjetrin dhe nuk mund ta ndryshojë strukturën e vet.²⁴⁴

Për qëllime të përmbartimit, paluajtshmëri konsiderohen:

- 1) Toka (p.sh. toka bujqësore, pylli),
- 2) Ndërtesat (p.sh. lokalet afariste, shtëpitë e banimit, apartamentet),
- 3) Sendet që janë pjesë e pandashme e ndërtesës (p.sh tullat në mur),
- 4) Sendet si pjesë e tokës (p.sh. drunjtë apo frutat para vjeljes).

Teoricientët ligjor po ashtu përfshijnë sendet e paluajtshme sipas destinimit, që janë sende të luajtshme, që mund të përdoren për qëllime ekonomike të paluajtshmërisë.²⁴⁵

Për të vendosur për propozimin për përmbartimin për sendin e paluajtshëm dhe për zbatimin e aktvendimit për përmbartimin, e kompetencës tokësore është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria.²⁴⁶ Në anën tjetër për të vendosur për propozimin për përmbartimin për sendet e paluajtshme dhe për zbatimin e aktvendimit për përmbartimin, përmbartuesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbartimor dhe të zbatojë përmbartimin.²⁴⁷ Përmbartimi për paluajtshmërinë zbatohet me shënimin e përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, me përcaktimin e vlerës së paluajtshmërisë, me shitjen e paluajtshmërisë dhe me pagimin e kreditorit të përmbartimit nga shuma e të hollave e fituar nga shitja.²⁴⁸ Po qe se me dispozita ligjore nuk është paraparë ndryshe, objekt përmbartimi mund të bëhet vetëm paluajtshmëria si tërësi e caktuar me anë të dispozitave të cilat e rregullojnë pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, si dhe librat publik të paluajtshmërive. Pjesa në bashkëpronësi e paluajtshmërisë mund të bëhet objekt i posaçëm i përmbartimit (pjesa

²⁴⁴ USAID. (2007, fq.49). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbartimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²⁴⁵ USAID. (2007, fq.49). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbartimore në Kosovë. Shih. [http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtësia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²⁴⁶ Neni 190- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁴⁷ Neni 191- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁴⁸ Neni 192- Ligji për procedurën përmbartimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

ideale e bashkëpronësisë në paluajtshmërinë) lidhur me të cilën në mënyrë të përshtatshme aplikohen rregullat e këtij ligji për përmbarimin për sendet e paluajtshme.²⁴⁹

Në rast të procedurës përmbarimore për pjesën e bashkëpronësisë, e me kërkesë të kreditorit, debitorit apo të bashkëpronarit tjetër, organi përmbarues në aktvendimin për përmbarimin ose urdhërit për përmbarim do të caktojë që për shitje të ofrohet sikurse sendi i paluajtshëm në tërësi, ashtu edhe pjesa e bashkëpronësisë që është objekt përmbarimi. Po qe se çmimi i shitjes së pjesës në bashkëpronësi të paluajtshmërisë, do të ishte dukshëm më i lartë në rast të shitjes së gjithë sendit të paluajtshëm, atëherë organi përmbarues do ta caktojë shitjen e gjithë sendit të paluajtshëm, duke vepruar sikur të ishte fjala për kërkesën e bashkëpronarit për ndarjen e sendit të pandashëm fizikisht, ashtu siç është paraparë me rregullat me të cilat janë të rregulluara marrëdhëniet bashkëpronësore. Në aktvendimin për përmbarimin ose urdhrin për përmbarim, organi përmbarues do të theksojë se shënimi i përmbarimit i përket paluajtshmërisë si tërësi.

Bashkëpronari që nuk është debitor i përmbarimit ka të drejtë që t'i paguhet vlera e pjesës së tij nga shuma e të hollave të fituara me shitjen e paluajtshmërisë para se t'i përmbarohet kredia kreditorit të përmbarimit dhe personave të tjerë të cilët realizojnë kërkesa në procedurën e përmbarimit, si dhe para se të paguhet shpenzimet e procedurës përmbarimore. Bashkëpronarët që nuk janë debitor në procedurën e përmbarimit kanë të drejtë që të kërkojnë që paluajtshmëria që është objekt përmbarimi t'u jepet atyre po qe se e depozitojnë shumën e cila i përgjigjet vlerës së pjesës së debitorit në paluajtshmërinë e tillë.²⁵⁰

9 Përmbarimi dhe përmbarimi: Borxhet jomonetare

Përmbarimi nuk ka të bëjë gjithmonë me borxhet monetare (në të holla). Përmbarimi mund të kërkojë, gjithashtu edhe për obligime jomonetare. Ligji për përmbarim parasheh procedura specifike për një rreth të gjerë të obligimeve jomonetare të cilat bëjnë pjesë në njërin prej dy kategorive: obligimi për të vepruar (p.sh: kthimi i pasurisë së luajtshme, regjistrimi i të drejtës në librat e tokave, apo lirimi i pasurisë së patundshme) dhe obligimi për të mos vepruar (p.sh: shmangia nga shkelja në pronën e patundshme të dikujt tjetër, apo shmangia nga ngritja e ndërtesës). Ne nuk do të prekim në specifikat e çdonjëres dhe secilës

²⁴⁹ Neni 193- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

²⁵⁰ Neni 194- Ligji për procedurën përmbarimore i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-139, (Gazeta zyrtare e RK-së).

procedure përmbareme në këtë kaptinë. Në vend të kësaj, do të fokusohemi në pesë obligimet kryesore:

- 1) kthimi i punëtorit në vendin e punës,
- 2) kujdestaria mbi fëmijën,
- 3) pengimi i posedimit,
- 4) dëbimi, dhe
- 5) përmbaremi i të drejtës në kolateral.²⁵¹

- 1) Kthimi i punëtorit në vendin e punës - Për raste të tilla, gjykata në territorin e së cilës gjendet vendi i punës, është kompetente të vendos për përmbaremin. Kërkesa për përmbaremi duhet të paraqitet brenda 6 muajve nga dita kur punëtori fiton të drejtën për të kërkuar rikthimin në gjendjen e mëparshme. Propozimet e paraqitura pas kësaj kohe do të refuzohen sit ë pavlefshme. Përmbaremi kryhet duke e kthyer punëtorin në vendin e tij të punës ku ka punuar para largimit. Gjykata mund të caktojë edhe gjoba për punëdhënësin në mënyrë që ta detyroj këtë. Punëtori i kthyer në punë gjithashtu mund të kërkojë kompensim për pagat e humbura për periudhën prej ditës kur ka fituar të drejtën për tu kthyer (p.sh nga dita kur aktgjykimi e ka marrë formën e prerë) deri në ditën e kthimit.²⁵²
- 2) Kujdestaria mbi fëmijën apo dorëzimi i fëmijës – Përmbaremi i vendimeve përkitazi me kujdestarinë e fëmijëve kryhet në pajtim me procedurën e paraparë të Ligjit mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Martesore (1984). Gjatë vendosjes mbi ndërprerjen e martesës, gjykata gjithashtu nxjerr edhe vendimin mbi kujdesin dhe kujdestarinë e fëmijëve të mitur të çiftit. Vendimi mbi kujdestarinë e fëmijës i beson fëmijën personin, kryesisht njërit prej prindërve.²⁵³ Fëmija mund të kërkojë që kujdestaria t'i besohet prindit tjetër apo një personi të tretë. Vendimi mbi përmbaremin e urdhëron debitorin (d.m.th. personin me të cilin fëmija aktualisht qëndron) që t'i dorëzojë fëmijën kreditorit (d.m.th. personit të cilit gjykata ia ka besuar kujdestarinë mbi fëmijën), brenda një kohë të caktuar. Para marrjes së vendimit, gjykata do të vendosë ta kryejë përmbaremin, në rast të mos përmbushjes së urdhrit brenda afatit duke i shqiptuar debitorit dënimin me gjobë, apo duke marrë fizikisht fëmijën. Në praktikë,

²⁵¹ USAID. (2007, fq.61). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbareme në Kosovë.Shih.
[http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²⁵² USAID. (2007, fq.61). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbareme në Kosovë.Shih.
[http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

²⁵³ USAID. (2007, fq.62). Doracak për zbatimin në praktikë të procedurës përmbareme në Kosovë.Shih.
[http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__\(ALB\).pdf](http://www.drejtesia-ks.org/repository/docs/ENF_Civil_Execution_Handbook,_21_November_2007,__(ALB).pdf)

